

Studiuesi Bashkim Kuçuku ka botuar librin “Bilal Xhaferri. Realizëm dhe tragjizëm” (Albas). Ai njihet dhe si autor i librit “Kadare në gjuhët e botës” (Onufri) ndaj vetvetiu të zgjohet dëshira të dish se si i ka trajtuar ai dy shkrimtarët e përfolur si përjashtues të njëri-tjetrit, ku Kadare vazhdon të paragjykohet si sjellës i fatkeqësisë së Bilal Xhaferit, ndërkohë që ky i fundit s’ka lënë gjë pa thënë kundër tij.

Studiuesi Bashkim Kuçuku midis Kadaresë dhe Bilal Xhaferit

Nga Fatbardh Amursi

*Pjetër Arbnori,
Lordi Bethel dhe spiuni
Kim Philby*

Nga Ndrej Gjini, Galway, Irlandë

SHËNIME MBI LIBRAT

Monografia “VASIL RAKAJ”, nga Suzana Varvarica
Një libër i çmuar për punën e gjatë në studio, kërkimet, eksperimentet e skulptorit

Vasil Rakaj

Nga Gazmend Leka

(fq. 8)

DE RADA PËR
SHKODRËN – SHKODRA
PËR DE RADËN

(fq. 9)

Nga Prof. Dr. Alfred Çapaliku

“Paradigmat e vetmisë në poezi”
Luan Topçiu me një studim krahasues mbi lirikën shqiptare dhe rumune

Nga Kastriot Kotoni

(fq. 10)

Shënime mbi krijimtarinë e poetit Xhevahir Spahiu

POETIKA E QËNDRESËS
DHE E SHIKIMIT PËRTEJ

Nga Luan Rama

(fq. 13)

Nga Onufri dhe Trishtil, “Njerëz normalë” e Rooney-t, dhe “Më thirr me emrin tënd” e Aciman-it.

Njerëzit normalë thirren me emrat e njëri-tjetrit

Nga Andreas Dushi

(fq. 4)



Romani i Mira Meksit “Ikona e Plagosur” Dekonstruksioni identitar dhe autenticiteti i plagosjes së ikonës

Nga Enver S. Morina

(fq. 6)

Në romanin e Mira Meksit “Ikona e Plagosur” hyn një çast fluturak i ngrirë në imazhin monumental, fati i një ikone e cila bëhet pasqyrë reflektimi, rrezet e së cilës depërtojnë në thellësitë më të largëta të hapësirës së “ndikimit” arbëror! Në periferi përmes detajeve dhe dromcave jetësore dhe “arratisjes” së familjeve pas vdekjes së kryeheroit, Skënderbeut! Intriga është aq reale saqë kapërcen “labirintin” e të dhënave historike për t’u ngulitur thellë në dilemën e lexuesit modern për një “mot të madh”...



“Sali Vranishti, njeriu-këngë”

Akademik Vasil S. Tole

(fq. 11)

Protect me from what I want

Syri dhe zemra

Nga Edison Çeraj

(fq. 18)

Botim i ri nga Ombra GVG

“Drita e muzgut”

nga Jaap Robben

(fq. 23)

Simon Armitage,
laureati i sotëm i Anglisë
dhe tri poezi të tij

Nga Rudolf Marku



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Petro Çerkezi

Shikomë në sy

(fq. 12)

Arben Velo

Juga e bardhë e një artisti

(fq. 14)

Ylli Ajdini

Dita e parë e pushimeve

(fq. 14)

Gjergji Mihallari

Schonefeld Airport

(fq. 15)

Kleo Lati

Pranga të padukshme

(fq. 16)

Shazim Mehmeti

Ajo ka ardhë sërish

(fq. 17)

Edna St. Vincent Millay

Koha nuk të shëron

(fq. 20)

Përktheu: Roland Gjoza

Pascal Quignard

Dashuria

Përktheu: Feride Papeleka

(fq. 22)

Arben Mexsi

Karikatura e së shtunës

(fq. 24)

Libri shqip
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta
brenda SHBA-së

www.albblibris.al



Me rastin e 90-vjetorit të lindjes së Bilal Xhaferit (1935-2025) studjuesi Bashkim Kuçuku boton librin “Bilal Xhaferi. Realizëm dhe tragjizëm”, botim i Albas, ku pjesën më të madhe e zënë dosjet e Sigurimit të Shtetit, i lexuar prej meje në 90-vjetorin e lindjes së Kadaresë më 28 janar të këtij viti. Përkime përvjetorësh të dy versnikëve me fate të ndryshme. Studjuesi Kuçuku njihet dhe si autor i librit “Kadare në gjuhët e botës” me studime, hulumtime, biografi, botim i Onufrit në vitet 2000, 2005 dhe 2015, ndaj vetvetiu të zgjohet dëshira të dish, se si i ka trajtuar ai dy shkrimtarët e përfolur si përjashtues të njëri-tjetrit, ku Kadare vazhdon të paragjykohet si sjellës i fatkeqësisë së Bilal Xhaferit, ndërkohë që ky i fundit s’ka lënë gjë pa thënë kundër tij?! (Ndodh që dhe viktimat të bëjë mëkate.) Kjo “gjendje luftime” mes tyre mbahet ende gjallë, edhe pas vdekjes, e stimuluar a e sponsorizuar, në dyshimin tim: prej palëve të interesuara, përfshi dhe 54 sigurimsa e bashkëpunëtorë të tyre, që e përndoqën shkrimtarin çam, përndjekës dhe të një “Kadare i denoncuar”, sikurse njihemi në dosjen e publikuar nga Dashnor Kaloçi. Kadare u njoh me dosjen e tij, ndërsa Bilal Xhaferi iku i përgjuar dhe i sulmuar nga erinitë e policisë së fshehtë. (Studjuesi Bashkim Kuçuku midis Kadaresë dhe Bilal Xhaferit të përngjan me një “pajtuari gjaqesh”, apo urë e vig, ku kalon i mirë dhe i ligë? Një rol që s’është e lehtë të merret, por që ka vetëm një shteg për t’ia dalë mban: hapja e dosjeve, duke hulumtuar të vërtetat e kyçura.

Sikurse dihet, Bilal Xhaferi, bëri emër me tregimet, poezitë, reportazhet të botuara në diktaturë, njohur me librat: “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”, “Lirishta e kuqe” dhe romani “Krastakraus” i paraqitur në një konkurs letrar, ndërsa 17 vite krijimtari në botën e lirë s’i përmenden si një vlerë e shtuar. Nuk përfitoi nam nga liria. (Edhe Kadare u bë i njohur në botë nga romanet të botuara në diktaturë.) Ndërkohë shtrohet pyetja: Bilal Xhaferi a ishte një shkrimtar i realizmit socialist? Askush s’e quan të tillë, sikurse s’rreshtin së thëni për Kadarenë e shumë të tjerë, duke denoncuar poezi për partinë dhe shokun Enver. Njerëzit e rinj dhe lirishta e kuqe të duken si sinjalistika të kohës së socializmit, ndërkohë që ai beson se: “Do të vijë koha që shkrimet e mia do të pëlqehen jo nga një grup zyrtarësh.” Duke përmendur zyrtarët, mos po vë në rreth të kuq kundërshtarët e tij realë? Por, mileti si kundërshtar të tij njohin Kadarenë?! Nuk shoh që pëlqyeshmëria ndaj Bilal Xhaferit të jetë rritur në demokraci. Ajo ka mbetur njësoj, si në diktaturë. Kështu që zyrtarët mbeten pa ndikim në famën e tij, por jo në jetën e shkrimtarit.

Ajo që ka rëndësi për autorin e këtyre radhëve është fakti, që librin për Bilalin e ka shkruar një adhurues i tij, i cili rezultoi të jetë dhe i Kadaresë, i cili kujton jo pa qëllim: “Përmbledhjen me poezi “Lirishta e kuqe” e kam lexuar, sapo doli nga shtypi, por, që u ndalua qarkullimi i saj. Student, në konvikt, isha në një dhomë me shokun e ngushtë, Fotaq/Foto Malo, në degën e letërsisë, në një grup; me Petro Çerkez, shok i ngushtë, Bardhyl London, të dy në degën e gjuhës ruse. Petro, që nuk linte redaksi pa hyrë, shkrimtar pa takuar e debatuar, sollti një natë në dhomë “Lirishta e kuqe”. “Edhe ky s’ka bërë gjë”, tha. “Po ti ç’shpikje prisje?”, ia ktheu Bardhi. Prisnim “çudira”, befasi orgjinalizimi, forcë shprehëse! Të ishte mbi shkallaren shprehëse të tregimeve.” Edhe Bardhi, edhe Fotaqi pëlqyen, poezi, aty këtu. “E mo se s’është ndonjë gjë e rrallë, tha Bardhi që ia pati marr nga dora Petros, duke e lexuar menjëherë...E lexova kur isha vetëm. Më pëlqyen disa, të tjerat më dukeshin përshkruese.” (“Lirishtën e kuqe” e kam lexuar, kur e sollën në fabrikën e letrës në Lushnje për ta asgjesuar në karton. E pëlqeva, jo aq sa poezitë e Kadaresë. Edhe tregimet, novelën Purpuranti e kisha pëlqyer, jo aq sa prozën e Kadaresë. Në këto vlerësime, që s’ dallojnë dhe prej të tjerëve, jemi dhe sot, hiq ata që udhëhiqen nga përdorimi politik i autorëve, që kërkohet ta ndryshojnë herarkinë në art me biografira.)

Nga dosjet e publikuara në librin e studjuesit Kuçuku lexojmë se: Bilal Xhaferi kishte fituar simpatinë e disa rretheve letrare dhe publicistike të kohës. Dhimitër Shuteriqi

Studjuesi Bashkim Kuçuku ka botuar librin “Bilal Xhaferi. Realizëm dhe tragjizëm”, (Albas) Ai njihet dhe si autor i librit “Kadare në gjuhët e botës” (Onufri) ndaj vetvetiu të zgjohet dëshira të dish, se si i ka trajtuar ai dy shkrimtarët e përfolur si përjashtues të njëri-tjetrit, ku Kadare vazhdon të paragjykohet si sjellës i fatkeqësisë së Bilal Xhaferit, ndërkohë që ky i fundit s’ka lënë gjë pa thënë kundër tij?!

Studiuesi Bashkim Kuçuku midis Kadaresë dhe Bilal Xhaferit

Nga Fatbardh Amursi



e ka propozuar për t’u bërë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve. Shefqet Musaraj e L Lazar Siliqi kanë shkruar në Durrës në Komitetin e Partisë, që Bilali të pranohej anëtar i Lidhjes. I është dhënë leje krijuese. Vehbi Skënderi pyet: pse në presidiumin e mbledhjes nuk ishte dhe Bilali? Moikom Zeqo shok i ngushtë i tij. Po kështu: Kiço Blushi, Koçi Petriti, Sulejman Mato, Adriatik Kallulli, e plot të tjerë. Për romanin kushtuar Skënderbeut e ka ndihmuar Dhimitër Pilika. Redaktori Dhimitër Fullani i ka botuar librat me urdhër të Dashnor Mamaqit. Qamil Buxheli është njeri nga ata që e kanë mbështetur Bilalin, e donte shumë dhe e vlerësonte penën e tij. I persekutuari Bedri Myftari, miku i tij i ngushtë, kujton: “Bilalin e kanë ndihmuar shumë vetë, edhe Trim Gjata, por në mënyrë të veçantë e kanë ndihmuar edhe Vath Koreshi, edhe Agim Cerga, si dhe Miço Verli, që ishte kryeredaktori, se po të mos donte Miçua nuk botoheshin ato të Bilalit. Edhe Ali Abdihoxha e ka përkrahur, sa një herë ka thënë se ky është Çehovi ynë dhe nuk ka çmim për të se po t’i japim çmim të parë, duhet të ketë shumë vende bosh e pastaj të ketë çmim tjetër. Edhe Dritëro Agolli e donte shumë, bile ka shkruar edhe një shkrim për të, edhe Ismail Kadare e donte, të gjithë e donin, nuk kishte njeri kundër veç ata të partisë e shihnin shtrembër.” Ata të partisë se mos vetëm atë shihnin shtrembër?! Naum Prifti i ka bërë portretin më interesant: “Në dhomën e redaktorëve hyri një djalë me uniformë ushtari dhe pyeti nëse mund të takonte Naum Priftin. Kishte trup mesatar, thujse imcack, me sy bojë qielli, flokë të verdhë, me fytyrë të pjekur nga dielli, ku binte në sy hunda e kuqe pak e rrjepur. Sa e pashë me rroba ushtari u kujtova. “Bilal Xhaferi?” e pyeta. “Po, erdha sipas letrës që më dërguat”, mu përgjigj. E luta të ulej dhe të priste pak, sa të përcillja bashkëpunëtorin me të cilin isha duke biseduar.” E fton dhe në shtëpi. Kudo të shoqëron pikëpyetja: kur “të gjithë e donin”, kush e ka luftuar Bilal Xhaferin? Mos gishtin duhet ta drejtojmë tek 54 sigurimsat dhe bashkëpunëtorët e tyre, ku të bien në sy dhe pseudonime të tillë: “Letrari i ri”, “Çajupi”, etj? Por, a kanë qenë të gjithë miqtë e tij? Ka të ngjarë ta kenë ndërsyer kundër Kadaresë, sikurse e përdorin edhe sot kundër gjenit të letrave shqip?

Ish i burgosuri, shkrimtari Bedri Myftari, e kujton kështu historinë e përplasjes së bujshme: “Mërzitja ime e parë me Bilalin ishte për arsyen e romanit “Dasma” të Ismail Kadaresë. Unë i thashë që të mos fliste, por ai nuk më dëgjoi, foli dhe si përfundim, pas asaj që ndodhi, edhe vetë Bilali e kuptoi që nuk kishte bërë mirë që foli. “E prisha”-më tha ai. Ndërsa unë i thashë: “Ik, s’ke punë më me mua”. Unë i thashë mos fol se do të kesh pasoja, se babain ai e kishte të pushkatuar nga regjimi, por ai nuk më dëgjoi. (Pra: mos lllapë, por shkruaj! F.A)... Isha bashkë me Liri Lubonjen. Bile Liria tha: “Bobo ç’bëri ai, nuk e di se çfarë do ndodhë”. Tha kështu, se Todi (Lubonja) e kishte përkrahur shumë Bilalin.” (Todi Lubonja e përkrahte, Fadil

duke i kujtuar nga Amerika kohën studentore në Moskë me një gjuhë që propaganda e kohës e përdorte shpesh: i shitur me rubla e aspra, si dhe dashnoret.

“Ti lulëzove në stinën me rubla, Kur ne të tjerët hamë baltën e kënetave, Ti u këndon serenata rrugëve të Moskës, Natashave, Tatjanave, Katjenkave.”

Dhe autorit të romanit “Kënetat”, tipik i socrealizmit, nuk iu thanë këto fjalë. Kur Kadare shkroi romanin “Dimri i madh” iu turrën ta fundosnin, duke e akuzuar si agjent të Perëndimit? Dhe ky ishte kryeministri i vendit. Më poshtë Bilali do e akuzojë dhe për plagjiaturë.

“Kur ne të tjerët hamë plumbat e mashinkave me kadifenë e poemave të tua të kopjuara, Ti u jep xhelatë çizmeve të xhelatëve, çizme të rënda me gozhda ta përgjakura që shkelën mbi fytyrat tona të masakruara.”

Si bir i një babai të pushkatuar, nuk i falet, që konturet e vrasëve t’i shoh në fytyrën e kolegut shkrimtar, kur ai vetë për vrasës të babait ka akuzuar njerëzit e Teme Sejkos i pushkatuar nga Enver Hoxha dhe, Fadil Paçrami, që e akuzoi si të birin e armikut pati më pas një fat më tragjik nga ai në raport me regjimin. Dramat personale nuk duhet të injorojnë tragjeditë e të tjerëve, nëse do të jesh i drejtë me kohën. A është e drejtë, që në kohën kur Kadare po bëhej i njohur në botë me prozën, ty të ngelet ora tek poezia?!

Ti vije nga sallonet e aristokracisë së kuqe, Vinje nga “Dasma” i dehur me lavdi, Unë vija drejt nga zemra e popullit, Vinja nga varrimi i babait të pushkatuar, Vinja nga varrimi i lirisë së kombit.

Tek poezia e parë flet nga pozita e klasës punëtore, tek e dyta nga pozita e përfaqësuesit të popullit, sikurse hiqeshin dhe pushtetarët. Propaganda e kohës i ngrinte në qiell shkrimtarët të ardhur nga radhët e klasës punëtore rol, që Bilalit po i leverdiste duke u forcuar politikisht. Zgjedh të bëjë kontrast me Kadarenë i mbështetur në kriterin klasor, që regjimi e kishte për zemër. Në vargjet e më poshtme Bilali i hedh dorashkën njeriut të gabuar për të zbratur pakënaqësitë klasore:

Ne u ndeshëm në errësirë
Si dy re, në një natë me stuhi

Flet për një ndeshje, duke krijuar idenë e një dyluftimi, kur pala tjetër heshti, nuk e pranoi për kundërshtar, duke manipuluar si e si të fitonte nderin e humbur.

Por që të gjithë e dinë mirë
Që shenja e furisë sime s’ishte ti:

Atëherë pse në qendër të sulmeve ve

Paçrami e sulmoi, ndërkohë që të dy zyrtarët e lartë të nomenklaturës së kuqe dënohen si të një grupi liberal?) Fundja, çfarë i kishte bërë Ismail Kadare, që ai shkon në diskutimin letrar për “Dasmën” si një i paftuar? Sikurse rrëfëhet një miku i tij i ngushtë: kishte përgatitur për diskutim 50 faqe, madje: 3-4 ditë para se të shkente në Tiranë për diskutimin e romanit “Dasma” dorëzon për botim poezinë “Për ty poet”, krejt e kuptueshme kundër Ismailit, e cila edhe sot shpërndahet me zell. Përtej aludimit ajo mbetet një poezi e bukur, që i shkon poetëve të socrealizmit, ku as ai dhe as Kadare nuk bëjnë pjesë.

“E kam fjalën për ty

Që pret të bjerë përsëri tërmet
Dhe të nxitosh të shkruash poezi.
(Kujto poemën e Kadaresë “Këto ditë dhjetori” kushtuar tërmetit në Dibër, për të cilin Fatos Arapi shkroi një roman.)

E kam fjalën për ty
që pret të dalë përsëri një emër heroj
Dhe të nxitosh të vendosësh mbi ballin e tij
Një aureolë poetike.
(Kujto poemën e Ismailit për Fillëronjësën.)
Poemat e tua
Të puthitura e të vidhosura me sinteza
Me simbole
Me novatorizma
I përmbledhin dhe i përfshijnë të gjitha
Në mënyrë besnike
Si një fotokopje panoramike
(Kujto poemën “Ëndërr industriale” kushtuar uzinës së Laçit, ku punuan dhe të burgosur.)

Atje mungojmë vetëm ne
Ne që ngremë oxhaqe dhe shtylla
Mungojmë ne.
Dhe atëherë kur ti e ke fjalën për ne
Për ty pra e kam fjalën
E kam fjalën për ty
Kur ti e ke për ne
Për ty poet
Që ne, masën, na bën të mendojmë:
“fort po shndrit ai diell e pak po nxeh.”

Kadare ka një libër poetik me titull “Motive me diell”. Aludon për shkëlqimin e rremë të shkrimtarit, sipas tij: ndriçimit i mungon ngrohtësia. Vetën e fut tek “ne”, ndërsa Ismailin e lë tek “ata”. Ja dhe një poezi e dytë kundër Kadaresë, e cila nuk e nderon aspak autorin e saj,



Kadarenë, kur shenjë e furisë tënde s' paska qenë ai? I bie të ketë qenë Fadil Pacrami se Todi Lubonja ka qenë përkras të tij. Lë të kuptoj se nuk e ka me "oborrtarin", por me "tiranin", të cilit i dërgon një letër, të cilën do e analizojmë më poshtë.

Unë u ndesha atje me tiraninë
Hodha jetën time në kthetrat e ujqërve
Dhe u shikova me vdekjen time sy më sy.

Kush ishte i dehur nga lavdia dhe cili u verbua nga cmira? Sulmet ndaj Kadaresë, për fat të keq, i shet si sulme ndaj regjimit, kur një gjë e tillë nuk ndodhi, pavarësisht se u trajtua si biri i armikut. Ai nuk u ndesh, por iku në "tokën e premtuar", preku ëndrrën amerikane e lakmuar dhe sot nga shqiptarët. (Nga goja e Kadaresë kanë dalë vetëm këto fjalë: "Bilal Xhaferi kishte më të madhe ambicjen nga talenti", të cilat mbeten si një pretendencë prokurori.) Ka dhe fantazira të këtij lloji: "Ma kanë thënë, pasi kishte iku Bilali, se në mbrëmjen para se të shtrohej çështja e librit të Ismail Kadaresë, "Dasma", në Lidhjen e Shkrimtarëve, në mesnatë, në shtëpinë e Kadaresë shkoi Nexhmije Hoxha, gruaja e Enverit dhe duhet t'i ketë thënë: "Ismail, mos u shqetëso fare për këtë punë. Janë marrë masat, nuk të bën dot gjë njeri ty." Dihet që legjendat urbane janë një ushqim badjava për budallenjtë, të cilët kthehen në një fuqi e verbër kundër cilitdo, që i ndërsejnë. (Petro Marko e ka quajtur "Dasmën" e Kadaresë një dasëm të letërsisë sonë.)

Inati ndaj Kadaresë nuk i del kollaj dhe kërkon shpëtim tek Enver Hoxha, duke i shkruar një letër, që të lë pa mend: "I dashur shoku Enver! Në pranverën që shkoi, u organizua në Tiranë një diskutim letrar rreth romanit "Dasma" të shkrimtarit Ismail Kadare... Shoku Fadil Paçrami që foli pas meje, njoftoi sallën që unë kisha babanë të pushkatuar dhe më deklaroi mua si armik, kurse romanin "Dasma" e vlerësoi lart... U ngrita kundër romanit "Dasma", se ai më dukej i gabuar fund e krye në brendinë e tij... Një shkrimtar i mirë revolucionar, (rol që Bilali e pretendon) nuk duhet të abuzojë me idetë e mëdha të partisë, duke i përdorur si prestigjator tezat dhe parrullat e partisë, vetëm sa për të bërë efekt, vetëm sa për të krijuar iluzione te lexuesi." Sikurse shihet, autori i poezisë "E kam fjalën për ty", e akuzon Kadarenë tek diktatori si abuzues të ideve të partisë dhe prestigjator i tezave, i bindur se po mbronte vijën dhe se udhëheqësi duhet ta llogariste tek besnikët e idealit?! Dhe më poshtë: "Romanin "Dasma" unë e denoncova si një vepër të shkruar shumë larg metodës së realizmit socialist dhe të rënë nën ndikimin e artit dekadent." Shihni sa ngjan ky denoncim me atë të Kasëm Trebeshinës, në letrën që ai i dërgon kryeministrit Shehu: "Dhe pikërisht në vitin 1961 kemi manifestin e shkollës moderniste: (Manifestin e dytë, se të parin e kishte bërë që në vitet tridhjetë Dh. S.

Shuteriqi në librin "Kangë"), tani "Shekulli im" i I. Kadaresë." Dhe në fund të letrës mohon bbanë biologjik duke pranuar atë ideologjik. "Mua nuk më ka rritur dhe nuk më ka edukuar babai im, të cilin nuk e mbaj mend dhe nuk e njoh, por më ka rritur dhe më ka edukuar klasa punëtore. Nëse duhet të flitet për atësinë time, unë jam bir i klasës punëtore i brumosur me idealet e saj." Me poezinë dhe letrën ai plotëson figurën e "shkrimtarit të ardhur nga klasa punëtore", që në atë kohë merrte gjithë vëmendjen e propagandës kundrejt intelektualizmit të qortueshëm, ku vagabondi mbahej për i shenjët. Por, mbi letrën e Bilalit Enver Hoxha ka lënë një shënim me stilolaps të kuq: "Asnjë autokritikë nuk bënë për lakrat që ka në kokë, për të cilat drejt është kritikuar, dhe jo se i bën kritika "Dasmës".

Ndiqni këtë dialog domethënës midis një bashkëpunëtorit të sigurimit "Burimi" dhe shkrimtarit Bilal Xhaferi, i cili mbahej nën kontroll prej tyre, marr nga libri i B. Kuçukut:

Burimi: A nuk ishte ti i zoti të botoje diçka që të bëhej flamur për letërsinë tonë?

Bilali: Unë e kam vërtetuar me bazë se ai roman, kënaq sedrën e përkëdhelur të Ismail Kadaresë, i jep mundësi atij të shprehë në mënyrë të fshehtë prirjet prej vagabondi, ndërsa na shfaqet si shenjtor.

Burimi: Unë nuk kam talentin tënd, por ama kam nuhatje dhe aftësi për t'i shpëtuar çdo goditje në çfarëdo forme qoftë... Hiq dorë nga njerëzit që të këshillojnë keq.

Bilali: Jam krejt i vetëm.

Burimi: Tani që po flet me mua, nuk je vetëm.

Kush ishin ata, që e këshilluan keq dhe ai nuk i tregoi kurrë? Sipas kushëririt të tij, Bilali që nga viti 1964 kishte në plan të arratisë, fillimisht duke u stërvitur në not si në Pogradec dhe Durrës. Kështu që bie alibia

se shkak i ikjes së tij është bërë konflikti me Kadarenë. Ai e kishte mendjen për të iku. "Eja shiko nusen" ka qenë teksti i telegramit që i ka shërbyer si pretext për t'i dhënë lejë Dega e Brendëshme. Sa i shkon ky tekst atij, që desh t'i prishte "Dasmën" Kadaresë! Për këtë u shfrytëzua një festë e krahinës, ku gjatë verës bëhej një panair me pjesëmarrjen e banorëve të të gjithë fshatrave të zonës. Atje dëfrehej gjatë gjithë natës. I luteshin të gjente një nuse e të martohej. Në fakt, ai e kishte një të dashur, së cilës i shkruan: "Ti nuk më njeh. Po edhe fare të panjohur ne nuk jemi me njëri-tjetrin dhe unë besoj se nuk duhet të çuditësh aq shumë kur ta lexosh këtë letër. Sidoqoftë, ti mendo si të duash, po unë nuk dua t'i gris akoma këpucët duke kaluar te rrugica e jote. Në një farë mënyre kjo gjë duhet të marrë fund. Pres të më kthesh përgjigje." Mos kjo poezi e mrekullueshme i kushtohet kësaj vajze, që me sa duket e ka lënë pa përgjigje? Nëse ajo nuk e pranoi si partner, Kadare nuk e pranoi si kundërshtar.

Ti je një pardesy
Tek ti fëshfërijnë të gjitha:
mendimet, pardesyja, zemra.
Ti je një pardesy
dhe bota të duket si një sallon mode,
ku parakalon si pardesy e dalë prej
garderobe.

Ti je njeri-pardesy.
Të shoh tek zhdukesh përtej-fëshfërimë-
nëpër erë,

sikur të mos kesh qenë asnjëherë.
I njëjti dyf që ka zbrasur ndaj Kadaresë,
zbras dhe ndaj vajzës. Miqtë e tij tregojnë
se kudo që Bilali ecte fërshëllente melodi të
Bethovenit, duke më kujtuar Konicën i cili kur
shkruante fërshëllente arie operetash. Dhe në
dëshpërim do shkruajë:

"Askush,

Nuk do të niset për tek unë...
Ja, kështu do më rrjedh e tërë jeta,
Larg atyre që më deshën
Larg atyre që i desha."

I braktisur, i shkonte në mend të hidhej në rrotat e trenit, ndaj dalin dhe vargje të tilla kapitulluese: "Prita, ju më dëbua, po ndjek fatin tim të hidhur." Por cilët janë këta "ju", kur atë e deshën të gjithë?! Shprehja: "Prita, ju më dëbua" të duket si kod, duke e shtuar enigmën rreth vetes. Dhe vargjet e baladës çame: "Ne, popull, muhaxhir, ecim nëpër shi", përjetohet me nota autobiografike. (Kur kaloi kufirin, ishte në tokën e tij, por që e kishte i huaji.) Në poezinë "Busti i një djaloshi çam të vrrarë" parathotë fatin e tij tragjik, duke iu drejtuar të njëjtëve, që, ma do mendja të jenë zyrtarë, apo miq të rremë që i shërbyen shëfave të tyre, si e si të lanin hesapet me të dy shkrimtarët:

"Unë do ju shfaqem në errësirën me mjegull
profil i ngritur plot dhimbje dhe përbuzje.
Për mua s'do ju tregojnë gjë yjet, as erërat
as shndritjet e bronzëta të siluetës sime.
Për mua do dëshmojnë vetëm plagët e mia,
Për mua do dëshmojnë vetëm vdekja ime."

Duke lexuar librin e studjuesit Bashkim Kuçuku, si adhurues i të dy shkrimtarëve, sheh qartë se tentativa për t'i dhënë persekutoreve të Bilal Xhaferit konturet e fytyrës së Kadaresë, është një projekt i ideuar nga bota e nëndeshme, autorëve të të cilëve ende s'ua dimë emrat. Libri në fjalë ngre profilin plot dhimbje dhe përbuzje të Bilal Xhaferit, siluetën e tij të mbuluar nga mjegulla dhe terri, duke e shkëputur përfundimisht nga mendimi i përhapur si viktimë e Kadaresë. Ajo që zgjon interes të dihet: a u përdor ai nga të tretë? Mos duhet ta merrte në konsideratë këshillën e mikut të tij Ibrahim D. Hoxha, i cili pohon: "I thashë me singëritet që "mos iu fut kësaj pune, se kam frikë që dikush të ka mballosur ty me këto, se nuk duan të dalin vetë, por duan të të shtyjnë ty dhe ti hyn në sherr që të fitojnë ata"? Sipas meje, ata që duhet ta kenë nxitur dhe ai s' i tregojë kurrë, duhet të kenë qenë armiq të heshtur të Kadaresë dhe miqtë e tij të rremë, që i morën gjithçka së shkuarës, duke mos lënë përshtypjen e shërbëtorëve të saj dhe në kohën e re morën poza antikomunisti. "Pjesa më e madhe e njerëzve vuan dhe vdes, pa e kuptuar se kush i vret."-shkruan Ayn Rand në romanin e saj "Revolta e Atlasit". Zor se ka për t'u gjetur ndonjëherë se kush e vrau Bilal Xhaferin, nuk e kam fjalën për legjendat urbane, por për ata që ambicjet ia nxitën për të zezën e tij, që e futën në një betejë që s' ishte e tija. Studjuesi Bashkim Kuçuku i del garant lexuesit, shqiptarëve, duke u shprehur qartë: "Ismaili nuk reagoi në mbledhje, as më vonë, dhe nuk është gjetur ndonjë dokument, që të mbështes mendimin e përhapur, se ka vepruar kundër tij." Dhe këto i thotë njeriu, që e adhuron Bilal Xhaferin...





Foto nga Roland Tasho

Dy botime të reja nga Onufri dhe Trishtil,
“Njerëz normalë” nga Sally Rooney,
dhe “Më thirr me emrin tënd” nga André Aciman.

Njerëzit normalë thirren me emrat e njëri-tjetrit

Nga Andreas Dushi

Asnjëherë nuk do ta harroj tronditjen që më ka shkaktuar “Krim dhe ndëshkim”. Mrekullia e të përballurit me faktin se jo të gjithë mendojnë si unë edhe atëherë kur ndajmë të njëjtit parime, që një ndër befasitë më kuptimplota që përvojat e leximit më kanë dhënë. Ndaj, sado grishem prej dëshirës për ta rilexuar, kam frikë ta bëj, pasi e di se mahnitja do të thjeshtohet në një fakt kureshtar: Jam tronditur kur e kam lexuar. Kaq. Do ta them pa emocion dhe nuk dua që kjo të ndodhë. Sepse, sa më shpesh rilexoj libra që kanë qenë krejt jashtë sugjerimeve për moshën kur i kam lexuar për herë të parë, aq më konkrete më bëhet rritja ime të cilën, teksa ka ndodhur, s’kam pasur si ta vija re. Prandaj, dua ta ruaj të paprekur mënyrën feminare se si e kam ndierë “Krim dhe ndëshkim”, i sigurt në ndikimin që ka pasur për të ma bërë të qartë se letërsia është ajo çfarë duhet të bëjë.

Si produkt shoqëror, dija kufizohet me mundësitë e shprehjes së vetë shoqërisë. Sa më e palexuar të jetë ajo, aq më pak do të dimë. Sa më pak të dimë, aq më shumë do të tkurret aftësia për të menduar. Dhe po menduam pak, edhe më pak do të kërkojmë. Prandaj leximi është i domosdoshëm. Pastaj, rileximi si rivendosje e asaj çka ke lexuar në përmasën e re të dijes, të shprehjes, të mendimit dhe të kërshërisë ku gjendesh tani.

Për të gjitha këto, rileximi është një akt i guximshëm. Përballë tij, vetja kuptohet dhe ndryshimi përgjatë kohës vlerësohet. Kjo e bën librin shumë më të gjallë sesa një pjesë të mirë të njerëzve. Ai nuk perceptohet ndryshe vetëm ndërmjet lexuesve, por edhe tek një lexues i vetëm në kohë të ndryshme. Libri rritet a zvogëlohet ashtu sikurse lexuesi i tij. Pra, çdo ftesë për rilexim është një ftesë për të njohur veten. Një terapi e lirë dhe argëtuese. Një *self-help* estetik dhe jo patetik.

Kjo që ajo çka më nxiti t’i rikthehesha leximit të “Njerëz normalë” nga Sally Rooney. Vura re se, kur e kisha lexuar për herë të parë, kisha shënuar me laps në pjesën e brendshme të kopertinës së pasme: *s’mbaj mend n’kjosë mi ka përplot sytë një libër tjetër*. E kujtoja këtë përjetim, por, ndryshe nga rasti i Dostojevskit, arsyeja nuk më vinte ndër mend. Dhe e lexova prapë.

Kishte gjithë ato pjesë të nënvizuara. Disa me shenja që unë di t’i identifikoj si *sa e bukur, për t’u mbajtur mend* etj. dhe të tjera, me shënimin *përkthimi s’më pëlqen*. Besoj të ketë qenë libri i parë ku kam mbajtur shënime të tilla. Diku nëpër të, kisha shkruar se do të doja shumë ta kisha përkthyer vetë. Kjo dëshirë e atëhershme u kthye në mundësi të tanishme. Kështu, rileximit iu bashkëngjiti përkthimi dhe unë, prej kur e fillova këtë punë, mendova se do ta mbyllja me një artikull a pasthënie të

titulluar *ripërkthimi si rilexim*. Mbase edhe do ta bëja, sikur menjëherë pasi i dorëzova Onufrit përkthimin tim të ri, nuk do të më duhej të lexoja për herë të parë “Më thirr me emrin tënd” nga André Aciman, përkthyer prej Arbër Selmanit. Ishin dy libra që komunikoni me njëri-tjetrin. Të vija në pah këtë, ashtu sikurse edhe vështirësinë e krahasimit të një libri të lexuar rishtazi me një tjetër të rilexuar, kjo ishte më sfiduese për mua dhe më interesante për lexuesin e bezdisur prej minjve që pjellin malet e mbarsura me debate veç për hir të debateve, në çka rrezikonte të shndërrohej edhe *rileximi si ripërkthim* sepse e di se s’do ta mbaja dot veten pa krahasuar përkthimin tim me paraardhësin.

“Njerëz normalë”, botuar më së pari

më 2019, u bë menjëherë bestseller ndërkombëtar i cili riktheu vëmendjen edhe te libri i mëparshëm i Rooney-t, “Biseda mes miqsh”, që, meqë ra fjala, po ripërkthehet dhe do të botohet nga “Onufri” së shpejti. Ai trajton një histori krejt të thjeshtë: një djalë dhe një vajzë lidhen në gjimnaz dhe, meqë vajza është subjekt i përhershëm i talljeve, djali e mban të fshehtë marrëdhënien mes tyre. Ndërsa në universitet, situata sikur përmbysset, vajza është e famshme kurse djali, nëse njihet prej dikujt, i vetmi shkak është raporti i tij me atë. Ky çift dinamik që ecën mbi fijen e hollë të kësaj marrëdhënie toksike, thajse përherë i papërvijuar si çift romantik por më së shumti si dyshe e përkohshme, raportohet me mikro-dhe-makro-shoqërinë edhe si pjesë e brendshme


e tyrja, edhe si vëzhgues të jashtëm. Vajza, Mariana, ka opinione për çdo gjë, nga protestat lokale te situata politike kombëtare e te luftërat ndërkombëtare. Liria e Palestinës e mundon, ashtu sikurse mundon vërtetë edhe autoren e cila tani vonë rrezikon të mos i botojë më librat në Mbretërinë e Bashkuar pasi ka vendosur që një pjesë të honorarëve t’ia kalojë Palestine Action, e paligjshme me vendim qeverie për shkak të luftës kundër terrorizmit. Pavarësisht kësaj lirie në të menduar, ajo pyet përherë veten se si situata ku gjendet, sado e përditshme të jetë, do t’i dukej Konellit, djalit pra. Çfarë do të mendonte ai për të? Si do ta gjykonte? Po të ishte në vendin e saj, si do të vepronte?

Ato vërtetë njihen në shkollë, por lidhen tjetërkund, në shtëpinë e saj, ku e ëma e atij punon si pastruese. Sa herë gjërat duket se marrin për mirë, krisen aq pa u vënë re, thua kushtet për të qenë larg njëri-tjetrit enden dalëngadalë me durimin e një merimange të vogël e rrjetëhollë.

Sikurse Shën Pali thotë, në fund mbeten tri gjëra, feja, shpresa e dashuria. Në këtë roman, fe nuk ka, shpresa vdes e para dhe dashuria sikur vazhdon ashtu e brishtë dhe e tkurrur brenda çasteve të vogla ku të dy kalojnë mirë deri sa ndjejnë se po dëmtojnë tjetrin e, për rrjedhojë, veten. Mariana dhe Konelli nuk janë vetëm dy të rinj, janë dy mostra nga më tipikët të brezit të tyre, prandaj libri aq sa rezonon me milenialët dhe brezin Z, aq edhe komunikon me prindërit e tyre, jo duke ua bërë më të thjeshtë për t’i njohur fëmijët, por duke ua shpjeguar më konkretisht botën ku edhe ata, edhe fëmijët e tyre po jetojnë sot. Një botë e shthurur nga ndikimi i kapitalizmit dhe e mbërthyer prej arrogancës së më të fortit, sidomos kur ky i fundit nuk është një njeri i vetëm me emër e mbiemër, por një sjellje e kthyer në fenomen mbarëshoqëror. *Prano hem shoqërisht, prandaj jam*, mund të ishte një devizë e saktë për Konellin.

Mariana, nga ana tjetër, ka përjetuar një shtypje sistematike brenda familjes. Sado përpiqet, e ka të vështirë të jetojë pa të, ndaj e kërkon me këmbëngulje. Kur Konelli nuk ia jep, tëhuajsohet. Kur të tjerët ia ofrojnë, dëshpërohet.

Kryesisht, romancat komplikohen prej faktorëve të jashtëm. Dy të dashuruarit janë të marrosur pas njëri-tjetrit dhe rrethanat nuk i lejojnë të jenë bashkë. Letërsia klasike është plot me to, mjaft të kujtojmë Romeon me Zhulietën, Anën me Vronskin, Frederikun me Katerinën e sa e sa të tjerë. Po në ato raste kur *dy të marrosurit pas njëri-tjetrit* duket se e kanë në favor gjithë çka i rrethon, çfarë ua komplikon marrëdhënien? Vetvetja! Problemet e trashëguara e të patrajuara. Trauma mos frikërat do t’u konkretizohen. Mungesa e besimit dhe besimi se mungesa është e pashmangshme. Prandaj “Njerëz normalë” është tronditës për nga thjeshtësia dhe mahnitës për nga brutaliteti i asaj *normaleje* me të cilën të përball. Sado të përgatitesh, prapëseprapë gjendesh i pazoti të reagosh disi. Nuk mund ta gjykosësh qasjen vetëshkatërruese të Marianës e as nuk mund ta pranosh qasjen vetizoluese të Konellit. Të dy e mbartin procesin e rritjes si një barrë të rëndë, të përhershme dhe të panjohur e pikërisht prej kësaj, pra meqë nuk e njohin, as që përpiqen ta largojnë. Ata besojnë se ashtu janë, se ashtu duhet të jenë, se ashtu do të jenë përherë. U duket sikur e kanë pranuar veten, por s’është tamam kështu: Kanë pranuar se kanë ngecur në grackat ku i ka mbyllur e shkuara e jetuar dhe e pësuar. Prandaj, sa herë përpiqen të rriten, përpjekje që zakonisht orientohen nga njëri për te tjetri, pra Mariana do të ndihmojë Konellin të rritet dhe anasjelltas,





vetësabotohen dhe nuk e lejojnë procesin të ndodh. *Two lost souls swimming in a fish bowl*.

Në romanin tjetër, dy personazhet kryesorë vijojnë të jenë shpirtra, ama këtë herë janë shpirtra të gjetur të cilët po notojnë në një det të stërmadh të panjohurash. *Two found souls swimming in a big sea*. Ashtu si Mariana dhe Konelli, marrëdhënia u sendërtohet në mënyra të çuditshme, deri sa binden se nuk ka më kuptim të hiqen sikur po përpiqen t'ia fshehin njëri-tjetrit dëshirën e tyre të përbashkët. Të dy e dinë se të dy e dinë që e pëlqejnë njëri-tjetrin. Por prapëseprapë, dëshira karnale, epshi instiktiv vijojnë të veprojnë egërsisht nën petku e qetësisë më të bindur ndaj heshtjes së imponuar prej intelektualizmit.

Janë dy djem, Elio dhe Oliveri. I pari, shtatëmbëdhjetë vjeç. I dyti, njëzetekatër. Babai i të parit, profesor ordinar, ka një vilë në një bregdet italian ku kalon verën bashkë me familjen dhe çdo vit, fton një profesor a kërkues të ri t'u bashkohet dhe atij që vjen, i ofron një si tip rezidence verore ku mund të punojë me librin a studimin e fundit që ka ndër duar. Mysafiri jeton aty, në shtëpi, bashkë me familjen, si pjesë e saj. Atë verë kur ndodhin ngjarjet, i ftuari është Oliveri, një profesor i ri nga Amerika të cilit i po i përkthehet në italisht një libër ndaj edhe i duhet të punojë ngushtësisht me përkthyesin dhe botuesin që libri të bëhet gati për botim. Prej se e sheh, Elioja e di, e kupton, nuk do t'ia dalë të mos e mendojë atë me veten e vet, atë brenda vetes së vet.

Sërish nuk janë rrethanat që e ndërlikojnë marrëdhënien; frika prej tyre e vonon atë, e vonon, e vonon, e vonon deri kur nuk ka më kuptim, nuk ka më kohë, duhet vepruar dhe ashtu ndodh, veprohet, jetohet, arrihet ajo nirvanë që mandej, edhe kur mbetet veçse një kujtim i largët, të lumturon sa herë e sjell në mendje. Por para se të shndërrohet në të tillë, dashuria nga një motor veprues e nxitës, shërben si një pengesë ndaluese dhe pritëse. Asnjëri nuk nxiton, sepse secili dëshiron ta ruajë tjetrin. Tjetri është më i rëndësishëm, herë sepse po u kalua kufiri, mund ta humbasësh edhe si mik e herë të tjera ngase, meqë është e qartë se ajo çka dëshirohet nuk mund të sjellë asgjë të përhershme, tjetri mund të lëndohet. Gjithçka e kësaj bote është e përkohshme, prandaj përgjithësisht njerëzit janë kaq të trishtë.

"Më thirr me emrin tënd" e zhvendos narracionin në një ligjërim shumë të lartë, fjalët përzgjidhen me kujdes prej njerëzve që janë rritur me kujdes dhe që, gjithë jetën e kanë ngritur mbi respektin më të thellë ndaj gjuhës. Gjuha nuk është më vetëm mjet për të shprehur, por shprehia vetë është një synim i arritur. E folura ua përcakton tiparet, deri edhe ato fizike. Prandaj, libri jo vetëm rrëfen, por flet gati konkretisht, duke

u kthyer në një album për regjistrat më të epërm të gjuhës.

Nëse dashuria ku kishin rënë Elioja dhe Oliveri do të ishte e njëjtë me të gjitha dashuritë, mohimi i saj do të rezultonte me një ftohje të natyrshme deri te ndarja e pashmangshme. Por jo, dashuria e tyre ishte thujse lëndore, kishte një jetë të sajën aq të pavarur prej tyre sa që, kur e vuri re se asgjë nuk po ndodhte, iku dhe ra ajo mbi to. Vetëm atëherë kur dashuria ra mbi Elio dhe Oliverin, yjet u renditën si shigjeta e Kupidit që shponte njëra pas tjetrës shenjat e horoskopit të të dyve.

Aftësia e të tjerëve, sidomos e babait të Elios për ta kuptuar këtë e po ashtu, mënyra se si të dy personazhet tona rriten të pashkëputur prej harresës ndonëse thujse

pa asnjë komunikim, si dhe fatet e rrugët e ndryshme që jetët e tyre marrin, i kthejnë ata në bartës të lajtmotivit se bota si e tërë s'është gjë tjetër veçse mënyra se si botët e vogla të njerëzve komunikojnë dhe lidhen me njëra-tjetrën. Pikërisht ky komunikim i çalë e i copëtuar duhet të jetë shkaku pse kjo botë si e tërë, shpesh dështon t'i kalojë kufijtë e botës së një libri. "Më thirr me emrin tënd" është ngushëllim për gjithë të palumturit e kësaj bote dhe ndonëse nuk synon të japë e as nuk jep kurrfarë mesazhi, mbart brenda vetes kumtin se *mbas bore t'dimnit çilet prendvera*.

Dashuria është personazh në të dy këto romane. Te të dy trajtohet ndryshe, ama pa qenë kundërtë, por përplotësuese. Nëpërmjet "Njerëz normalë", njohim atë

dashuri të vrullshme së cilës i paraprin gjithë diapazoni që dikur mund të imagjinohej vetëm brenda dashurisë. Pra, ndonëse çifti është tradicional, një djalë dhe një vajzë, sjellja e tyre është krejt liberale: pa u dashuruar, jetojnë gjithë çka hamendësohet si ekskluzivitet i dashurisë. Mariana dhe Konelli njihen, fshihen, bëjnë seks, ndahen, harrohen, marrin vesh se marrëdhënia e tyre e fshehtë kishte qenë publike, rinjihen, dashurohen ndahen, pajtohen, ndonëse të dashuruar jetojnë si miq-me-benefite, ndahen prapë, i prezantojnë sho-shoqit të dashurit e rinj, ndahen prej tyre, pajtohen prapë me to, pastaj me njëri-tjetrin e sa e sa mikrosituata të tjera, deri sa vjen fundi i pafundëm.

Ndërsa te "Më thirr me emrin tënd", çifti është liberal nga çdo aspekt, dy djem, diferencë në moshë, situatë e ndërlikuar, patjetërshmëria e fshehtësisë e sa e sa të tjera, por pavarësisht kësaj, dashuria ndodh në rendin e zakonshëm e të natyrshmërisë së saj: ata njihen, pëlqehen, dëshirohen, dashurohen e mandej bëjnë dashuri. Se nuk ka kuptim të them çfarë ndodh më pas.

Më kujtohet një shprehje nga "Faji në yjet tanë" i John Green: *Ne nuk mund të zgjedhim nëse do të lëndohemi apo jo, por kemi njëfarë mundësie për të zgjedhur nga kush mund të lëndohemi*. Në këtë pozitë, në këto romane, është vetë dashuria. Ajo asnjëherë nuk i lëndon personazhet e tjerë, por vetëm lëndohet prej tyre. Te "Njerëz normalë", shmanget dhe nëpërkëmbet prej rrethanave të mburitura shumë para ardhjes së saj. Te "Më thirr me emrin tënd", fshihet dhe përthyer, deri sa i bëhet e qartë se në fakt, përkthyerja është mënyra se si farkëtohet dhe kthehet në portë sublime të lumturisë. Dashuria pra, në të dy këto romane, nuk është gjendje, ndjenjë jo e jo. Ajo shoqëron personazhet si njëri prej tyre dhe ndonjëherë, merr edhe rolin e bashkautorit.

Ka disa balona aq të mëdha, sa që e vetmja mundësi për t'i mbajtur në ajër është po të kenë dy fije që i tërheqin dy njerëz të ndryshëm, të cilët vrapojnë në sinkroni të plotë. Kështu është dashuria në këto dy romane. Njëra prej fijeve të saj është në Romë mes duarve të Elios dhe Oliverit, kurse tjetra, në apartamentin e vogël dublinas të Marianës, ku Konelli s'e kupton dot arsyen pse ajo i bindet çdo dëshire të tij. Këtë të dytin nuk e lëviz askush, ndërsa me të parin, ata që e mbajnë vrapojnë me nxitim. Prandaj duhet lexuesi, t'i balancojë lëvizjet me përvojën e vet. Ashtu do të mundet ta zbulojë se në cilën anë përket. A është njeri normal, dikush që do ta thërriste tjetrin me emrin e vet apo një njeri që do ta vërtetëjë bindjen time pas leximit të këtyre dy librave, se *njerëzit normalë thirrren vetëm me emrat e njëri-tjetrit?*

André Aciman



Më thirr me emrin tënd

Përktheu: Arbër Selmani



Rrëfimi në prozë është forma më totale e Rrëfshëtitimit të fakteve me fiksonin, të cilat së bashku krijojnë përfytyrimin e jo vetëm një epoke, e jo vetëm një ngjarje, e jo vetëm një personaliteti të njohur apo inekzistentë fare!

Në romanin e Mira Meksit *"Ikona e Plagosur"*¹⁾ hyn një çast fluturak i ngrirë në imazhin monumental, fati i një ikone e cila bëhet pasqyrë reflektimi, rrezet e së cilës depërtojnë në thellësitë më të largëta të hapësirës së "ndikimit" arbëror! Në periferi përmes detajeve dhe dromcave jetësore dhe "arratisjes" së familjeve pas vdekjes së kryeheroit, Skënderbeut! Intriga është aq reale sa që kapërcen "labirintin" e të dhënave historike për t'u ngulitur thellë në dilemën e lexuesit modern për një "mot të madh", i cili vështirësohet në kohërat e mykura nga perandoritë "kalimtare" në Ballkan. Prandaj "nëse e vërteta epike rrjedh nga kujtesa kolektive, që ajo vërteton, romani e nxjerr të vërtetën nga lidhja e një fiksoni."²⁾

Narracioni është renditur duke i dhënë vëmendje përmbajtjes të një ikone në varësi nga veprimi i karaktereve, dhe në fund i personazheve, Arbrit dhe Vetonit.

Përngjasimet dhe huatë krijuese "imagjinare" për analogji

Botim klasik. Struktura ka rrjedhë ideale të formatit të përpiktë. Shënim për romanin I-XIX faqe (Mbititulli: "Kur letërsia i huan zërin e saj historisë". Titulli: "Si është shkruar ky libër"). Tekst-botimi fillon më saktësi nga 1 deri 319 faqe në tërësi: Shtatë emërtimet e kapitujve: "Zbulimi i atë Isaisë" (f.1-28), "Napoli Portat e fshehta të universit dhe kohës" (f.29-49), (f.50-92), (f.93-122), (f.123-132), (f.133-163), "Në Valencia" (f.165-179), "Manastiri Mbretëror i Trinisë së Shenjtë" (f.181-203), "Ditari i Alfons Kastriotit" (f.205-249), "E fshehta e Ikonës së Plagosur" (f.251-266) dhe "Mali Athos dhe Pirgu i Arbrit" (f.267-319). Nga njëmbëdhjetë (?) pjesët, katër të paemërtuara. Në mes "kapitulli" që ndërlihd në vete kohën e personazheve dhe kohën e dokumenteve. Tri pjesë "zhvendosen" në gjysmën e dytë të shekullit XV.

Autorja Mira Meksi³⁾ në fillim si hyrje ("Si është shkruar ky libër") flet për "trillin romanor" dhe "deduksionet dhe hamendësimet e historianëve" që përgatit lexuesin me "vërejtje" këshilluese në rrjedhën e të dhënave që përfytyrojmë që në titull të këtij prologu "Kur letërsia i huan zërin e saj historisë".

"Teknikat letrare që shkrimtari përdor kanë mundësi të krijojnë metafikson historiografik, pra të krijojnë një trill romanor me bazë, sfond apo nuanca historike, i cili shkon përtej kufirit ku ka mbërritur historia. Gjithsesi, në këtë roman, ku nuk mëtojt assesit të jap të vërtetën historike, trilli shkon në një drejtim me deduksionet dhe hamendësimet e historianëve dhe të historisë për temën në fjalë. Konvergojnë në një pikë."⁴⁾

Përgjasim shëmbëllimi pa lejen e autorëve shtesë të fusnotave në kushtim të citatit të munguar që ka të bëjë me përfytyrimin e pamjeve të të moshuarit të verbër, në analogji të kundërtë me "krijimin e rastësishëm", thënie e Borgers-it: "Fatit i pëlqejnë përsëritjet, motërzimet, simetritë...". Autorja Mira Meksi shkruan në faqe V (romak): "Për Ismail Kadarenë, Mjeshtrin e Madh të gjuhës shqipe, që më nxiti të kërkoj letrarisht varrin e fshehtë të Skënderbeut". Seç iu ktheva viteve të hershme të njohjes me letërsinë. Me librin. Dhe në kushtim, si homazh dhe përngjasim: Për Bajram Krasniqin, Studiuesin e Madh të prozës shqipe, që më nxiti të afrohem, të parapërgatitem më mirë që të njoh dhe të rilexoj në të ardhmen romanin *"Ikona e Plagosur"*.⁵⁾

Që në fillim ngjasimet e personazheve me Borgesin. Trilli deri në krahasim për një njohje rrëfimtare. Personazhi Arbrit i pati rrëfyer Norës se "vetvrasja e tij e dështuar ngjasonte pikë për pikë me atë të shkrimtarit të madh argjentinas Jorge Luis Borges, sipas asaj që djaloshi kish lexuar vite më vonë: "A e beson dot, Nora, se vetvrasja e dështuar e Borges-it u projektua e saktë dhe e plotë mbi vetvrasjen time pas më shumë se gjysmë shekulli?"⁶⁾ Kulmimi i plotë analogjik me një vetvrasje të munguar. Me Borges-in e paprekshëm! "...vetvrasja e munguar e Borges-it u projektua me një saktësi

Për romanin e Mira Meksit "Ikona e Plagosur"

Dekonstruksioni identitar dhe autenciteti i plagosjes së ikonës

Nga Enver S. Morina

Rrëfimtari ka kapërcyer pamjet e ngrira të veprave historike, të dhëna të cilat bëhen paradigme e përkryer si shije e të bukurës historike, aromë e këndshme dokumentare, dije për të kaluarën e ritreguar dhe mbresëlënëse në diskursin e dekonstruksionit të përsosur letrar-artistik...

halucinante mbi mua." (f.12)

Enumeracioni i veprimit në dhjetë fjali (f.6, 7 e 8) në të cilat veprimi folor shpërfaqet e tërë qyteti i Vlorës me shenjzimin semantik që nga parahistoria deri tek kohërat moderne: ... *t'i fliste...* (për rrënojat antike, kujtesën e vjetër, labirintet e ngjarjeve...), *T'i rrëfente...* (për një Pazar shumë të vjetër ëndrre...), *T'i përshkruante...* (një park magjik me pemë të larta në Rrugën Vlorë-Skelë...), *Ta ngjiste...* (në një kullë sahati...), *ta shetiste...* (në një rrugë të ngushtë që quhej Rruga e Jahudive...), *Ta shoqëronte...* (pranë varrit të një heroit në shesh...), ... *ta njihte...* (me varrin mitik të një pashai me emrin Kuzum Baba...), ... *Ta merrte...* (për dore...), ...*të ecnin...* (në kujtimin e një rruge magjike pranë Sheshit të Flamurit...) dhe ...*të shpinte...* (në një kishë me derë druri të blertë...).

Me maturi rrëfimi autorja hy tek leximi. Çështje leximi? "Emocionet e leximit të një libri të mirë janë vetë jeta...". Tej leximit "na pret" zbulimi. "...me mendje të kënaqësia e papërskrueshme e leximit dhe e zbulimeve, që të ndihesh eksploatori i vetëm i aventurave." (f.11)

Gërshëtimi mes zbrazësisë dhe "kaosit" mund të takojë "valë elektromagnetike që vijnë nga e kaluara dhe nëpërmjet tyre të udhëtojnë pas në kohë." (f.14) dhe "mund t'ia dalë të lexojë edhe libra që ende nuk janë shkruar." (f.14)

E kaluara thellësisht e përjetuar në dimensionet inteligjente dhe futja në fletet e pashkruara të librave. Isai a "prifti me kobure", patriot i rryer dhe i dëshmuar vdiq, thotë rrëfimtari, "në kampin e përqendrimit nazist në Zemun pranë Beogradit." (f.16) Autorja përmes personazhit të Isait plotëson një personalitet shumëdimensional, një krijues që i ngjar personazheve më kuptimlote për të njohur fatin e shumë figurave "të humbura" të botës shqiptare, jo vetëm në gjysmën e parë të shekullit XX.

Dualizmi enciklopedik i një diskursi letrar në prozë mes një forme "klasike"

"Shkolla e parë e Vlorës në Muradie (1908)" (f.16). Për Ne shqiptarët e Kosovës, të zbulosh këtë lagje kaq vonë, në përmasat e saj historike në të cilën është në ndërtim Muzeu "Kosova", dhe ta hasësh në roman është një ndjenjë refleksioni dekonstruktiv hja e të cilit ndërlihd vende e epoka.

Rrëfimi është dije të dhënash historike dhe njohuri "të reja" emërtime hyjnish, imazhe dhe pamje ikonash deri tek ikonat e çmuara të Shën Sofisë të Konstantinopojës të cilat ruhen në Manastirin e Vatopedit në Athos. Personazhet kryesor veprues Arbrit e Nora ndërtojnë dialogun përmes "shpejtësisë" së pyetjeve të përgjithshme, të përgatitura a të papërgatitura profesionalisht dhe pyetjeve të goditura e të sforcuar në dëndësinë e një imazhi të çastit. Arbrit përgjigjet: "Dëgjo, Nora. Që të jam më i qartë, kjo ikonë, ashtu si edhe të tjerat që përfaqësojnë artin më të lartë ikonografik (nënvizimi ynë-e.s.m.), shërben që nëpërmjet imazhit të dukshëm ta fusë admiruesin e saj në të padukshmen, transhendenten, të paarrtshmen... Pra, ta çojë atë që di të lexoj ikonën te kumti a shenja që mban të fshehur, ose te zbërthimi i kodit

që gjendet i trupëzuar në të. Këtë çelës", po e quaj unë, kishte si objekt studimi atë Isai." Një hyrje "shkencore" dhe rrëfim dijeje, të dhënash për të zbuluar në kapitullin e parë (f.1-27)...

...

Në përballjen diskursive dhe të njohur mes personazheve për kujtesën e trashëguar që sipas tyre ka vetëm dy shekuj që studiohet, autorja përmes personazhit thotë: "...kujtesa duhet të konsiderohet si një aftësi e qenësishme e lëndës sonë cerebrale që iu nënshtrohet ligjeve fizike. Ajo bën unifikimin e së tashmes në një organizëm me të kaluarën e tij, jo vetëm gjatë jetës së tij, por edhe gjatë brezëve. Ajo shtrihet në të gjitha qelizat e organizmit, duke përfshirë edhe ato germinale dhe bëhet kështu mbështetja organike e trashëgimisë së fituar." (f.113)

Gjatë leximit seç ndërhyt tek lexuesi, dekonstruksioni tekstori i Ismail Kadarese. Faqe 147. Personazhi i Stresit, Besa e dhënë e Konstandinit dhe besa ndaj Krishtit nën përfytyrimin e Milloshit dhe dashuria e kthimi në atdhe, në Arbëri, përmes Norës, si tek "Kush e solli Doruntinën"...

Një thënie metaforë e cila e tejkalon metafizikën rrëfimtare për një kujtesë të përhershme kulmore artistike: "Aroma e luleve të thara është aromë e fuqishme e kujtimit... Është aroma e shpirtit." (f.148)


Edhe pse nuk është shënuar në libër, romani sikur ndahet në dy pjesë të barabarta. Pjesa e parë përfundon me udhëtimin në Napoli dhe kthimin në atdhe te personazheve kryesor Arbrit dhe Norës. Atmosfera e rrjedhës historike është e përpiktë.

Kapitulli emërtues "Ditari i Alfons Kastriotit" është një ditar shkencor historik. Rrëfim për diçka reale e cila në rrjedhën e saj krijohet epoka, krijimi, ikona, vërtetësia. Një epilog i shkrimtares i ndërtuar në kohë krijon prolog dhe përfundimin e një romani. Pjesa "Ditari..." është një përshkrim kronikal e portretizues në veten e tretë! Përsosur-gërshëtim përmes reflektimesh. Në qendër dhe në funksion të hyrjes në epokën "e errët" dhe në hapësirën e të panjohurave qendron "Ditari i Alfons Kastriotit", jo në formatin klasik por një ditar-studim kritik letrar. Nëse për shekullin XV janë të rëndësishme kronikat, letrat, janë relacionet që i mungojnë arkivit, muzeut. Një rrëfim për ditarin. Leximi dhe përshkrimi i tij. Një formë e ditarit, përmbajtjes, brendësisë së tij në vepër. Dilemat mbeten tek titullëzimi i kësaj pjesë. Autorja këtë ditar e kthen në rrëfim, në një vepër epike në prozë, në tregimtar. Dualizmi enciklopedik i një diskursi letrar në prozë mes një forme "klasike" dhe studimi të ditarit në një vepër të re, pjesë e romanit (f. 205-249)...

...

Në kërkim të tri parimeve klasike të dramatikës: **Të gjejmë kohën** nëpër vite shekuj e mileniume..., **Të gjejmë hapësirën** nëpër kontinente, detëra dhe qytete e fshatëra... dhe **Të gjejmë veprimin** nëpër krijime artistike, politike, ekzistenciale të luftërave, në jetën e një kombi.

Përshkrim brilant i historisë së Kishës-Katedrale-Bazilikës së Valentias nga rrënojat e Tempullit të Jupiterit në epokën vizigote, të pushtimi arab dhe të mbretit Jaime!



(f.231) Historia e një monumenti historik në ingranazhet e trandjes së një epoke në të cilën periudha e errët dhe e heshtur në fshetësinë ideolatrike vjen e bëhet e zhurmshme, ka paradigma letrare dhe kode që paralajmërojnë një realitet tjetër. Një preheje a grisje në thellësinë e krijimit ikonik bëhet diskurs për një aoreolë paprekshmërie të një fisnikërie, shembëlltyra e të cilës do i mungoj përgjithmonë pasardhësve.

Kapërcimi i Un-it të shkrimtares nga rrëfimi tek historia e një realiteti të largët historik

Nëse Balzaku rreth 200 vjet më parë thotë se "arti është të zgjedhë pjesët e shpërndara të natyrës, detajet e së vërtetës, për të formuar me to një tërësi homogjene"⁸⁾ është Mira Meksi që përmes romanit *"Ikona e Plagosur"* të zgjedhë intrigën e shpërndarë nga Napoli, Valensia, Athosi, detajet rrëfimtare përmes epokave për të na dhënë "shekullin e plotë" të një nga enigmave më të mëdha, vendndodhjes të varrit të Skënderbeut.

Të jetë i panjohur Barleti në periudhën e vet për t'i munguar veprës së personazheve kryesor te Mira Meksit?

Kërkimi i eshtrave të kryeheroit?! Ku prehen eshtrat e bashkëlufëtarëve të Skënderbeut?⁹⁾ Romani *"Ikona e Plagosur"* merr shkas nga një vepër arti. Nga një ikonë. Nga një detaj. Një përshkallëzim thellësisht zbritës nën sipërfaqe. E kundërta e gjithë këtij procesi: rrjedha deri tek lexuesi.

E fshehta "misterioze" nuk është enigmë në epilogun e rileximit të romanit te Mira Meksit. Ecejakët e personazheve kanë paradigmat e njohura në peripecitë të rrjedhën e pasqyrimit historik në vendet e rrjedha për ndodhitë e rizbuluara përmes fondit letrar të autores.

Leje, lë të pushoj vepra dhe "historia". Rrëfimi të marr frymë në vete. Mjaftë e ke trazuar me rileximin e saj. Ke shkruar për të. Pusho! Të kërkon vetveti. Këto shënime i shkruan duke u ndalur për një çast veten që ta lësh të lirë ecejakën dhe e gjithë rrëfimin në studion tënd! Pas një pauze të domosdoshme shkrimi të thërret për të paralajmëruar që ta rishkruash, të ndërhysh qetazi në gjithë ato ngjarje e personazhe, në gjithë atë intrigë dhe botë e cila është krijuar nga autorja. Ky zë nuk të lë rehat si vet vepra dhe siç i ndodhi autores me historinë. "Huaja" do të të hakmerret që të trazos sa herë që historia dhe letërsia flasin me gjuhën e tyre në gërshëtim kujtese e harrese, në diakroninë dhe sinkroninë e përsosmërisë krijuese-artistike.

Pierre Chartiert duke shpjeguar për surrelizmin flet për "aktivitetin e lirë të shpirtit" dhe Ne sikur shohim tek autorja dhe rrëfimtari pikërisht këtë diskurs krijonjës përgjatë jo vetëm të kaluarës por edhe si "ndërhyrje" në historinë e ardhshme duke shenjuar hapin e parë origjinal të çthurjes së enigmës.

Nëse Dikushi, që kemi pak shpresë që ekziston, le ta ekranizoj që t'i afrohem edhe përmes imazhit real. Pëlhura e thellon të vërtetën e shekullit XV, epokë që i kthehem përherë. Rrëfimi shpiket, forma mbetet konservatore. Thyerjet janë të rralla. Universi romanesk është i pakufishëm. Në histori vlen koha. Katër kohët e romanit historik janë: **Koha e rrëfimtari** (Koha e shkrimtarit, Koha e personazhit), **Koha e lexuesit** (Koha e kritikut, Koha e rileximit), **Koha e subjektit** (Koha e ngjarjes), **Koha në kohëreale** (Kohërealja në kohë(n) e rrëfimi(t), Kohërealja në periudhën e

ngjarjet, Kohërealja e rileximit në uverturën e leximit të parë)...

... Çështje "liria delikate" dhe "shkolla e vështrimit" terminologji e huajtur nga studiuesi e kritiku francez Pierre Chartier? Të humbur nëpër kohë, përmes hulumtimit të fatit të ikones prehet "liria delikate" i një fati të tërë të një epoke, thërmijat e të cilës prehën në çdo periudhë të kombit dhe civilizimit tonë. Romani i ri. Asgjë nuk e trazon hulumtimin para vështrimit të objektit dhe të të dhënave historike. Sa më në thellësi hyn tek rrëfimi i Mira Meksit shpërfaqet vepra e Barletit dhe gjitha ato tregime për fatin e Motit të Madh në ardhmëri dhe gjetjes së eshtrave të kryeheroit. Nëse është thënë dhe përsëritet edhe te "Fjalori i kritikës moderne" se "letërsia nuk i takon një periudhe por është mbikohore"¹⁰ atëherë tek romani "Ikona e Plagosur" jo vetëm që gërshëtohen kohet në format e rrëfimit por edhe përmbajtja në subjektin e të dy periudhave.

Njohësit e kritikës të historicizmit flasin për lexuesin modern "Lexuesi modern është, i prirur të sjellë në letërsi vlerësimet dhe asociacionet e shkuara duke pasur parasysh se qëllimi i historizimit është që t'i bëjë veprat e peridhave të ndryshme më të pranueshme për këtë lexues modern duke rikonstruktuar përvojën historike ashtu si ajo ndikon kuptimin dhe gjykimin e veprës në shqyrtim."¹¹, derisa ne si lexues tashmë në një periudhë delikate i vëmë në qendër të interesimeve kundërshtuese.

Historia dhe artefaktet që kishin të bënin me shqiptarët erdhën dhe u bënë pjesë e historisë evropiane, një rrugëtim ky nga Arbëria tek Italia, Spanja dhe "kthimi" në Greqinë "antike". Autorja Mira Meksi përmes këtij romani sikur vjen e bëhet "përfaqësuese" e një epoke duke gërshëtuar un-in e saj krijues, nëse parafrazojmë studiuesin Bajram Krasniqi, me zënie vend të një ideologeje, të një filozofeje dhe të një historianie për t'i shtuar edhe të një enciklopedisteje të koheve moderne. "Kuptimi i romanit si fotografi epike e botës, ka gjetur shprehje të plotë në prozën që e trajton të kaluarën historike. Romani historik, duke dashur të rikrijojë artistikisht të kaluarën e largët, apo të afërt, ta rrokë atë në gjerësi dhe në shumë plane, sikur deshi t'i konkurojë historisë. Për këtë arsye, në të gjejmë mjaftë referenca historike, ekonomike, sociologjike, etnografike etj."¹²

Ngjarjet rrjedhin nëpër shekuj, personazhet levizin në hapësirë të pafundme

Në indeksin e emrave jo vetëm të personazheve, por edhe të institucioneve kanë zënë vend numër i pafundëm i tyre në hapësirat e romanit për ta njohur tërë madhësinë e arkitekturës morfologjike të një periudhe.

I vendosur në një kohë të gjerë 2300 vjeçare (315 para Krishtit-1999) në roman në një "thuarje" më të detajuar nga viti 1178-1999 janë tri periudha më të ngjeshura në vite që vendosen ngjarjet përgjatë shekullit XV (1405-1499), fillimi i shekullit XVI (1500-1517) dhe fundvitet e shekullit XX (1997-1999)...

... Në romanin "Ikona e Plagosur" në të cilin gërshëtohen kohet, gjithashtu indeksi i emrave fillimisht i vendeve pastaj i "institucioneve" kapërcen limitet e harresës dhe kujteses duke u bërë enumeracion i pafundmë i tyre në përmasa enciklopedike: Ishulli i Sazanit, Skela e Vlorës, shtegu i Cesarit, Shpella e Haxhi Alisë, Sheshi i Flamurit, Mali i Shenjtë Athos, Kepi i Posillipo-s, Kepi i Rodonit, Shtegu u Perëndive, gjiri i Solernos, Gjiri i Napolit, Malet e Vetëtimës, Malet Akroheraune, Gadishulli Apenin, Porti i Pastrovçit, Porti i Palermos, Mesdheu Perëndimor, Gadishulli Italik, Qyteti i Diellit, Toka e Thesalisë, Porti i Dafnes... etj. pastaj Fakulteti i Historisë, biblioteka e Lagjes Nr. 4 në Tiranë, kancelaria italiane e Giuseppe-s, Manastiri i Hilandarit, biblioteka e Eqrem bej Vlorës, Sarajet e Syrja bej Vlorës, Manastiri i Vatopedit, Vëllazëria e Dragoit, Muzeu Historik i Fierit, Departamenti i Historisë së Mesjetës, Universiteti i Napolit Frederiku II, Manastiti Santa Chiara, Instituto Sanseverino Orientale, arkivi i Dukatit, Palazzo Sanseverino, Universiteti i Bolonjës Alma

Mater Studiorum, Kalaja e Kaninës, Bazilika e Santa Restituta-s, Kishëza Santa Maria del Principio, Pallati Diemoede Carofa, kështjella e Monte Sant'Angelo-s, Biblioteka e Castel Nuovo, Katedralja e Krujës, arkivi i Vatikanit, Senati i Venedikut, Galeria Uffizi, Manastiri i Kapuçinëve të Amalfit, Opera Garnier e Parisit, arkiva e Papatit në Romë, tempulli i Osirisit, Pallati i DonnAnna, Kështjella Capua, Kalaja e Shkodrës, Kalaja e Ljeshit, Manastiri i Shën Angjelinës, varret e ilirëve në Selcë, Kështjella e Otrantos, kështjella e Sopotit, Kështjella e Sopotit, kështjella e Stekulit, arkivi i Beogradit, Qendra e Restaurimit të Shkrimeve dhe Paleografisë në Romë, Universiteti i Valencias, Sigurimi i Shtetit, Panairi i Krishtlindjeve, Kisha San Francisco, Teatri San Carlo, Departamenti i Historisë së Mesjetës në Universitetin e Valencias, arkivi mretëror i Valencias, Biblioteka e Valencias, arkivi i Bashkisë së qytetit të Valencias, arkivi qendror i Madridit, Kisha San Nicolas de Bari, Manastiri Mbretëror i Trinisë së Shenjtë në Valencia, Akademia Mbretërore e Historisë në Madrid, Kishëza e Virgjëreshës së Strehës së Mëkatarëve, Vëllazëri e të Devotshmëve të Ikonës, Biblioteka bashkiake Serrano Morales, Universiteti i Bolonjës, Pallati i 300 Drynave, Kishëza e Santa Catalina-s, Hospital d'Innocents, Kishëza Palatine, Manastiri serb i Hilandarit, kështjella e Monte Sant'Angelo-s, Universiteti Mjekësor i Parisit, kisha e Manastirit mbretëror të Santa Trinidad, Kisha Katedrale-Bazilika e Valencias, Tempulli i Jupiterit, Porta e Apostujve, Kisha e vjetër e Santo Cäliz-i, Pallati i Santo Oficio, Sinagoga Mayor, diogjeza e Valencias, Pallati i Markezit te Don Aguas, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Katedra e Gjuhësisë Historike e Universitetit të Tiranës, Patriakana Ikumenike e Stambollit, Manastiti Laura e Madhe, Manastiti bullgar Zographe, Universiteti i

Moskës, Biblioteka Kombëtare e Moskës, Manastiri i Studenicës... e të tjera, e të tjera.

Rrëfimtari ka kapërcyer pamjet e ngrira të veprave historike për t'i përtërirë në copëzat dhe paragrafët e romanit duke e bërë strukturën "e ndërlikuar" për rilexim të domosdoshëm sepse tashmë informacioni vjen e bëhet paradigme e përkryer si shije e të bukurës historike, e aromës së këndshme dokumentare e dijes për të kaluarën e ritreguar mbresëlënëse në diskursin e dekonstruksionit të përsosur letrar-artistik...

... Zëvendësimi i termit te ideologjisë me atë religjioz është i domosdoshëm për shkak të historisë së trajtimit tematik dhe intrigës rrëfimtare si thyerje të konvencave të të dhënave të librave të historisë. Të shkruash për personazhet, për figuracionin stilistik dhe semantik duke veçuar krahasimin etj. herë të tjera.

Gjithmonë vrasim shkrimin me padijen tonë dhe varrosim leximin bashkarisht

Romani "Ikona e Plagosur" është një shtresim tjetër i diskursit krijues letrar në prozë që shkrimtarja Mira Meksi na jep një botë të tërë në një pasqyrë lëvizëse e cila futet thellë në të kaluarën e një kombi dhe qendron pezull në të sotmen e pritjes për zbuluesin, për një fakt historik i cili dëshmon ekzistencën e gjurmëve pa zhurmues, i fjetur në rrënojat e perandorisë pushtuese ballkanike, i cili lind në Krujë, rinohet në Edirne dhe ngulitet në Krujë përjetësisht.

Nuk dua të paragjykoj, përkundrazi flas me vete, arsyetim monologues (!) që romani shqiptar dhe historia ka një paradigme për t'u vlerësuar. Është studiuesi, autori i veprës monumentale "Poetika e romanit historik shqiptar" Bajram Krasniqi, i cili na ndihmon që të kemi një strukturë rrjedhe të

prozës në diakroni e sinkroni përsosmërie të papërsëritshme. Ndoshta, jemi në një periudhë kur ende nuk e lexojmë dot Barthes-in, "Vdekjen e autorit"? Ndoshta, tashmë vrasim shkrimin me padijen tonë dhe varrosim librin dhe leximin bashkarisht! Ndoshta, herë pas here edhe me ndihmën e të tjerëve!

Megjithëkëtë, autorja Mira Meksi ka gjetur "korrelacionin objektiv" (term që sipas "Fjalori i kritikës moderne" është popullarizuar prej T. S. Eliot) për të vendosur gjurmët dhe situatat në dimension të lartë emocional, artistik, fillimisht përmes krijimit dhe në epilog zbulimi të kodeve enigmatike të "religionit" dhe të ideologjive që ndërhyjnë përherë në "kornizën" e heshtur të ikonave.

Në fund, për një uverturë tjetër njohjeje si në një refleksion pasqyre, falenderojmë autorin dhe vëmë një shkronjë, pa shenja pikësimi, në un-in krijues të saj, për rilexime të mëtejme! Në fakt për zbulues të tjera!

Shkurt-mars 2026, Prishtinë- Gllarevë

- Meksi, Mira "Ikona e Plagosur", Onufri, Tiranë, 2025 (Shënim: Në një panair që mungonin bestselleret "tradicional mediatik" të shekullit XXI nga vetëm 3, 4 vepra të domosdoshme për lexim të ndikuar nga propaganda e trivialitetit dixhital vendosa të lexoj librin, romanin "historik")
- Chartier, Pierre "Hyryje në teoritë e mëdha të romanit", Onufri, Tiranë 2015, faqe 53
- Nga një rrugëtim në kohë ndërrim mileniumesh dhe hapësire "të afërte" te un-it të shkrimtares, të dëshmuar përmes veprës në sirtar! Jo e plotë! Fragmentar, si vet teksti në tërësi: Rreth 350 kilometra distancë mes Barcelonës dhe Valencias. Përkthyesja Mira Meksi në vitin 1990 takon Gabriel García Márquez-in. 35 vjet më pas prozatorja Mira Meksi viziton varrin e Donika Kastriotit dhe boton romanin "Ikona e Plagosur". Në këtë "hark" kohor të përtërirë në qindra krijime imagjinative letrare, shkrimtaren Mira Meksi e "shfletoj" në bibliotekën time. Fillimisht pasthënie "Tarasona-një "Babel" gjuhësh-Garcia Markezit" te romani "Dashuria në kohërat e kolerës" (1990, "Naim Frashëri", Tiranë), tregimin fiction-factions "Kadare, Atxaga, Çmimi Nobel, Lopez Tubio në shtratin e vdekjes" te "Mali i shpirtave" (1994, "Dituria", Fondacioni "Velija", Tiranë), revistën "Meh Lichi!" (në veçanti esenë "Romani", janar 1997, nr. 2), parathënie "Borges" të veprës përkthimi nga origjinali në shqip "Vdekja dhe Busulla" (Fiksione & Aleph, 2002, "Onufri", Tiranë) te Jorge Luis Borges, shqipërimin e parë nga origjinali te "Njëqind vjet vetmi" (2019, "Onufri", Tiranë), botimet e ripara, të ripunuara dhe të plotësuar në shqip, shqipëruar nga origjinali "Dymbëdhjetë tregime pelegrine" dhe romanit "Kujtim kurvash të trishtat" (2017, "Onufri", Tiranë), romanin "Vjeshta e Patriarkut" (2022, "Onufri", Tiranë), veprën post mortum te Gabriel García Márquez-it "Shihemi në gusht" (2024, "Onufri", Tiranë) dhe në fundin e prologut, veprën me ese "Leximi i ndaluar dhe shkrimet e fshehura" (2011, "Onufri, Tiranë). Ndoshta, pasi tashmë ditëve të fundit ka ardhur në shqip një "version tjetër përkthimi i "Tuneli" i Ernesto Sabato-s, kjo fusnotë do ishte pikënisje për një shëmbëllim tjetër me titull të gjatë në proces: "Prozatorja Mira Meksi, Shtëpia Botuese "Onufri" dhe përkthimi i shkrimtarëve të realizmit magjik në shqip"
- Meksi, Mira "Ikona e Plagosur", Onufri, Tiranë, 2025, f. XVIII
- Tashmë rreth 40 vjet nga botimi i veprave kritike "Komunikime letrare" (1980) "Letërsia dhe vetëdija historike" (1984), "Poetika e romanit historik shqiptar" (1985) dhe "Kode të ligjërit letrar" (1988) të studiuesit Bajram Krasniqi (1951-1990). Nga katër këto vepra dy janë bazë për historinë e diskursit të prozës me tematikë historinë. Për të veçuar "Poetika e romanit historik shqiptar" (1985). Janë 38 romane që janë vënë në analizë letrare në sintezën poetike nga romani historik shqiptar Bajram Krasniqi vepra të botuara nga viti 1889 ("Marçja" i N. Nikaj) deri në vitin 1981 ("Motti i madh" i M. Krajës)
- Meksi, Mira "Ikona e Plagosur", Onufri, Tiranë, 2025, f. 6
- Meksi, Mira, Po Aty, f. 20 e 21 (më tej pjesët e cituara faqet në tekst)
- Chartier, Pierre, Po aty, f. 180
- Ne nuk guxojmë ende të vëmë kurora lulesh tek varri i Josif Bagerit? Të rrallë janë ata që din se eshtrat e Hasan Prishtinës prehen në varrezat e dëshmorëve në Kukës. "Janë varrosur në kohën e Enver Hoxhës dhe me urdhërin e tij. Hiqeni! Dërgoni në Trojopje! Jo, jo! As atje!" Në gishta numërohen ata që kanë vizituar varrin e Sami Frashërit në Stamboll.
- "Fjalori i kritikës moderne", Botimet Toena, 2000, Tiranë, f. 118
- "Fjalor...", Po aty, f. 118
- Krasniqi, Bajram "Romani dhe historia" te "Kode të ligjërit letrar", Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 75



Kur Zana më telefonoi për t'u angazhuar me fjalën e rastit, mu kujtua menjëherë ajo kohë që sot duket sikur i përket një bote tjetër, vitet kur studionim së bashku në shkollat e artit, në Liceun Artistik dhe në Institutin e Lartë të Arteve! Ishin vite me kufizime të shumta, me mungesa në materiale, me një horizont kulturor të kontrolluar, por me një etje të jashtëzakonshme për dije!

Në shtëpitë tona ende nuk kishte televizor dhe bota e ekranit të vogël ishte pothuajse e panjohur. Filmata që shfaqeshin në ekranin e madh të kinemasë, ishin të paktë dhe të përzgjedhur. Për jetën e artistëve të mëdhenj flitej shumë pak, ndërsa për shumë prej tyre nuk flitej fare. Në atë kohë, dritarja e vetme që na hapte drejt botës së madhe të artit ishte libri. Pa librin, ne nuk do ta kishim kuptuar kurrë territorin e pafund të artit, atë hapësirë të gjerë ku krijonin artistët, përtej kufijve të vendit tonë. Pa librin do të kishim vetëm hartën e vogël të një ishulli të izoluar, ku ne do të krijonim vetëm për njëri-tjetrin, pa e ndjerë frymëmarrjen e botës së madhe!

Ishte libri, ai që vërtetë na hapi sytë. Pak prej tyre arrinin të merrnin në bibliotekë. Më pas kur disa botime u ndaluan, librat që qarkullonin dorazi, u bënë ushqimi ynë më i çmuar. Një përfaqësues i tyre ne njohëm për herë të parë artistët "e jashtëm", ata që krijonin në një botë që për ne ishte e largët dhe e paarrtshme si vetë ëndrrat. Secili prej tyre kishte të paktën një monografi. I mbaj mend librat e mëdhenj, të rëndë, të trashë, me kopertinë të fortë, me këmbë të lluksoze dhe me një peshë që dukej sikur mbante brenda jo vetëm veprat e artistit, por edhe atë vetë.

Ishin të mbushur me imazhe të veprave, të riprodhuara me një përkujdesje që për kohën dukeshin pothuajse perfekte, të shoqëruara me tekste të gjata nga kritikë, studiues dhe historianë arti. Nuk na shkonte kurrë ndër mend se një ditë edhe ne, artistët e këtij vendi të vogël, do të kishim libra të tillë të personalizuar për krijimet tona.

Libri i një artisti të madh, mua më shëmbëllente me një katedrale. Pse?

Sepse kur ndërtohej katedralja, qyteti bëhej i rëndësishëm dhe ngrihej në një status të veçantë. Brenda asaj ndërtese mpiksej e gjithë energjia e kohës. Nuk ishte thjeshtë një ndërtesë e aq, por një qendër gravitete rreth së cilës organizohej e gjithë jeta e atij qyteti. Koha rridhte ndryshe, ku e përditshmëria e zhurmshme mbetej jashtë. Ishte një arkiv i gjallë i kujtesës, pasi në gurët e saj gdhendeshin figura, histori, shenja dhe simbole. Kështu ndërtesa bëhej një libër i madh guri ku shkruhej historia e dukshme dhe ajo okulte.

Në të njëjtën mënyrë, edhe një libër monografik bëhet qendra rreth së cilës orientohet e gjithë qenia e një artisti. Ai mbledh në një pikë të vetme të gjithë udhëtimin, të gjitha përpjekjet dhe të gjitha gjurmët që ai ka lënë në kohë!

Ti, i dashur Vasil, ja mbërrite të ndërtosh katedralen tënde!

Dhe për ta ngritur këtë ndërtesë, zgjodhe Zana Varvaricën si arkitekte, si inxhinierë dhe si muratore të kësaj ngrehine. Ajo mori përsipër një punë, që nuk është vetëm teknike, por e brendshme, sepse një libër i tillë nuk ndërtohet thjesht me informacion; ai ndërtohet me kuptim, me përzgjedhje dhe me një ndjeshmëri që di të dallojë thelbin nga të rastësishmet.

Ashtu si katedralja që ngrihej në mes të qytetit dhe organizonte jetën rreth saj, edhe ky libër monografik ngrihet në mes të jetës tënde si artist dhe organizon kujtesën tënde krijuese. Në faqet e kësaj monografije mblidhen vitet e punës, kërkimet, dyshimet, dështimet dhe sukseset e tua. Çdo vepër vendoset në vendin e vet, si një gur në një mur të madh, dhe papritur rruga që dukej e shpërndarë në kohë merr një formë të qartë.


Nëse katedralja thërriste drejt vetes mjeshtra, pelegrinë dhe udhëtarë, ky libër do të thërrasë lexues, studiues dhe dashamirës të artit. Ti dhe publiku mund të komunikoni përtej kohës dhe përtej distancave. Njerëz që nuk të kanë njohur kurrë, mund të hyjnë në këtë hapësirë të ndërtuar me fjalë dhe imazhe

Monografia "VASIL RAKAJ", nga Suzana Varvarica

Një libër i çmuar për punën e gjatë në studio, kërkimet, eksperimentet e skulptorit

Vasil Rakaj

Nga Gazmend Leka



dhe do të zbulojnë aty universin tend artistik.

Por ndikimi i librit shkon edhe më thellë. Nëse katedralja transformonte qytetin së jashtëm, libri transformon individin së brendshëm. Çdo njeri që do e hapi këtë libër do të hyjë në një hapësirë të re reflektimi. Faqet e tij do bëhen si dritare nga të cilat, do të hyjë një dritë tjetër, një dritë që ndriçon jo vetëm veprat e tua, por edhe mendimet dhe përvojat e atij që i sheh.

Brenda këtij "qyteti të brendshëm", imazhet e tua dhe fjalët e Zanës ndërtojnë rrugë. Një vepër tëndja të çon tek një tjetër, një ide e Zanës çel një ide tjetër, dhe lexuesi fillon të ndërtojë brenda vetes një hartë të re, ku arti yt bëhet një pikë orientimi për të kuptuar qenien tënde. Ashtu si në një katedrale ku drita e vitrazheve ndryshon me orët e ditës, edhe kuptimi i këtij libri do ndryshojë me kalimin e kohës dhe me përvojën e atij që e lexon.

Në këtë mënyrë, libri monografik për ty nuk do të jetë vetëm një dokumentim i veprës tënde. Ai do jetë një hapësirë e gjallë, ku energjia krijuese tënde do vazhdojë të qarkullojë. Ai do ruajë kujtesën e një jete artistike, por njëkohësisht do e përhapë atë, që të vazhdojë të ndikojë në mendjet dhe imagjinatën e të tjerëve.

Së fundi, ashtu si katedralja që mbetën për shekuj si qendra të qyteteve, edhe një libër i tillë do të mbetet si një qendër midis shumë qendrave gravitete në kulturë. Ai do të "flejë" në raftet e bibliotekave, por e vërteta është se do të jetojë në mendjet e atyre që do e hapin.

Zana e ngriti këtë ngrehinë tullë pas tulle, faqe pas faqe, duke ndjekur me durim gjurmët e krijimtarisë tënde. Ashtu si mjeshtrat e dikurshëm që kontrollonin çdo gur përpara se ta vendosnin në murin e katedrales, edhe ajo ka zgjedhur me kujdes çdo vepër, çdo periudhë, çdo moment të rëndësishëm të rrugës tënde artistike, që rrëfimi të ndërtohej i qartë dhe i qëndrueshëm.

Një monografi nuk është vetëm një renditje kronologjike veprash. Ajo është një proces kërkimi dhe kuptimi. Ajo kërkon të hyjë në logjikën e brendshme të krijimit, të kuptojë se si lind një ide, si ndryshon në kohë dhe si shndërrohet në formë. Për këtë arsye, puna e autores është një lloj arkeologjie e kujtesës artistike: ajo gërmon në dokumente, në kujtime, në dëshmi dhe në vetë veprat, për të zbuluar lidhjet e fshehta që i bashkojnë ato.

Ti, Vasil, i besove Zanës gjithçka ke bërë në vite: punën e gjatë në studio, kërkimet, eksperimentet, periudhat e ndryshme të krijimtarisë tënde. I besove jo vetëm veprat, por edhe historinë e tyre, rrugën që kanë bërë deri sa janë ngjizur si pjesë e universit tënd artistik. Dhe ajo e mori këtë besim me përkushtim, duke e përkthyer udhëtimin në gjuhën e studimit dhe të reflektimit kritik.

Ajo ndërtoi një rrëfim që nuk është vetëm për veprat, por për rrugën që të ka çuar tek ato. Sepse çdo vepër e një artisti, është një stacion në një udhëtim më të gjatë, dhe vetëm kur këto stacione lidhen mes tyre, fillon të duket qartë harta e plotë e këtij pelegrinazhi.

Në këtë mënyrë, libri që ajo ka ndërtuar

nuk është vetëm një dokumentim i krijimtarisë sate. Ai është një strukturë e menduar me kujdes, ku çdo kapitull është si një hapësirë e veçantë, një vend ku lexuesi mund të ndalet, të shohë, të kuptojë dhe të ndjejë më thellë energjinë e punës tënde artistike. Dhe kështu, përmes kësaj pune të duruar, ajo ka bërë atë që bëjnë arkitektët e mirë të kujtesës: ka ndërtuar një hapësirë ku veprat e tua jo vetëm të ruhen, por edhe flasin mes tyre, duke i dhënë lexuesit mundësinë të shohë më qartë jo vetëm atë që ke krijuar, por edhe rrugën e gjatë që të ka sjellë deri këtu.

Unë jam shprehur edhe më parë për punën e Zanës, në promovimin e monografisë së një tjetër piktori. Zana nuk ka ndryshuar. Është po ajo: e përkushtuar, e duruar e qartë dhe kërkuese. Prandaj e gjej me vend të rilexoj mbylljen e fjalës sime të para disa muajve për të.

"Shumë vite më parë jam shprehur se në bibliotekën virtuale të mendjes sime kishte një mungesë të madhe monografish për artistët shqiptarë dhe kjo asfiksi krijonte një përshtypje të mbrapshtë, sikur në Shqipëri artet e bukura të ishin një 'vrimë e zezë'. Sot bibliotekat tona kanë në raftet e tyre disa libra të tillë me një cilësi të admirueshme, dhe kjo falë studiuesve, ku në rresht të parë bën pjesë edhe Zana Varvarica. Puna e saj është e gjatë. Nuk bëhet në pak ditë, por kërkon muaj të tërë dhe shpesh vite, derisa vepra të piquet. Janë ditë të mbushura me kërkime, grumbullime, seleksionime, balancime, evidentime, takime dhe biseda të shumta me njerëzit që e kanë njohur dhe që kanë qëndruar pranë personazhit që ajo analizon. Është një punë e vështirë, sepse nuk të lejon të rrish ulur, siç do të rrimë ne kur libri të na bjerë në dorë dhe do ta shohim qetësisht në rehatinë tonë."


Nuk po i përsëris thjeshtë fjalët që kam thënë më parë, por po rikonfirmoj njohjen time për të. Po të njëjtën kthjelltësi në analizë ajo ka treguar edhe në këtë libër dhe, padyshim, e ka bërë me një ndjeshmëri të veçantë. Jo vetëm sepse po shkruan për një artist, por sepse po shkruan për ty, me të cilin kemi ndarë vite formimi, miqësi dhe një pjesë të rëndësishme të jetës sonë!

I dashur Vasil, si fillim, librin e krahasova me një katedrale për nga pesha dhe rëndësia që ai mbart. Por mund të sjell këtu edhe një tjetër imazh plot kuptim për të. Victor Hugo në romanin *Katedralja e Parisit*, shkruan:

"Kur kujtesa e popujve po formësohej dhe kur mendja njerëzore ishte në fëmijërinë e saj, gjithçka shkruhej në librin e gurtë. Por në çastin kur u shpik shtypshkronja, mendimi njerëzor gjeti një mënyrë më të qëndrueshme dhe më të lehtë për të jetuar. Mendimi u bë zog. Ai fluturon në katër erërat që mbush ajrin dhe hapësirën. Mali do të zhdukej prej kohësh nën ujë, gjatë një përmbytjeje të madhe, ndërsa zogjtë do të fluturonin ende."

I tillë do të jetë libri i mikes tonë, studiueses Zana Varvarica, shkruar për ty: një tufë zogjsh që do të fluturojnë përtej kësaj dite, përtej kësaj sale dhe përtej kohës sonë, duke mbajtur me vete kujtesën e punës, të përkushtimit dhe të udhëtimit tënd artistik! Veprat e tua vërtetë jetojnë në hapësirën e tyre natyrale, në studio, në ekspozita dhe koleksione, por libri është ai që do t'u japë atyre një tjetër jetë - kujtesën.

Vasil, të falënderoj që më dhe mundësinë të shprehem me disa rreshta në këtë ngjarje kaq të rëndësishme të jetës tënde!



“Më 1836, nga dashuria për emrin e Atdheut, u ngrita i pari dhe, si i vetmi shqiptar, qita në dritë të diellit, pothuajse si në një palestër të përbashkët, fiset e ndryshme që tregojnë virtytet e tyre.”
 Jeronim de Rada*

DE RADA PËR SHKODRËN

Lidhja e parë e Poetit të kangjeleve me Shkodrën erdhi përmes letërsisë, kur më 1836 botoi në Napoli librin “Poesie Albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari” - “Poezi shqiptare të shekullit XV. Këngë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës”. Qasja ndaj qytetit historik të Shkodrës shihet qysh në titullin e kryeveprës së tij dhe të mbarë poezisë shqipe. Jeronim de Rada, si mjeshtër i portretizimit, vëllain protagonist Milosao dhe motrën e vogël deuteragoniste Letician, i ka trajtuar si personazhe me detaje domethënëse e me tipare karakteristike, në të cilat shquhet fisnikëria e djemve dhe e vajzave shkodrane të shekullit XV. Milosao largohet nga qyteti i lindjes për të studiuar e më pas për të luftuar, por rri përgjithmonë në kujtesën e kombit si një simbol qëndresë:

“Gjaku im te lumi i Vodhit . / Hapeni shatoren,

O ushtarë, që të shoh / Shkodrën edhe time motër.” (1)

Edhe pse ka humbur familjen (nënë, gruan, djalin) dhe i ka mbetur te shtëpia veç motra e vogël, heroi romantik Milosao në amanetin e fundit kërkon që të ketë para syve të tij fillimisht Shkodrën dhe menjëherë mbas saj motrën.

Studiuesi Jup Kastrati ka vënë re: “Për të parën herë në historinë e letërsisë shqiptare paraqiten guximi dhe trimëria e popullit shqiptar në një vepër artistike. Milosau, përshkruar aq fuqishëm nga pena deradiane, bie theror për mbrojtjen e atdheut. Shuhet pranë liqenit të Shkodrës, te lumi i Obotit. Në këtë poemë De Rada shpreh nostalgjinë dhe dashurinë për atdheun e etërve të tij.” (2)

Portretizimi i motrës është bërë me fije të arta thurur me delikatesë përmes shkrimit eliptik të llojit “vedo non vedo”. Motra e vogël e tij rrezaton pastërti virgjërore falë gërshetit vajëror kapur me lidhëse të bardhë. As porosia e fantazmës së Rinës për të gjetur shokun e jetës, as këshilla e Milosaos për martesë me një trim arbër, nuk e tundin nga përkushtimi deri në vetëmohim ndaj vëllait. Prandaj heroi i poemës liriko - epike e rendit atë përkrah Shkodrës në fjalët e fundit. Motra ia ndrin jetën vëllait duke e lënë veten e saj në hije.

Studiuesja Fatbardha Hoxha ka spikatur se: “Kulti i gruas, aq i preferuar për romantikët, është përvijuar edhe në figurën e Leticies, ku De Rada ka derdhur me densitet pakrahueshëm sakrificën e pafund të motrës për vëllain.” (3)

Lidhja e dytë e Jeronim de Radës me Shkodrën erdhi përmes publicistikës, kur ai themeloi në Corigliano Calabro revistën “Fiamuri i Arbërit” - “La bandiera dell’ Albania” (1883 - 1887), një nga tribonat më të rëndësishme të shtypit shqiptar të Rilindjes sonë Kombëtare. Mjaft figura të shquara kulturore të Shkodrës, kohanike me Jeronim de Radën, shquhen nëpër artikujt publicistikë të shkruar me elegancën e pendës së shkrimtarit arbëresh.

Lavdërim për Leonardo de Martinon
“At Leonardi për t’iu dhënë guxim dhe për t’ua zgjeruar mendjet hartonte një dramë të shenjtë shpirtërore, që qe e para dramë shqiptare, shfaqur nga nxënësit e shkollave popullore në kishën e françeskanëve në Shkodër natën e Krishtlindjeve më 1880.” (4)

Kjo konsideratë e Jeronim de Radës për pionierin e teatrit shqiptar doli në shtypin periodik arbëresh më 1884. Vite më pas, më

Në 123-vjetorin e vdekjes së Jeronim De Radës

DE RADA PËR SHKODRËN – SHKODRA PËR DE RADËN

Nga Prof. Dr. Alfred Çapaliku

1896, në një antologji shqipe të përgatitur prej tij, ai i bëri një tjetër lavdërim, po aq të merituar, arbëreshit shkodran Leonardo de Martino:

“Sigurisht i vleri De Martino ka meritë më tepër se të gjithë ne për ringritjen e shpirtërave në Shkodër dhe në krahinën e saj, ku ai qëndron.” (5)

Profil për Prenkë Doçin

“Po i botojmë këto vargje të një atdhetari të ndritur nga Shkodra, për t’iu përgjigjur para së gjithash nevojës që të bashkohemi në gjuhë (e cila është detyrë e Fiamurit të Arbërit). Dhe pritëm për t’i vënë përmbri, jo gjithaq si shkrim dashurie, por si adhurim i vërtetë, të cilëve, me ndjesi të thjeshta e të natyrshme, ata u rrinë në krahë si bij të një kombi.” (6)

Portret për Filip Shirokën

“Kur Fuqitë e Europës ndërhyjnë për copëtimin e parë të Shqipërisë, një djalos shkodran, Karolipo Shifi (anagram i poetit Filip Shiroka) hartoi hymnin e luftës italisht, i cili paraqet një paraftyrë të vendit të sotëm të Shqipërisë.” (7)

Lartësim për veprën e çmuar të Pashko Vasës

“Shih disertacionin e shkëlqyer të Vaso Pashës, sot guvernator i Libanit, botuar gjermanisht në Berlin më 1879”. (“E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Një studim kritik historik”. Shën. im: A. Ç.). (8)

Epistular me Zef Jubanin

Jeronim de Rada mbajti letërkëmbim me një nga udhëheqësit e Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, me folkloristin e njohur shkodran Zef Jubani (Ndokillia). Një letër, ajo e shkruar në gjuhën italisht dhe dërguar Zefit më 12 korrik 1870, u bë publike nëpërmjet shtypit arbëresh.

Shkodra dhe Buna

Shkodra - Skutari përmendet si toponim pesëmbëdhjetë herë në krijimtarinë letrare dhe në publicistikën deradiane, ndërsa Buna - Buena, lumi që rrjedh pranë qytetit të Shkodrës, i del si hidronim tri herë në opus. (9)

SHKODRA PËR DE RADËN

Në korrespondencën nga Krakovi i Polonisë për në Grac të Austrisë me albanologun Gustav Majer, te letra VIII e 6 dhjetorit 1892, poeti i ri Ndre Mjeda interesohet për jetën e De Radës. Ndërsa në letër XII të 16 marsit 1893 duke dashur që të njohë një kontribut të rëndësishëm filologjik të Jeronim de Radës i shkruan shumë të shkëlqyeshmit zotit Profesor: “Unë gjithnjë vazhdoj ta shtoj, ndonëse me ngadalë, koleksionin tim të vogël të librave. Deri tani i kam grumbulluar të gjitha gramatikat e shqipes, me përjashtim të asaj të De Radës dhe të Likut...” (10)

Më 1903 - 1904 si pasardhës i Jeronim De Radës në detyrën e profesorit të gjuhës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit u emërua gramatikani dhe poeti nga Shkodra, Gaspër Jakova - Merturi. Më tej në vitin shkollor 1911 - 1912, si mësues i gjuhës shqipe, ishte aty intelektual shkodran Nikollë Martin Zamaj.

Për ndriçimin e figurës së apostullit të Rilindjes Kombëtare Jeronim de Rada (**Maki, Zozencë, Kalabri 29. 11. 1814 - 28. 02. 1903**) kontribuan me 230 artikuj shkencorë edhe 46 studiues nga areali shkodran. Autorët, sipas rendit mbiemëror, janë: Ermira Alija, Kolë Ashta, Vehbi Bala,

Izet Bebeziqi, Hamit Boriçi, Martin Camaj, Alfred Çapaliku, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani, Gjovalin Çuni, Palokë Daka, Miaser Dibra, Andreas Dushi, Filip Fishta, Gjergj Fishta, Luigj Franja, Karl Gurakuqi, Luigj Gurakuqi (ish - nxënës i De Radës në kolegjin e Shën Adrianit, Shën Mitër Korone), Mark Gurakuqi, Artan Haxhi, Nertila Haxhia - Ljarja, Fatbardha Hoxha, Kolë Kamsi, Paulin Kamsi, Valbona Karakaçi, Eleni Karamitri, Jup Kastrati, Ernest Koliqi, Gazmend Krasniqi, Ledri Kurti, Mati Logoreci, Ardian Marashi, Vinçens Marku, Ndojë Mhilli, Filip Ndocaj, Shefik Osmani, Tomor Osmani, Arshi Pipa, Fadil Podgorica, Arben Prendi, Gëzim Puka, Sami Repishti, Justin Rrota, Gjovalin Shkurtaj, Tefë Topalli, Zef Valentini.

Brilant është vlerësimi i folkloristit të mirënjohur Kolë Kamsi rreth personalitetit të Jeronim de Radës: “*E përnjimend ky burrë qi ja kushtoj Shqypniis fuqin e mëndes, qetsiin e shpirtit e ja fali gjithë gjëan e jeten e vet, kje një luftaar per komin t’ onë, pënda e tii kje e prehtë si shpata e Skanderbeut.” (11)*

Edhe sot e kësaj dite vijon interesimi i madh për këtë figurë poliedrike të botës shqiptare - arbëreshe, nga pedagogët e gjuhës e të letërsisë, studentët filologë, doktorantët e Gjuhës shqipe në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, si dhe nga anëtarët e Qendrës së Studimeve Albanologjike në atë institucion të arsimit të lartë shqiptar.

Kësisoj marrëdhënia Jeronim de Rada për Shkodrën dhe Shkodra për Jeronim de Radën rri në simbiozë.

EPILOG: VJEN DE RADA


*“Te shtëpi e Zotit e ka varrin,
 Ku kangjelja feks si një qiri,
 Por ndriçimi nuk ia shuan mallin
 Për çdo lis me erë Arbëri.*

*Anëdetit klith pors lumbardha,
 Brigjet diellore mban ndër sy,
 Kala - Shkodra, lule mac - Saranda,
 Vjen De Rada si një bard aty:*

-Si të lashë prap të pashë ty!” (12)

REFERENCA:

- *G. De Rada: “Canti storici albanesi di Serafina Thopia, moglie del principe Nicolo Ducagini”. Tradotto in prosa italiana. Napoli, della Tipografia Boeziana, 1839, p. 82.
- 1. Jeronim de Rada: “Këngët e Milosaos”. XXX, v. 3 - 6. Vepra letrare 1. Tiranë, 1987, f. 127.
- 2. Jup Kastrati: “Krijimtaria e Jeronim de Radës”. Jeronim de Rada. Vepra letrare 1. Tiranë, 1987, f. 12.
- 3. Fatbardha Hoxha: “Poema “Këngët e Milosaos” në optikën e sotme të leximit”. Letërsi e interpretuar. Shkodër, 2003, f. 88.
- 4. Girolamo De Rada: “Leonardo De Martino”. Rev. “Fiamuri i Arbërit” - “La Bandiera dell’ Albania”. Anno I. Nr. 6. Corigliano Calabro. 30 marzo 1884, p. 7.
- 5. Girolamo De Rada: “Leonardo De Martino”. Antologia albanese. Napoli, 1896, p. 74.
- 6. Girolamo De Rada: “Prenkë Doçi nga Shkodra”. Rev. “Fiamuri i Arbërit” - “La Bandiera dell’ Albania”. Corigliano Calabro. Anno I. Nr. 11. 30 settembre 1884, p. 7.
- 7. Girolamo De Rada: “Filip Shiroka”. Rev. “Fiamuri i Arbërit” - “La Bandiera dell’ Albania”. Anno II. Nr. 7. 20 ottobre 1885, p. 3.
- 8. Girolamo De Rada: “Vaso Pasha”. Rev. “Fiamuri i Arbërit” - “La Bandiera dell’ Albania”. Anno III. Nr. 9. Cosenza. 20 gennaio 1886.
- 9. Jeronim de Rada: “Tregues i emrave gjeografikë”. Vepra historike dhe filologjike. Përkthyer prej italishtes, me një studim hyrës dhe me shënime e komente plotësuese nga prof. dr. Jup Kastrati. Tiranë, 2020, f. 78, 94, 304, 305, 347, 452, 459, 605, 680, 681, 705.
- 10. Ndre Mjeda: “Korrespondenca. Dymbëdhjetë letra të Ndre Mjedjes, shkruar italisht, dërguar albanologut Gustav Majer gjatë vitit 1892 - 1893”. Ndre Mjedja. Vepra letrare 2. Tiranë, 1988, f. 140, 146.
- 11. Kolë Kamsi: “Jeronimi De Rada. 1814 - 1903”. Shqiptarët e Italisë. Shkodër, 2006, f. 354.
- 12. Alfred Çapaliku: “Vjen De Rada”. Harmoni. Lirika. Shkodër, 2015, f. 55.



Studimet krahasuese në letërsinë bashkëkohore shqiptare dhe ballkanike po fitojnë gjithnjë e më shumë një peshë të veçantë, sidomos kur ato ndërtohen mbi koncepte themelore të përvojës shpirtërore, siç është "malli". Libri i studiuesit Luan Topçiu, "Paradigmat e vetmisë", i botuar nga shtëpia botuese "Onufri", përbën një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim, duke sjellë një qasje të thelluar ndërdisiplinore, ku ndërthuren analiza letrare, refleksione filozofike dhe vëzhgime antropologjike.

Që në parathënien e librit, të hartuar nga akademiku rumun Alexandru Balaci, theksohet vlera shkencore e studimit dhe aftësia e autorit për të ndërtuar ura ndërmjet kulturave, veçanërisht në raportin shqiptaror-rumun. Balaci nënvizon se vepra shquhet për gjykime me peshë dhe për një njohje të thellë të ndërveprimeve kulturore në hapësirën ballkanike, duke e vendosur që në hyrje studimin në një kornizë serioze akademike. Në këtë prizëm, edhe vetë Topçiu, përmes analizës së tij, e trajton mallin jo thjesht si motiv letrar, por si një kategori ekzistenciale dhe kulturore, që përshkon në mënyrë organike përvojën poetike të popujve të rajonit.

Kështu, libri shndërrohet në një udhëtim analitik dhe hermeneutik, që synon të zbulojë strukturat e thella të ndjeshmërisë kolektive dhe të shprehjes artistike, duke vendosur në dialog letërsinë shqipe me atë rumune dhe më gjerë.

Pjesa qendrore e librit i është kushtuar pranisë së mallit në letërsinë e lëvruar rumune dhe shqiptare. Në faqet e tij, autori thekson kompleksitetin e lirizmit individual përkundrejt atij kolektiv të folklorit. Shembujt që dëshmojnë kalimin e teksteve, që spikasin për një talent të shquar përkthyesi dhe kritiku, ndihmojnë në përshkrimin e evolucionit të spektrit semantik të fjalës *dor* në krijimtarinë e artit letrar të Costache Conachi, Iancu Văcărescu, Enăchiță Văcărescu, Anton Pann, Gheorghe Asachi, Eliade Rădulescu, Dimitrie Bolintineanu, Vasile Alecsandri. Një kapitull i posaçëm i kësaj qendre tematike i është kushtuar "shtysës" kulmore të mallit në krijimtarinë emineskiane, ku malli shfaqet si përmasë e së pakufishmes. Një citat nga libri është domethënës: "...Vepra emineskiane sjell në letërsinë botërore universin më të pasur dhe më të nuancuar të mall-it...". Ndërsa për Lucian Blagën, filozof i kulturës, malli përcaktohet në trinomën udhë-mall-udhëtar, duke gjeneruar vazhdimisht shpresë dhe dashuri. Sensualiteti i gjeneruar nga dëshira për të jetuar plotësisht përshkon, përmes evolucionit lirik të poezisë së Blagës, përmasat kozmike. Askush më mirë se ai nuk ka ndjekur me aq intensitet mrekullinë e oborrit të mallit (vizionet e dritës dhe të fshehtësisë në dëshifime kozmogonike).

Në të vërtetë, poeti është ai që do të trokasë në portat e mëdha prej bronzi, plot mister, të botës së kësaj ane dhe të asaj së përtejme. (Luan Topçiu përmbledh mbresat e drejtpërdrejta në pasionin e leximit, që befasojnë me hollësi të dallueshme, duke zbuluar magjinë e artit të poetëve të studiuar.)

Kapitulli kushtuar dor-it/mall-it në poezinë e lëvruar shqipe është, për çdo lexues të vëmendshëm të studimit të Luan Topçiu, kërkues në fushën e letërsisë krahasimtare, duke qenë një tjetër dokumentim i qartë i evolucionit semantik dhe tematik të kësaj fjale emblematike për spiritualizmin e të dy popujve.

Denduria e saj është më e theksuar në periudhën romantike, te poetët që u drejtuan kah gurrat e kthjellëta të folklorit. Janë të analizuar, me vëmendje pjesëmarrëse dhe me përkujdesjen e një studimi racional, veprat e disa prej shkrimtarëve më përfaqësues të letërsisë shqipe, si: Jeronim de Rada, A. Rrjeka, Zef Serembe, Naim Frashëri (poeti kombëtar shqiptar), Andon Zako Çajupi.

"Paradigmat e vetmisë në poezi"

Luan Topçiu me një studim krahasues mbi lirikën shqiptare dhe rumune

Nga Kastriot Kotoni

Me interes të posaçëm janë faqet kushtuar pranisë së mall-it në veprën e tre shkrimtarëve shqiptarë nga "Bukureshti": Asdreni, Poradeci, Kuteli, duke shënuar një shkallë të epërme krijuese dhe mbi marrëdhëniet me universin. Duke jetuar dhe shkruar në Rumani, ata hyjnë në konvergenca shpirtërore me letërsinë e këtij populli, nën shenjën e romantikut të madh evropian, Mihai Eminescu.

Të tre shkrimtarët janë paraqitur në tre medaljone të shkëlqyera letrare, ku evokohen aspekte të panjohura nga Bukureshti, i konsideruar kryeqyteti i Ballkanit dhe selia e një qendre të rëndësishme shqiptare.

"Shkrimtari i parë bukureshtas" është Asdreni (1872–1947). Poezia e tij meditative (me disa ndikime nga Eminescu dhe Arghezi) i drejtohet njeriut universal.

"Bukureshtasi i dytë" është Lasgush Poradeci (1899–1987), student në Belle Arte dhe në Teologji në Bukuresht, doktor shkencash në Graz, me një tezë mbi Eminescu-n. Ai është konsideruar poeti më i rëndësishëm i Shqipërisë moderne,

i përqasshëm me Baudelaire-in dhe në interferencë me artin kozmogonik të Eminescu-t.

Medaljoni i tretë (seria e tre shkrimtarëve është tejet interesante për të vendosur edhe karakterizimin e marrëdhënieve kulturore rumune me spiritualitetin evropian) i është kushtuar Mitrush Kutelit (1907–1967), student në Bukuresht, përkthyes i Eminescu-t, i cili u manifestua edhe në poezi, duke qenë ndër prozatorët më të shquar të letërsisë shqipe bashkëkohore.

Të tre shkrimtarët kanë qenë të përfshirë nga magjia e entitetit të mallit, duke depërtuar në zona të fshehta të subkoshicës së parë, në një huajësim që ndodh në kontaktin metafizik me një ekzistencializëm quasi-onirik.

Në poezinë e Lasgush Poradecit, malli merr kuptimin e një "migrimi" shpirtëror, një përkushtim absolut ndaj fjalës-simbol. Gjendja e thellë onirike i jep fjalës cilësi hermetizuese, duke rritur kënaqësinë e lexuesit për të deshifruar në mënyrë mbresëlënëse kuptimet e fshehta. Përmes tij,

në poezinë shqipe depërton poezia e misterit.

Bindëse është edhe ekzegeza kritike e faqeve të këtij libri, që analizon me imtësi paralelizmin Eminescu-Poradeci, duke mbërritur në një konkluzion, ndonëse të diskutueshëm për Eminescu-n si romantiku i fundit evropian dhe për Poradecin si postromantik që përfaqëson një poezi më moderne dhe më komplekse. Luan Topçiu e konsideron edhe Mitrush Kutelin të denjë për t'u përfshirë në këtë "matricë stilistike".

Një tjetër medaljon provokues, i titulluar në mënyrë simbolike "Victor Eftimiu - Urë lidhëse", është shkruar me një simpati të veçantë intelektuale për këtë shkrimtar të rëndësishëm rumun me origjinë shqiptare.

Kapitulli V trajton mallin në letërsinë rumune dhe shqiptare të pasluftës, duke afirmuar praninë e tij në një sërë autorësh përfaqësues të letërsisë bashkëkohore të të dy popujve.


Vëmendje e posaçme i kushtohet "Metafizikës së mall-it në poezinë e Nichita Stănescu-t", ku mall-i vendoset krahas "motivit të lundrimit...". Vëzhgimet kritike të Luan Topçiu përbëjnë ndër interpretimet më të rralla dhe më të stërholluara.

Autori i librit ka shteruar në mënyrë lineare të gjithë hapësirën ontologjike ndërmjet popujve të Ballkanit, e posaçërisht atë rumune dhe shqiptare. Ai i ka shtrirë kërkimet edhe në fushën gjeografike, në arealin e termit Ballkani Perëndimor, ku shumë vende e cilësojnë veten si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit apo pjesë e "Europës Lindore". Autori ka një ngjizje të antropologjisë kulturore dhe ekonomike të dy popujve. Vlen të përmendet fakti se Luan Topçiu ka hedhur në hapësirën shqiptare teza shkencore të pavlerësuar ose të pakonstatuara, si, për shembull, në lidhje me fjalën mall të shqipes, ku ai shprehet se është studiuar pak sfera semantike dhe shtrirja e motivit në krijimtarinë poetike nga studiuesit shqiptarë. Topçiu na kujton se për herë të parë ndihet pesha e madhe e fjalës mall në poezinë e Lasgush Poradecit. Autori përmend studiuesen me origjinë shqiptare, Lucia Djamo Diaconita, në studimin e saj krahasues "Eminescu-Asdreni", ku bën disa vëzhgime mbi fushën e gjerë semantike të fjalës mall, duke qenë kështu e para studiuese që heq një paralele midis mallit dhe dor-it. Si njohës i kulturës ballkanike, Luan Topçiu e ka shtrirë më thellë vëzhgimin e tij shkencor; sipas tij, kufijtë e dy llojeve të letërsisë, asaj të lëvruar dhe asaj popullore në Ballkan, shkrihen dhe herë pas here është e vështirë t'i dallosh nga njëra-tjetra. Për këtë arsye, thotë ai, i referohemi poezisë popullore si dëshmia më autentike e strukturës shpirtërore së një populli, e cila përbën deri në ditët tona një lëndë burimore për letërsinë e kultivuar. Më tej, Luan Topçiu shton se në të dy popujt, po të kërkojmë gjenezën e ndjenjës së mall-it, ajo është e lidhur nga kontaktet e këtyre dy popujve, që në periudhat e mugëta të historisë së tyre, me natyrën. Malli ka lindur në kushtet e transhumancës, kur të dy popujt migronin me bagëtitë nga njëri cep i Ballkanit në cepin tjetër. Ashtu si shqiptarët, edhe rumunët, thekson autori, dikur, në rrethana të caktuara historike, kanë qenë të detyruar të izolohen në një lloj mërgimi në vendin e vet, për t'u mbrojtur nga furia e popujve migratorë luftënxitës, duke u tërhequr për një periudhë kohe në male e pyje, në zonat malore të vështira për t'u depërtuar nga barbarët. Këto izolime të përkohshme sollën në shpirtin e shqiptarit dhe rumunit trishtim, brengë, hidhërim, melankoli për të shkuarën. Në këngët baritore rumune të komitëve, të quajtura ndryshe *doina* (ritmi i së cilës, po t'i referohemi Lucian Blagës, është pasqyruar i një horizonti specifik rumun, që përbëhet nga një horizont i lartë ritmik dhe pafundësisht i përbërë nga kodra e lugina), rumuni i këndon vëllazërimin me natyrën. Pikërisht në këtë lloj specifik të lirikës popullore haset edhe motivi i mall-it.

Luan Topçiu

PARADIGMAT E VETMISË NË POEZI

studim krahasues mbi lirikën shqiptare dhe rumune



Onufri

Ndërkaq, në këngën popullore shqiptare, figura e çobanit dhe, më gjerësisht, hapësira e bjeshkës artikulohe si hapësira liminale (një gjendje tranzitore midis dy fazave) dhe rituale, ku subjektiviteti njerëzor lirohet nga kodi i rendit shoqëror. Vargjet: “Më ka marrë malli rëndë”, “për të fjetur nën tendë” dhe “që të mjet dhentë në shtrungë, t’i mjet ti e t’i nga unë”. Figura e çobanit, në të dy traditat kulturore, është më shumë se një emër; është një pozitë ekzistenciale e përshkuar nga simbolika. Një trajtesë e rëndësishme në librin “PARADIGMAT E VETMISË, studim krahasues mbi lirikën shqiptare” të Luan Topçiu është edhe vështirësia e përkthimit të fjalës “mall” dhe “dor” nga gjuhët e tjera. Në përkthimet shqip të letërsisë rumune, përkthyesit shqiptarë e kanë përkthyer dor-in e rumanishtes nëpërmjet mall-it në mënyrë konsekuente dhe pa luhetje, si Mitrush Kuteli, Rexhep Ismajli, Vehbi Bala, Dionis Bubani. Topçiu na njofton se vetëm malli i shqipes mund ta përkthejë në mënyrë adekuate dor-in e rumanishtes, duke mbuluar gjithë sferën semantike të tij, falë përputhjeve në të gjitha kuptimet e mundshme të mallit dhe dor-it.

Autori përmend Profesor Grigore Brâncuș në lidhje me përkthimin e fjalës *mall*: do të shprehej: “Korrespondenti i saktë i dor-it në shqipe: *mall*”. Gjithashtu, edhe Kundera është i mendimit që, përveç atyre që përdorin fjalën greke, mund të shtojmë pa ngurrim rumanishten me fjalën *dor* dhe shqipen me fjalën *mall*, të dyja pothuajse të papërkthyeshme dhe shumë më intime në shprehjen e ndjenjës. Dijetari gjerman Karl Dieterich, në fillim të shekullit XX, realizoi një studim krahasimtar të poezisë popullore ballkanike, ku identifikoi elemente të përbashkëta stilistike dhe figurative. Një nga tiparet karakteristike që ai vërejtë ishte përdorimi i një imazhi natyror si hyrje poetike në këngët popullore ballkanike, si psh: “Ra një vesë e zbuti dhenë, lulëzoi molla, lulëzoi dardha”. Gjithashtu, Dieterich thekson metaforat dhe krahasimet e zakonshme për përshkrimin e bukurisë femërore: shtati si selvi, vetulla si gajtan, syri si filxhan, hunda si qiri, goja si kuti, dhëmbët si inxhi, beli si unazë. Ai mendon se këto formula poetike kanë origjinë orientale dhe janë përhapur në Ballkan përmes Bizantit.

Në zbërthimin e fjalës *mall* nga Luan Topçiu kemi disa shtresëzime të kuptimit të kësaj fjale. Ajo herë na duket një ndjesi e largësisë fizike dhe herë një udhë e dyfishtë: fizike dhe shpirtërore, e prekshme dhe mitike. Në këngën popullore shqiptare dhe rumune, malli nuk është thjesht një pasojë e kalimit të kohës, por gjenerator i ndjeshmërisë dhe i krijimit. Ai shfaqet si ndërthurje e kohës së humbur dhe vendit të largët, siç do ta përkufizonte Mircea Eliade në “Njeriu dhe shenjtëria” (1957), ku çdo kthim drejt të shenjtës është një rikthim në zanafillë (Itakë dhe përpara saj). Malli, në këtë rast, është kërkim për origjinën personale, për vendin ku njeriu ndihet i përkryer dhe i plotë.

Malli është një ndjenjë themelore dhe universale, që mbart në vete jo vetëm përjetimin emocional, por edhe reflektimin identitar, siç thotë Paul Ricoeur, që formojnë narrativën tonë të brendshme dhe strukturën autobiografike të vetes. Kujtimi personal, i transformuar nga përjetimi emocional, krijon një “kohë të tretë”, “kohën e mallit”. Të tjerë autorë citon Topçiu për fjalën *mall*, si Gaston Bachelard, për të cilin malli është mënyra me të cilën e “banon” shpirtërisht një vend që nuk ekziston më realisht, por jeton në kujtesë si një hapësirë intime. Për një tjetër autor si Mikhail Bakhtin: malli është i vendosur gjithmonë në një kronotop, në kuptimin e një njësie ku koha dhe hapësira ndërthuren për të krijuar përjetimin e plotë narrativ dhe estetik. Kënga e mall-it është vendi ku bashkohen koha e kaluar dhe hapësira e munguar, si fshati, mali, lumi, shtëpia, pragu, livadhi. Në këtë kuptim,

malli përfaqëson një kronotop emocional, që përmban nostalgjinë, dhimbjen dhe dëshirën për rikthim.

Një tjetër ide shteruese e autorit është se malli, si koncept poetik dhe antropologjik, është evaziv, i vështirë për t’u matur, por jo për t’u ndjerë. Ai shpërhapet në ndërjegjen njerëzore dhe vjen si një “tingull i brendshëm”, që shfaqet në një sërë formash artistike. George Călinescu e përkufizon *dor*-in (mallin) si ndjesia themelore e shpirtit rumun, një ndërthurje e melankolisë me mallin ekzistencial dhe fatin historik të njeriut. Në këtë mënyrë, malli mbetet një strukturë ndjesore dhe mitike, një ndërmjetës midis njeriut dhe kohës, midis brendësisë dhe jashtësisë. Ai është dëshmi e një jete të jetuar, e një lidhjeje të thellë me botën që kemi lënë pas, por që nuk na lë kurrë.

Nëse tek Mihai Eminescu malli thërret, përgjërohet, akuzon, tek Lucian Blaga ai i jep kësaj gjendjeje një frymë të re. Malli, në universin e tij poetik, është një vuajtje që nuk konsumohet dhe nuk shërohet prej vetvetes. Ai ndërthen një ndjeshmëri më të thellë, më të heshtur, më afër qenësisë. Shorti i poetit është një dallgëzim i vazhdueshëm, një puls i ritmuar me lëvizjen e universit, për një botë të mbushur me shenja dhe relacione. Barra e tij është të deshifrojë shenjat dhe të vjelë kuptimet e fshehta të botës.

Me ardhjen e këtij studimi të nivelit shumë të lartë shkencor, bota shkencore dhe studimore akademike shqiptare është pasuruar edhe më shumë. Luan Topçiu ka ditur që, me metodën krahasuese, të zbërthojë edhe brenda letërsisë shqipe valencën e fjalës *mall* nga autorët shqiptarë si Asdreni, Kuteli e Poradeci. Ndërsa Kuteli shkruan për Asdrenin si poeti i mallit, i atij malli të pashuar të mërgimit, që nuk e mbytnin as detet, as vitet. Së bashku me Lasgush Poradecin, ata i japin termit “mall” një kompleksitet të ri, duke e çuar përtej dimensioneve të zakonshme. Tek poezia e Asdrenit ndihet fuqishëm fjala kombëtare me shenja të qarta gjeografike, të cilat vendosen si tituj emëruar në krye të poezive. Për këtë mjafton fakti që ai shkroi vetëm në gjuhën shqipe, duke ndërthyer veten pjesë organike të bashkësisë së tij etnike dhe, si lëvtronjës i dorës së parë i kësaj gjuhe, është dëshmi e një vetëdijeje kulturore.

Sipas studiuesit Luan Topçiu, në poezinë e Lasgush Poradecit, fjala *mall* merr kuptime komplekse dhe njëherazi sfiduese. Malli meriton vëmendje jo vetëm për dëndurinë e përdorimit, por edhe për potencialin e tij semantik: ai shndërrohet në një motiv të fuqishëm që ndërton një rrjet të gjerë domethëniesh. Ai shfaqet në gjendje ekzistenciale, si etje për diçka apo për dikë mungues që nuk shter, si vendi, dashuria, koha, vetja. Jo vetëm fjala “mall”, por e gjithë gjuha që e rrethon krijon një univers të përbrendshëm, ku emocionet përthyer në reflektim. Ekziston bipolariteti emocional i mallit në universin poetik të Lasgushit: ato janë një trinom: malli, mungesa, udha, ku ndjenja e mallit është një shqetësim shpirtëror, me një mungesë shumë të rëndësishme, me një mungesë të dimensionit metafizik, me një mungesë të natyrës ontologjike. Karakteri i mungesës humbet konkretësinë e tij në kushtet kur malli, manifestim dhe pasojë e kësaj mungese, transformohet nga një përjetim vetjak subjektiv në një rrethanë të pastër lirike. Në këtë mënyrë, veç vlerave të tjera të ofruara në metodën krahasuese mbi lirikën shqiptare dhe atë rumune, që u munduam të evidentojmë në këto radhë, mund të themi me plot gojë se, me këtë libër, studiuesi Luan Topçiu, na provon në mënyrë bindëse se, malli te Lasgushi nuk mbetet vetëm një ndjenjë e përjetuar, por ngrihet në një parim organizues të vetë universit të tij poetik, ku mungesa shndërrohet në burim kuptimi dhe krijimi.

“Sali Vranishti, njeriu-këngë” Akademik Vasil S. Tole

Për kapedan Sali Vranishtin është folur dhe shkruar shumë. Ai tashmë është pjesë e historisë së Shqipërisë dhe ky libër është një tjetër dëshmi e prekshme e jetës dhe e aktivitetit të tij patriotik për Shqipërinë. Sali Vranishti kishte shume epitete, ndër to astrit, bir i maleve të sertë, kapedan i kapedanëve etj, dhe më i bukuri ndër ta është ai i “njeriut këngë”.

Po çfarë është kategoria e “njeriut-këngë”?

Është një klasifikim popullor që lidhet me meritat e njeriut parë nga sytë, mendja dhe zemra e popullit. Zakonisht jemi mësuar me ndarjen dhe klasifikimet e rëndësishme të njerëzve sipas shtresave shoqërore dhe titujve aristokratikë që mbajnë, si p.sh.: baron, dukë, kont, princ, mbret etj. apo me klasifikimet e titujve dhe gradave akademike, ushtarake apo fetare. Po ka edhe një ndarje tjetër, të pashkruar dhe pa vendime e shkresa, kjo e popullit që flet për “njerëz me këngë”. Për popullin këta janë kategoria e njerëzve të shquar dhe është e kuptueshme që derisa ka njerëz me këngë, ka edhe njerëz pa këngë, madje shumica nuk ka këngë.

Siç me të drejtë thuhet në libër “*kënga nuk është thjesht kujtesë, ajo është monumenti i parë i pavdekësisë*”² dhe për Sali Vranishtin janë ngritur shumë të tilla si “Sali Murati, i thonë”, “Nëntëqind e tetë viti”, “Bashkë me Sali Muranë”, “Ç’janë ata komita malit”, “Ju dogj xhani për vatanë”, “Te ura Saliu thirri”, “Në Vlorë foli tellalli”, “Hapsanat kush i prishi” etj. Për më tepër, si askush më parë, Sali Vranishti ju këndua: *Kudo ku të shkeli këmba/ Të ndoqi nga pas kënga!* Këto vargje pohojnë më mire se çdo argument tjetër se jeta dhe veprimtaria e tij ish e denjë për këngën e popullit.

Ismail Kadare e konstaton këtë dukuri, pra “njeriun me këngë” si një diçka jo të rrallë në hapësirën shqiptare, pasi vetë ambienti i lindte, krijonte njerëzit me këngë. Sipas tij ata ishin të gjallë, por edhe të vdekur, pra që kënga u ishte ngritur nga pas.

Në realitetin fizik e njerëzor të Shqipërisë, gjejmë këngë të ngritura nga populli për figura të shquara historike e për dëshmorë të atdheut, si për “*Heroin Kombëtar*” – Skënderbeun, “*Babain e kombit*” – Ismail Qemalin, Selam Musanë, “*Këngë për Ali Pashanë*”³, trimat⁴ “*Gjolekë Mandileziu*”, “*Kush e njih Dervish Alinë*”, “*I shkreti Hadër Kaninë*”, “*Metë Jazua gjakëtuar*”, “*O Hodo, Hodo Nivica*”, “*Zek Prevata një trejm i rrallë*”, “*Haxhi Zeka në shall të bardhë*”, “*Idriz Seferi ça ka thone*”, dëshmorët Mujo Ulqinaku, Qemal Stafa e Vojo Kushi etj.

Në thelb “*njerëzit këngë*” janë ata që ushqejnë dhe kanë ushqyer krijimtarinë artistike njerëzore me të jashtëzakonshme, me unike, me të përjetshme duke tërhequr vëmendjen edhe të shkrimtarëve tanë, ndër ta edhe të Kadaresë. Në veprën e tij janë disa “njerëz këngë” që ai i përmend, ndër ta Gjon Mokrari, kapedani Çelo Karafil Plaku, Babë Vuçiterni – kryetar kuvendi burrash, stërnipi i Balshajve, Shpend Shendëllia, hero popullor, me tri këngë, njëra prej të cilave kërcëhej, Nik Martini etj. Këngët për “njerëzit këngë” janë si një gjerdan vlerash që ka nisur të formohet prej qindra vitesh, nga krijues anonimë ose jo. E ritheksojmë se këtij realiteti metafizik letrar i ka paraprirë kjo krijimtari popullore që ka lartësuar me këngë figurat e heronjve. Të tilla janë edhe këngët kushtuar Sali Vranishtit, “njeriut këngë” të Labërisë dhe Shqipërisë (një këngë për të gjendet edhe në arkivin e Institutit të Antropologjisë, ish Instituti i Folklorit), atij që populli i këndoi:

*Kush njihje Sali Muranë
Atë komitin me famë
Korb të zezë e kish fustanë,
Ju dogj xhani për vatanë.*



Skanoje për të dëgjuar këngën për kapedan Sali Vranishtin

E përgëzoj përgatitësin e librit, Arbenin për punën e madhe që ka bërë në grumbullimin dhe sistemimin e gjithë asaj lënde dokumentare, studimore dhe folklorike që lartëson dhe përjetëson figurën dhe kontributin e madh patriotik të Sali Muratit për Shqipërinë! Ju faleminderit!

1 Shih: Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Tiranë, 1980, f. 32–33.

2 Tek “Sali Vranishti, kapedani që nuk i mbyll sytë as në bronz”, Tiranë, 2026, f. 189. Libër i cituar.

3 Botuar nga Spiro Dine, Sofje, 1908. Te: *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635–1912)*, vëllimi 3, Tiranë, 1962, f. 13–15.

4 Shih: *Epika historike 2*, Tiranë, 1981, f. 98, f. 106, f. 115, f. 118, f. 418, f. 215, f. 266, f. 154.

M'u zemërua trëndafil

M'u zemërua trëndafil
Që nuk ja fala mikes
Për ditlindjen e saj
Dhe më përgjaku gishtat.

Pritja

Pemët e rrugës më dërgonin ligjërime bilbilash
kur vija në vendtakim
dëgjoja hapat në rrugë si duartrokite
trëndafil në dorë parfumonte mbrëmjen

Hëna u bë orë, por akrepat u lodhën duke pritur
dhe ngrinë në cep të qiellit si lypëse e dritës
ndërsa pemët u zverdhën befaz
dhe hodhën gjathnajën me fëshfërimë
gjethet korba më çukitnin sytë

Era ma rrëmbu trëndafilin nga dora
vjeshta kamçikonte me vetëtima

Bust heroi në një park të harruar

Pranë bustit vijnë dhe ulen zogjtë dhe gjethet
sikur duan t'i kujtojnë heroit ëndrra gjaku
shiu i pëshpërit fjalë të harruara
si urdhra të mbetur pezull në ajër
retë i flasin me gjuhë bubullimash

barërat rriten si kujtime pa trup
dhe i mbështillen kraharorit si medalje të zbehura

Gjethet ngjajnë me plagë të vjetra
një flutur ndalon mbi ballin e ftohtë
e vetmja gjë e gjallë këtë ditë të thyer
sytë prej bronzi kërkojnë diçka të humbur
sikur duan të thonë sa shpejt harron njeriu

Pesha e padukshme

sa i madh qielli
sa e vogël ngjan toka nën këmbët e reve

avioni pret ajrin si një mendim i gjatë
dhe qytetet bëhen pika që humbasin pa gjurmë

në këtë lartësi ku çdo gjë zvogëlohet
zemra zë më shumë vend se horizonti

dhe papritur e kupton
se qielli të jep përmasat e vërteta të dashurisë

Krateri i Zembrës

Fryma jote, puhizë që lëmon qerpikët e barit.
Gishtat e mi, valë ere që puthin lirishtat.
Ti rritesh në mushkëritë e mia,
si dritë në qelqëzën e një tempulli të gjallë.
Zemra ime, një mollë e artë,
e kafshon dhe nxjerr flatra,
rritet, kuqëlon planet në agoni.
Në çdo gjethe që prekim, digjet një mit.
Unë, krater që derdh vetëm lavë e hi,
që të lulëzosh ti në dritë.

Troja e Syve të Tu

Mos i besoni kalit, ulërinte Kasantra
dhe qielli pikonte mbi xhama të krisur.
Autobusë fërshellenin mallin,
pemët dridheshin si vajtoça në zi.

Ti qeshje me një flakëz të ftohtë
por unë kurrë s'e lexova drejt
zinë që shpallnin sytë e tu.

Vështrimi yt: re pa shi, rrufe që nuk falin.
Mos u besoni, ulërinte Kasantra
mos u besoni syve.

Të besova.
Le të digjej Troja brenda meje;
S'munda ta verboja atë vështrim,
as ta fshija lotin e rremë
që kurrë s'mesova ta deshifroj.

Pushtimi

Erdhe dhe më plaçkite,
jo me zjarr, por me sy, me zemër.
Si ushtri pa armë,
por me buzëqeshje që thejnë çdo portë,
madje dhe ato kështjelloret.
Më more gjithçka: mendjen,



PETRO ÇERKEZI

shikomë në sy

kujtimin, trupin tim që nuk kërkon kthim.
Dhe unë jap, jap
pa kërkuar dëmshpërbim,
si një flim i lumtur,
që pranon pushtimin
nga një perandori e butë,
ku shpërblimi është vetë ndjenja që rri sovranë
në fronin e zembrës.

Orkestra e Kaosit

Zëra, zëra si pluhur drite në magnetofonin e ditës.
Zëra kalifonikë, si harqe që merren me veten.
Zhurmë kakofonie, si një botë e lodhur nga harmonia.
Erërat ulërijnë me zëra dëshpërimi,
paralel me preludë idilesh që nuk u luajtën kurrë.
Zëri yt, një flaut në dhomë, që zgjon porët e mureve,
që sjell një rend të ri në këtë kaos,
si një dorë që përkëdhel të çmendurit me nota dashurie.

Në kufirin e flakës

Ngeca në telin me gjemba,
kur kapërceja oborin e mistershëm të shpirtit tënd.
U bëra mish i flakës, terror vetëtimash.
Re e kuqe, vegim që lë erë gjaku e dashurie.
Zgjat duart, moj qenëz e qenit,
vetëm ti mund të më heqësh këto pranga qiellore
të më kthesh nga skllav i ankthit,
në lirinë e përqafimit.

Pranverë e Çliruar

E theve akullin e qiejve të burgosur.
Mbama dorën. Janari iku si një plak i hidhur.
Vish fustanin e bajames.
Shkurti e humbi betejën si kalë çalaman.
Do t'i fal sytë thua për fole dallandyshe
Mars, qesh e luaj dhe qaj po të duash
si fëmijë që u gëzohet krahëve të ylberit.
Prill! Shkel mbi supin tim dhe përqafo perëndinë
Flautët e luleve projektojnë qiellin e rilindur.

Anija e Heshtjes

U thinj qielli, ballë i rrudhur pa shpresë.
U thinj deti, pasqyrë e kaltër trishtimi.
Anija e vetmisë endet ngadalë,
nëpër qiparisë që përkulen si engjëj të bardhë.
Hëna, një tempull kotnie,

mermeri i saj, i brishtë si premtimet e harruara,
bie thërrime mbi valët e ftohta
si orakuj që s'parashikojnë më asgjë.

Panteoni i Shpirtit

Brenda këtij tempulli
ku koha e ka humbur orën,
banojnë perënditë e ngurosura të vetëdijes.
Dalta e shekujve ka gdhendur një formë,
dridhjen e dritës në mermerin e shpirtit.
Panteon i braktisur, por mitologjia e tij,
gdhend akoma me daltë vetëtime.
Profilon përjetësinë
hijen e bukurisë që s'mund të plakët.

Shikomë në sy

"Shiko në fokus dhe buzqesh," tha fotografi,
duke rregulluar diafragmën e një realiteti të deformuar.
"Shikomë në sy", tha vajza
"janë qielli i lumturisë sime".
"Shiko sytë e qiellit", tha Zoti
"atje është gdhendur hyjnisht përjetësia".
"Mos u tremb nga sytë e mi", tha Jeta
"janë një pasqyrë që nuk gënjen".
Dhe e Vërteta, sy që ndriçojnë tunele terri,
tha: "syri im është dielli që s'duhet harruar".
Por askush nuk e pa.
Të gjithë shikonin nëpër lente
dhe ngatëronin përmasat.

Çelsi i derës së fundit

"Merreni", tha dhe hodhi pistoletën mbi tavolinë
si të ishte çelësi i derës së fundit.

Plumbi, bëri rikoshetë dhe më mori zemrën, tha.
Ajo s'kishte zemër,
ishite një arkiv dashurie mortore.

Një dashuri që mori formën e krimtit
dhe erën e barutit.

"Ishte dashuria ime", tha,
"ishite jeta ime."
Tani më sillni sarkofagun,
ta mbështjell me një batanije akulli
dhe ta çoj në muzeun e shpirtit tim dështak".

Tempulli i dritës

Ti zgjodhe të banosh në sytë e mi,
Si në një tempull hyjnor, në Delf apo Dodonë
jo si banore, por si perëndeshë që krijon yllësi.
Aty ndërtove pallatin tënd hyjnor,
me dritare që shikojnë drejt përjetësisë.
Shih pemët, ato janë fenerë që ndriçojnë frymën time,
ja lisi i profecive, degë sallone mbretërore, me pak gjak
ku ti ecën mbi tapet gjethesh,
dhe çdo fletë pëshpërit emrin tënd me zë enigmatik.

Në avion

Të kujtova ty
dhe u drodh avioni si një mendim që s'gjen vend

njerëzit britën nga paniku
ndërsa zogu i çeliktë hynte mes reve pa kërkuar leje

stjuardesa buzëqeshte
thua se e dinte sekretin që ende hapësirave qiellore

avioni u drodh sërish dhe sërish
ishe ti që krijoje boshllëqe ajri në kujtesën e qiellit

Vallja e furishme

Bie klarina ciklon tingujsh që i shpërthen dritaret.
Ti, e lindur prej flakësh gushti,
Vallon si hyjneshë që kërkon hakmarrje mbi trupin e kohës.
Ngjyrat në zemrën time shpërthejnë si stuhi shigjetash,
shamitë ngrihen si pëllumba me flatra të çara.
Bukuria rritet këtu si pemë trupi që përdridhet,
dhe kali i zembrës thyen këmbët në terren emocionesh.
Ç't'i bëj kalrinës që shpërthen në çdo damar?
Ç't'i bëj zemrës që merr malet në çdo rrahje?
Ç't'i bëj valles që më ka grackuar këmbët?
Ç't'u bëj syve të tu që janë fole vetëtimash?

Uverturë Vjeshtore

Vjeshtë, o piktore e çmendur me penela ngjyrash magjike,
Nga cili univers i krisur i rrëmbeve këto paleta të rralla?
Ç'është ky sekret që i kthen gjethet në psalme?

Ndalu, të pi një kafe me Van Gogun në fushën e diellit të verdhë,
Të sodisim bashkë këtë peizazh që merr frymë si ikonë.
Në këtë galeri ku Zoti vetë dridhet nga emocioni.

Ti flije nudo nën një uverturë me dirigjent penelin e Curbet.

Shega

Shega u ça, jo nga thika, por nga puthja.
Ajo hapi buzët, lëng i kuq si fjalë që s'u thanë,
Dhe shpërtheu në cep të dritares si një burim sekret.
Çdo kokërr, një gjuhë që më rrëfen një mister,
Një histori që më shkund gjetet në shpirt
Dhe më josh ëmbëlsinë e puthjes.

Buzëqeshje prej Qelqi

Mbrëmja më buzëqeshje prapa kangjellave,
Si një fantazmë që endet pas perdes së një ëndrre.
Një manekin porcelani, i palëvizshëm në vetmi,
Më buzëqeshje nga vitrina, një ngërdheshje pa formë.
Njeriu që ia vodhi buzëqeshjen natës me fara yjesh,
Nuk ishte aty. Njeriu që desha të më buzëqeshje,
Ishte një shtëllungë ere që vërtiste gjetet e harresës.
Vjeshta thurte uverturë me një orkestër kanibalësh.

Kryqi i Hijes

Puthi ikonën, lëkura e saj prej qielli të çarë
dhe bëri kryq me gishtat që dridheshin nga mallëngjimi.
Një zog, hije me pendë prej drite të ndotur,
linte në ajër kryqin e vet, peshën e padukshme të natës.
Ai ishte Jezusi dhe Barabai në të njëjtën frymë.
Goja e Golgotës e thithte si një plagë të njohur,
Dhe nën dritën e zezë të hënës,
u bë copa e fundit e një mozaiku të harruar mëkatarësh.

Kërthiza e Botës

Kërthiza një ylbernajë që më lidh me ty,
një litar drite që dridhet si damar nën ujë.
Por edhe kufi: kërthiza e përgjakur që më ndan,
një hemorragji e heshtur
që rrjedh nga harta e çarë e universit.

Në natën eunuke,
mitrat e yjeve pjellin foshnja pa zë
trupa që nuk qajnë,
por digjen si qytete
në qetësinë e dritës.

Gjaku i hënës ka ngrirë.

Epika e Errësirës

Nata uli perdet
një skenë tragjedi pa aktorë.
Kalorësi i çarmatosur,
kali këmbëthyer;
rruga që të thërret
është labirint thikash të padukshme.

Ç'luan i fshehtë lëpin plagët e mia
në një rit arkaik,
djegur nga shkretëtira e mallkimit,
pa puthje, pa mëshirë pa lavdi.

Qielli tavan teatri, yjet drita mitike.
Dantella e dhomës, hartë vegimesh;
mjegulla shall zëri,
vala nimfë që kërkon duart tona.

Një puthje ringjall,
një tjetër vret,
nën tingujt e një nokturni
që nuk mbaron.

Sa herë dëgjoj gërnjetën

Sa herë dëgjoj gërnjetën
e flak patericën dhe pranveroj
një flutur e tejdukshme vallëzon mbi qerpikët e tu
gjaku më buçet si lumë në damarë
dhe befaz jam heroi që bie pranë një burimi

Sa herë dëgjoj gërnjetën
një shami e përflakur më ndizet nëpër gishta
dhjetëra zëra më gjëmojnë në shpirt
dhe fustanella hap flatrat në panairët e Pogonit tim

Hyj e dal në vrimat e gërnjetës
dhe rilind nga e para si nëpër ballada malli

Shënime mbi krijimtarinë e poetit Xhevahir Spahiu

POETIKA E QËNDRESËS DHE E SHIKIMIT PËRTEJ

Nga Luan Rama

Emri i Xhevahir Spahiut përfaqëson një nga nyjet më të rëndësishme të zhvillimit të poezisë shqipe bashkëkohore. Ai nuk është vetëm një autor me një korpus të konsoliduar krijimtarie, por një zë që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në riformulimin e marrëdhënies midis poetit, fjalës dhe realitetit. Në këtë kuptim, poetika e tij mund të lexohet si një ndërthurje e dy dimensioneve themelore: qëndresa dhe shikimi përtej.

Që në fillimet e veta, poezia e Xhevahir Spahiut shfaq një vetëdije të theksuar për identitetin dhe për procesin e formimit të tij. Subjekti lirik nuk paraqitet si një entitet i përfunduar, por si një qenie në lëvizje, në kërkim të vetvetes dhe të kuptimit. Vargje si "Jam ai që s'kam qenë / ai që do të jem nuk jam" dëshmojnë për një konceptim dinamik të qenies, ku e tashmja është një pikë kalimi dhe jo një gjendje përfundimtare.

Në këtë kontekst, motivi i udhës merr një rëndësi qendrore, jo thjesht si figurë stilistike, por si kategori ekzistenciale dhe epistemologjike. Udhëtimi është proces njohjeje dhe tejkalimi.

Shikimi përtej lidhet me aftësinë për të perceptuar të padukshmen: "Unë e ndiej / bukurinë e gjithçkaje që s'shoh". Kjo e vendos poetin në një raport të veçantë me realitetin, ku intuita bëhet formë njohjeje.

Një dimension i rëndësishëm i kësaj poetike është ekspresiviteti i lartë dhe natyra e saj thelbësisht rebele. Fjala tek Xhevahir Spahiu nuk është e ftohtë apo neutrale; ajo është e ngarkuar, shpesh shpërthyes, e tendosur nga brenda.

Ky ekspresivitet buron nga një tension real midis individit dhe kufizimeve të kohës së vet. Rebelizmi i tij nuk është slogan, por mënyrë qenësore e të menduarit dhe e të shkruarit. Pikërisht për këtë arsye, poezia e tij refuzon konformizmin dhe kërkon liri jo vetëm si temë, por si formë ekzistence.

Në planin formal, Xhevahir Spahiu orienton krijimtarinë e vet drejt një poezie të përqendruar, duke iu larguar modelit dominues të poemës që u afirmua nga autorë si Dritëro Agolli, Ismail Kadare dhe Fatos Arapi. Ai zgjedh dendësinë, ngarkesën semantike dhe intensitetin e vargut të shkurtër, duke u afruar në këtë drejtim më shumë me Migjenin ku fjala synon drejtpërdrejt thelbin.



Qëndresa përbën dimensionin tjetër themelor të kësaj poetike. Ajo nuk është vetëm temë, por parim organizues i gjithë veprës. Në kushte presioni dhe kufizimesh, Spahiu ka ruajtur një koherencë të rrallë midis bindjeve dhe krijimtarisë. Ndalimi i veprave, censura dhe pengesat nuk e deformuan zërin e tij; përkundrazi, e forcuan atë.

Kjo qëndrueshmëri ndaj vetes dhe ndaj së vërtetës e bën poetikën e tij një shembull rezistence kulturore.

Kjo qëndrueshmëri shfaqet në mënyrë të veçantë edhe në disa korpuse tematike të dallueshme.

Poezitë kushtuar Kosovës përbëjnë një nga kulmet e angazhimit të tij historik dhe moral. Në to, fjala poetike bëhet dëshmi dhe solidaritet, duke artikuluar dhimbjen dhe dinjitetin e një përvoje kolektive. Vargje që evokojnë qëndrueshmërinë dhe identitetin, si ideja e qëndrimit "në këmbë mbi tokën e vet" edhe në kushte dhune, përbëjnë një lloj kredoje etike të poetit, ku liria dhe dinjiteti nuk negociohen.

Në një plan tjetër, cikli i poezive për ulla të përfaqëson një dimension më simbolik dhe meditativ.

Ulliri ngrihet në metaforë të jetës, të rrënjosjes dhe të qëndrueshmërisë në kohë.

Ai mishëron vazhdimësinë dhe forcën e heshtur përballë stuhive historike.

Në këtë cikël, vargje që sugjerojnë qëndrueshmërinë, idenë e një qenieje që "rron duke u përkulur, por nuk thyhet", sintetizojnë një filozofi ekzistence ku mbijetesa nuk është pasive, por dinjitoze. Kështu, elementi natyror shndërrohet në një simbol me rezonancë universale.

Përtej dimensionit tematik, kjo ndërthurje e etikës dhe estetikës është një nga veçoritë më të rëndësishme të poezisë së Xhevahir Spahiut. Tek ai, poezia nuk është vetëm krijim, por mënyrë e të qenit. Fjala nuk është zbukurim, por qëndrim.

Në një rrafsh krahasimor, poezia e Xhevahir Spahiut mund të vihet në dialog me tradita më të gjera të poezisë moderne, ku figura si Neruda apo si Lorca kanë artikuluar marrëdhënie të ngjashme midis poezisë dhe angazhimit.

Megjithatë, Xhevahir Spahiu mbetet thellësisht i rrënjosur në përvojën shqiptare, duke e përkthyer atë në një gjuhë me vlera universale.

Poezia e Xhevahir Spahiut ndërtohet mbi një ekuilibër të rrallë midis shikimit përtej dhe qëndrueshmërisë ndaj reales.

Këto dy dimensione nuk janë të ndara, por përbëjnë një tërësi organike, ku poezia bëhet njëkohësisht akt njohjeje dhe akt qëndrimi.

Pikërisht kjo e bën veprën e tij një nga kontributet më të rëndësishme në poezinë shqipe bashkëkohore dhe një model të qëndrueshmërisë të integritetit poetik.



ARBEN VELO

Juga e bardhë e një artisti

Tregim

“Keni skenar se për çfarë duhet të flas? -pyeti Ferhati.

Kështu quhej artisti që njihej për rolet komike sidomos në pjesët “Doni më për qytetin tim”? “Ah pushtuesit gjermanë” “Dhia e haramit”

“Është thjesht një intervistë”- pohova unë.

Tundi kokën dhe nisi të nxirrte prej dollapit disa skaleta.

Miliona të qeshura, duartrokitje, ishin paketuar në korniza. Mijëra foto, ishin gati të ngjallëshin. Vetëm prisnin zërin e tij.

“Kujdes, mos m'i grisni. I kam bërë gati, që, kur të mos jem unë, të paktën të mbeten ato” – gati pëshpëriti.

Kameramani më bëri shenjë. Për drejt kishte harruar pa karikuar bateritë. Dhe kërkoi një prizë elektrike për ti karikuar.

Ferhati iu afrua dritares.

“Nisi dhe juga”- psherëtiu.

Hodha sytë jashtë. Buzëqesha.

Kishim shkuar për ti marr një intervistë. Jetonte i vetëm. 20 vite më parë i kishte vdekur gruaja. Nuk ishte rimartuar. Dhe ende nuk ishte mbushur viti, nga vdekja e djalit të vetëm. Tani jetonte me personazhet

“Moos,”- bërtiti befasi.

“Ç'është kjo drejt erë. Po kush e hapi dritaren?”

U duk sikur një filxhan ra në dyshe. Fillimisht krisi e pastaj u thye. U dëgjua zhurmë.

“Mbylleni dritaren”- ulëriti ai.

Vërtet, po vërshonte një erë e çuditshme?

“E shihni çpo ndodh? Po përzihen bashkë humor, duartrokitje, batuta, të qeshura, parodi, peizazhe, fusha xhirimesh dhe po kthehen në një erë drethkël myzeqare. Nga një frymë ujku po shndërrohet në Jugë të bardhë”- gati recitoi ai.

Kameramani gati po shqyente sytë nga habia. Të them të drejtën, dhe unë po trembesha

“Ah!”- bërtiti prapë ai. I shkatërroj kjo jugë të gjitha. Pastaj, hapi krahët, dhe u shtri

mbi fashetat e fotove, të mbledhura kutullaç, sipër pllakave të sallonit,

Duart i dridheshin. Nuk po u besonim syve. Ndoshta po aktronte. I marrë prej mallit për skenën, personazhet, po stiste para nesh, para asaj interviste, ndoshta një rol prej babloku vetmitar.

“Nuk dua të filmohen kështu, -shtoi duke u përpjekur të mblidhte me krahët e tij gati të tharë, grumbujt e fashikujve.

“Është jeta ime aty, arti, personazhet. I kam dhënë këtij qyteti. Nuk ika si të tjerët. Se braktisa, sepse dhe ai me deshte. Tani më kanë harruar?”-pyeti ai

“Nuk ka gjë” shtoi,- veç më ndihmoni të mbyll dritaren. Akoma nuk e shihni çfarë po ndodh?”

“Dritarja është mbyllur” – përsërita unë. Kot shqetësoheni.

“E keni gabim”- përsëriti. Dhe rendi drejt dritares. E shtrëngoi dorezën me dorën e rreshkur ku dukeshin damarët dhe pasi u sigurova që ishte mbyllur, tundi kokën mosbesueshëm.

“Çudi!”- psherëtiu. Vërtet nuk e patë se çfarë ndodhi?”

“Për pak era më përpriu kujtimet. Shyqyr që u shtriva sipër tyre sepse kush e di ku kishin përfunduar”- tha duke marrë frymë i lehtësuar.

“Ky nuk është në rregull” më tha kameramani. Po silllet cuditshëm”.

Nuk ktheva përgjigje.

“Pa më pyetur mua, nuk do filmosh asgjë”, - përsëriti 90 vjeçari me trupin e hajthëm, shumë të brishtë, me sytë e gjallë edhe pse vështrimi po e braktiste ngadalë,

“E dini çmë gjeti sot në mëngjes?”

Ne heshtëm dhe ngritëm supet.

“Në mëngjes më erdhi një vajzë në shtëpi.

Kërkoj të merrte disa foto nga puna e ime. I duheshin për një studim. E ndihmova dhe e lashë t'i zgjidhte vetë. Në fund kur iku, më përqafoi dhe me puthi në faqe. Dhe më uroi ditë të bukura. Po po. Kur e përcolla, thashë; paskërka ende njëzëz që e duan artin dhe artistin. “!

“Pastaj dola për të bërë pazar. Do ti. Disa më shikonin. Të tjerë ndalonin hapat. Herë më shikonin me habi. Herë vinin buzën në gaz. Disa dhe qeshnin ore, qeshnin. Shyqyr thashë. U kujtuan se unë rroj akoma!”

Kameramani bëri shenjë te faqja e vet dhe tregoi me sy nga faqja e djathtë e artistit

“Shikoje mirë, më pëshpëriti te veshët. Ka dy shënja buzëkuqi në fytyrë.” I duhet thënë. Nëse do ta intervistojmë, nuk mund ta filmojmë ashtu!

“Një, dy, tre, Një, dy, tre”-numëroi ai mbi mikrofonin lidhur me kamerën.

Ferhati mori lupën në dorë.

Një fjollë drite vërshoi nga dritarja, çau mospërmasë sallonin, dhe u shlodh mbi fytyrën e rruddhur të artistit.

Hodha sytë jashtë. Asnjë degë peme nuk lëvizte. Vetëm dy gjurmët e buzëkuqit në faqen e Ferhatit, dukej sikur lëkundeshin në erë, sa herë ai fliste për jugën e bardhë. Unë bëra gati mikrofonin për intervistë.



YLLI AJDINI

Dita e parë e pushimeve

Tregim

Ngrita jastëkun pak më lart dhe mandej nu çova në pozicionin gjysmështrirë. Matanë tytit të tejdukshëm dhe dritares me dopio xham perceptova dëborë që po binte me flokë të imët dhe të rallë. “Ndoshta ka filluar gjatë natës. Dhe sigurisht që gjatë natës ka filluar, sepse mbrëmë tek isha i ulur mbi kolltuk e po shijoja çajin me boronicë, sikur përjashta nuk pash të kishte dëborë!”, arsyetova. Ndërsa gjumi më ka dalë plotësisht dhe ndërkohë po bëhem gati për të braktisur ngrohtësinë e krevatit, pasi më duhet të shkoj në punë, dëgjova zilen e telefonit.

-Kush po të merr kaq shpejt?-ndërhyri Evina.

Zgjata krahun dhe pa u ngutur mora celularin nga komodina dhe mandej shtypa butonin për të komunikuar. Papritur më njoftuan nga institucioni për të filluar lejen vjetore.

“Oh, më në fund!”

-Më kanë regjistruar lejen e vitit, i thashë.

Pavarësisht se pata një pëshqjellim brenda vetes, nuk them se se s'u ndjeva i lumtur, sepse prej kohësh kemi vendosur të nisemi me Evinën diku larg qytetit për t'i shijuar më ndryshe pushimet e këtij viti. Një çast qëndrova në heshtje, pa folur. Pastaj reagova:

-Faleminderit, u përgjigja dhe e mbylla me nervozizëm telefonin.

-Sa është ora?

-Është herët. S'ke pse çohesh kaq shpejt. Për në punë ke ende kohë, i them. Dëgjova një “eeh” që doli nga brenda mbulesave, pastaj asgjë, por që unë nuk munda ta deshifroj dot atë “eh” të saj për shkak të mërziisë që më kishte lindur.

Çuditërisht pushimet e mia nuk përkujtojnë kurrë në muajt e stinës së verës, sikundër i kalon përherë nëpër vendet më ekzotike administrata e lart e institucionit tim. Sidoqoftë kjo padrejtësi dhe mënyra se si po duken gjërat, pavarësisht se më revoltonte, për momentin nuk më ndryshon mendimin për t'i shijuar e përjetuar fundja edhe unë pushimet e mia në mënyrën time. Gjithsesi dhe larg çdo xhelozie, njerzit jashtë meje nuk kam pse i pengoj të ecin brenda mendimeve të veta, por që edhe veten time ndërkohë nuk do e lejoja të jetë asnjëherë pranë tyre. Dhe është ky vendim arsyeja pse për momentin nuk më vjen të çohem nga robat e t'i prish qetësinë rehatisë. Tek e fundit shtrati është

i vetmi vend ku ti mund të bësh ç'të duash, sidomos me imagjinatën. Kështu që në vazhdim unë mund ta zë kohën time shumë më mirë me parafytyrimet që më sjellin veç dëshirat e mia, pasi dëshirat që nuk janë të miat, unë i urrej. Pa u vonuar u futa në hapësirat boshe të kohës, ku mes tyre imagjinoj tek notoj në ujën e pastër të lumit të Drinos, aty, në zonën e Budukut rrethuar nga shelgje të harlisur e të dendur, që ndodhet jo më shumë se dhjetë minuta larg nga shtëpia ku banoj. Në vazhdim të kësaj mënyre apstrakte të përjetimit të realitetit, pasi i kam shijuar të gjitha kënaqësitë e mundshme, i mbuloj përfytyrimet me tepër kujdes të veçantë, por gjithmonë me qëllimin për t'i ruajtur si prova të vetme të lumturisë që zotroj. Sidoqoftë brenda kësaj hapësire një parehati e fuqishme më shtyn të çohem nga shtrati.

-Po çohesh? Ndërkohë Evina u kthye nga unë.

-Sigurisht.

Ende mbi mbajtësen në afërsi të kolltukut qëndrojnë dy librat dhe mbi librat filxhani me çaj, të cilin, mbrëmë tek po lexoja, nuk pata dëshirë ta përfundoja. Vërej se ka dal një diell i zbehtë. Pasi e shoqërova puthjen që i dhashë Evinës edhe me një, “je shumë e mirë”, u çova. Me tu ndodhur më këmbë menjëherë u përballa me pasqyrën e rrethuar nga një kornizë estetikisht e bukur, po ku fatkeqësisht në thellësinë e pafundme të së cilës, pasqyrimi i ngjyrës së qiellit mu reflektua si për ironi në ngjyrën impresionuese të detit të Karaiëve. Nuk u habita aspak kur edhe në një nga cepat e pasqyrës, edhe lumi i qytetit tim u pasqyrua mbi xham si lumi Vollga. Nuk është i vetmi rast. Kështu ka ndodhur edhe në raste të mëparshme. U shkëputa nga pasqyra edhe më i zhgënjyer e i trishtuar. Nuk di se çfarë të bëj. Duket sikur në këtë dhomë banon vetëm zhgënjimi e hipokrizia, dhe jo unë. Sidoqoftë kjo gjëndje s'ka pse duhet të përbëjë një pengesë për të mos gjetur një zgjidhje të përshtatshme, zgjidhje, e cila të më qetësojë e të më largoj nga cilitja.

Përfundimisht në fund të këtij gjykimi e analize, pasi prura në vend ngjyrën normale të fytyrës, nuk mu desh shumë kohë të vendosja për një zgjidhje konkrete e të thjeshtë. Krejtësisht i qetë, pa shqetësuar sigurisht Evinën, menjëherë i rikthej të gjitha bagazhet me robat e plazhit në dhomën më



të errët të shtëpisë. Pas këtij veprimi është e kuptueshme se as dëshira për të pushuar pranë detit, apo dhe për të shëtitur nëpër vëndet më klasike e të bukura të vendit, nuk më shqetëson dhe as më tundon më. Më në fund jam i qetë me zgjidhjen që bëra. Jam i qetë sepse nuk di të kem gabuar për të merituar këtë ndëshkim. Sidoqoftë më mirë të veproj se sa të gjykoj. Pasi bëra një dush dhe u vështa me robat që po më prisnin t'i vishja, mbrita përpara hyrjes së dhomës. Pështjellimin që pata pak më parë në kraharor sikur nuk e ndjej më. Dëgjova Evinën tek sa po çohet nga krevati të thotë:

-Çfarë po bën?
Ktheva kokën dhe vështrimin dejt saj dhe u përgjigja:
-Unë po dal.
-Kur të dal edhe unë nga puna takohemi tek "Bora" për një kafe.

-Të dua shumë! Dhe pasi i them edhe "Shihemi", shtyj derën me lehtësi, zbres shkallët prej druri dhe menjëherë dal në rrugën me gjithfarë pemësh pa klorofil. Qysh në hyrje të rrugës ndjeva një aromë të lehtë parfumi. Dëborë ka kohë që ka pushur së rëni dhe se qielli për momentin çfaqet me ngyrën e vet blu. Gjithashtu përjashta si përherë është e njëjta kohë, por që brenda së cilës lëvizin qënie të ndryshme. Është e pamundur teksa ecën së bashku me ta, të mos ballafaqohesh me fytyra njerzish të veshura me gjestikulacione të pakuptueshme të tipit surrealist: të ftohta, të mjegullta, të lumtura, të vrenjtura e qesharake, që të sjellin menjëherë në mendje krijimtarinë e Andre Breton, Salvador Dalit e Dychamp, krijimtari e cila ngaqë më tërheq shumë, e shikoj me kënaqësi sa herë më duhet që të largohem nga realiteti. Gjithsesi tek vazhdoj të shëtis, unë nuk ngutem, sepse nuk kam arsye pse duhet të ngutem. Pranë shitësive ambulante të perimeve të vendosur në gjatësinë e trotuarit e të veshur me roba të ngrohta dimri, me doreza e kokore kush prej leshi e kush prej lëkure, shikon përherë veç blerësve edhe qenë endacak. Ndoqa me kërshtëri për një moment lëvizjet e tyre, pastaj largohem. Sidoqoftë ky konglomerat gjëndesh nuk ja zbeh aspak shijen llojit të pushimeve që po kaloj nëpër ambientet e qytetit. Përkundrazi. Përkundrazi sepse për mua tek e fundit argëtim do të thotë jo domasdomërisht të jesh duke pushuar në bregdetin e Jonit ose Santa Cruz, por të gjeshe qoftë edhe një vend nga ku mund ta soditësh botën edhe nga çdo lloj distance e lartësi, por, veçse përmes syzeve me ngjyra. Ndërsa lash mbrapa një pijetore bohemësh, imagjinata më nxori një të qeshur me ngjyra ironie.

"Duhet të jetë vërtet diçka e bukur. Po e provoj njëherë. Fundja nuk humbas gjë të imagjinoj atë që nuk ekziston", thashë pas atij mendimi e parafytyrimi të përnatshëm. Menjëherë këputa dy gjethe nga një pemë aty afër, sigurisht nga ato pemë të gjelbërta që janë anësh trotuarit, dhe i mbajta përpara syve, biles i ngjeshja fort pas tyre për të improvizuar sa më mirë ekzistencën e xhamave. Pavarësisht se në thelbin e vet çdo gjë është e njëjta gjë, në dukje gjithçka ka marrë ngjyrat e syzeve të mia. Sidoqoftë ky realitet e kjo gjëndje e çuditëshme, më bëri ta ndjej veten më shumë mirë, sesa të ligështuar. Pasi kalova trotuarin dhe gjethet ende si kam flakur, u drejtova për nga rrugica që të shpie te muzeumi. Por pavarësisht reflektimit aty për aty të një entuziazmi të dukshëm, që mora sigurisht prej iluzionit të çastit, një këputje e lehtë më përshkoi shpirtin e lodhur nga mashtrimet dhe mendimet më rimorën përsëri ngjyrat e errëta të dëshpërimit.

"Ç'realitet i bukur por çuditërisht dhe i çuditshëm", artikulovala.

Nejse, jam me pushime e më shumë se çdo gjë tjetër, më duhet të mendohem se si të shploh veten. Pasi lashë muzeumin, u nisa për te lokal "Bora". Vëreja se mali pëballë është bërë plotësisht i padukshëm, ndërsa hapësirën mbi qytet po e mbulojnë përsëri retë e bardha të dëborës.



GJERGJI MIHALLARI

Schonefeld Airport

Tregim

Gjatë dy muaj, duhej të udhëtonte çdo javë drejt aeroportit të Schonefeldit në Berlin. Sa zgjaste fluturimi me avion, ishte edhe koha e autobuzit për ta çuar në qytetin e Drezdenit. Nuk e lodhte kjo kohë e zgjatur udhëtimi, pa tymosur një cigare (nevoja për të pirë një të tillë ishte e domosdoshme si frymëmarrja), por qëndrimi ulur në ndenjësë, që mpinte të ndenjësuar. Deri në sistemimin e familjes, duhej të udhëtonte, sa drejt Dresdenit edhe të kthehej në qytetin e tij. "Bëmë me fat dhe hidhmë në hale!", ishte plotësisht e drejtë. Fati qëlloi në anën e tij. Punët shkuan fjollë. U regjistrua në bashki, ndihmuar nga kushëriri. Një bashkëfshatar, e ndihmoi për apartamentin. Të shoqes, i gjetën punë në të zezë, sa të paisej me leje qëndrimi. Qyteti, i pëlqeu. Ndërtesa të larta, rrugë të gjera, gjelbërim pafund, dy liqene të vegjël ku mund të bëje edhe serf, qëlluan afër apartamentit. Lumi i Elbës e qerthullonte qytetin, me anijeve që lundronin në të. Kisha e vjetër, shkatëruar nga bombat angleze në fund të luftës, e restauruar, shponte qiellin. Pëlqimi, ia lehtësoi dhimbjen e largimi nga vendlindja. Për punën nuk ndjeu keqardhje, aspak! Situata rodhi në një shtrat të tillë sa të ndiente njëfarë lehtësimi, por edhe mëllef për vitet që çoi dëm në këtë punë. Kishin emëruar eprorë, një kolege që punonte paralel në një degë tjetër. Gjatë kësaj kohe, kishin patur fërkime të vogla për punën. Eprorja, ishte nga ai lloj femre që ligësinë e bartin si organ të brendshëm të trupit, si veshkë, stomak apo edhe zemër... Thjesht, nga ato femra ku në qytet përdorej shprehja "Ajo, është dhi!". Fjalët e dëgjua, si shpirtkeqe dhe hakmarëse, nuk donte t'i besonte. Nuk mund të jenë të vërteta, pati menduar. Është femër, është krijesë që krijon jetë. Femrat janë qënie të buta, të ëmbla, falin qetësinë shpirtërore, ndaj duhet të jenë fjalë për smirë. Ky mendim u lëndua sado vuri këmbë në institucion. Bëri mbledhje. Broçkullisi gjerë e gjatë, për mënyrën si duhej të punonin dhe silleshin. Qëndrimi në tavolinë ishte sikur të ndihej zot i jetëve të vartësve të saj. Në fund, shqiptoi thatë, që takimi mbaroi. Ai dëgjoi gjithë kohën, me vështrim të derdhur përtej dritares. Vjeshta ishte shtruar këmbëkryq. E dashuronte këtë stinë. Gjethet e gështenjave të egra në krah të rrugëve po ndëronin ngjyrë, ndonjëra, vallëzonte drejt tokës. Lëvizti, pasi u larguan të gjithë. Si personi i dytë në drejtim, priste që ajo të kërkonte bashkëpunim dhe mirëkuptim. Por nuk u shqiptua asnjë fjalë. Duke vështruar kompiuterin, dhe lëvizur lapsin nëpër gisht, shqiptoi:

-Jam e detyruar të punojmë bashkë, por nuk kam harruar grindjet!
-Si të jetë dëshira jote, -ia ktheu qetë ai.
-Nuk kanë qenë personale, por për punë. Rëndësi ka të bëhet puna. Unë fal edhe pse më lëndojnë dhe duan të më shkelin me këmbë!
Pastaj, kishte tërhequr derën lehtë, të mos

dëgjonte kërcitjen vajtuase. Fjalët e saj, i harroi sapo u largua nga puna. Nuk vonoi hakmarrja. E vlerësoi dobët për punën në fundvit, keq në aspektin profesional. Përvoja e tij, sipas saj, ishte fluskë sapuni. U step. Zemërimi u bë lëmsh në grykë. Të shpërthente në grindje? Ndaj një gruaje? Ti kërkonte shpjegime? E kotë! Do të dëmtonte vetëm veltveten.

-Më ke vlerësuar dobët!? Nuk njoh procedurat!? -pyeti me ton ironik. -Këtë vlerësim ke ti për mua, kur vetëm tre muaj po punojmë bashkë? Konsideratë e madhe!
Kishte mundur të mbante nën fre zemërimin. Doli jashtë dhe ndezi një cigare. Pandehi, se pati shijuar një ëndërr të keqe.

Stinën e pranverës do ta shijonte si rilindje të shpirtit. Qetësia ishte arma, e përfurcuar nga indiferenca, për të anashkaluar çdo situatë nervoze të sjellë nga eprorja. Kuptoi se situata, do kishte një fund jo të dëshirueshëm, ndaj u parapërgatit shpirtërisht. E priste me mospërfillje. Ndaj filloi të mendojë për diçka të re në jetë. I pari mendim, vendosi të largonte familjen. Pastaj ndodhi ajo çfarë kishte për të ndodhur. E trasferuan në degë tjetër. Në bisedë me një nga drejtuesit në qendër, mësoi se ishte dëshira e eprorës për ta larguar. Pra, fundi mbriti. Kërkoi dorëheqje, duke mëshuar faktin se situatën e krijuar, e shihte si goditje ndaj personalitetit dhe etikës së tij profesionale. Në këto kushte, e shihte të nevojshme largimin, nuk bëhej dhëndër me zor, në një vend ku nuk e pranonin as në oborr.

Mbëriti në mëngjes në Selanik, nga do fluturonte drejt Gjermanisë. Në errësirën e natës, pati mbyllur derën e shtëpisë, duke ndjerë shtërngim në gjoks. Kudo, heshtja e plotë. Dikur, qetësia thyhej nga lehtë qenësh, por, emigrimi, bëri edhe kafshët të largoheshin. U mungonte dora që ushqente. Natën e kthjellët me yje në kupën të qiellit kur po largohej, do ta mbante mend. Agu i mëngjesit, e përshëndeti kur taksia, shkeli rrugët e Selanikut. Qyteti në zgjim, ishte i zhurmëshëm, me një lumë automjetesh nëpër rrugë. Vështrroi orën. Duhej edhe tre orë për tu nisur avioni. I pihej një kafe e fortë, por edhe të tymoste një duhan. Kafën ekspres nuk e bënin si në qytetin e tij, përsëri, pëlqente tek rrufiste lëngun e zi buzë detit. Deti e rrëmbente me pafundësinë dhe thellësinë e tij.

Në monitor, në aeroport, mësoi se avioni kishte vonesë. Shpresoi të mos vonohej shumë, sepse humbte autobuzin në zbritje. Kur nga dritarja e vogël ovale e avionit, dalloi së largu aeroportin, u qetësua. Qiellin i vrejtur, ngarkuar plot re të hirta mbi Berlin, lotoi në shi sapo zbriti nga avioni. Nga terminali deri në stacion hodhi çapat shpejt, gati duke vrapsuar, e mbrojtur nga shiu me çantën e shpinës që e mbante mbi krye. Ndali poshtë strehës së vogël në stacion, pushtuar nga udhëtarë të tjerë, duke u përpjekur të gjente një vend të lirë. Si për fat, shiu pushoi.

Dhe u gjend i vetëm në strehë. Autobusi i sapombritur, rrëmbeu të gjithë njerëzit. Pas pak, duhej të mbrinte autobuzi i linjës së tij.

-Më falni zotëri, -dëgjoi dobët një zë të zvarrët, nga pas shpine. Fjalët u shqiptuan në anglisht. -Më ndihmoni, të lutem!

Ngeli i habitur me shfaqjen e djalit. Pamja, ia përforconte idenë e mbirjes nga dheu, shfaqur nga hiçi, apo sjellë nga shiu me vete. Ishte njomëzak, ndoshta vërsnik me të birin. Nga flokët, duke zbritur në fytyrë, i lëpiheshin rëkeza të imta uji. Me siguri ka qëndruar tërë kohës nën shi, mendoi, kur dalloi se edhe rrobat i kullonin ujë.

-Të lutem, dua të kthehem në shtëpi! -vazhdoi i përgjyruar. Nga sytë i rrodhën lotë. Sytë e lodhur, ishin një me lëkurën e zbehtë të fytyrës. Nuk dallohej që të ishte përdorues i drogës. -Kam humbur portofolin, ndaj të kërkoj ndihmë... Më beso, nuk kam mundësi të komunikoj me familjen... Ndoshta...

Ky djalë, mundet të kishte moshën e të birit. Ishte imcack dhe i ndrojtur, ashtu si biri i tij. Po sikur edhe i biri, gjatë udhëtimit të tij, të ishte gjendur në të njëjtën situatë? I uritur, pa ngrënë? U ndje keq. Një lëmsh iu gërmuq në fytyrë. Gati t'i ndalte frymën. Futi dorën në xhepin e brendshëm të xhakaventos. Kaloi gishtat mbi kartëmonedha, duke i lëvizur pak. Ishin vetëm prerje të mëdha. Shqiptoi se nuk mundej dhe ndihej keq që nuk mund ta ndihmonte. Autobuzi, ndali para këmbëve. Ndërsa me njërin shtërngoi çantën në sup, dorën tjetër e futi në xhep të pantallonave.

-Hej djalosh, -i foli, duke rrotulluar pakëz trupin ndalur në mes të derës, dhe zgjatur dorën që më parë e kishte rrasur në xhep. I lëshoi në duar, gjithë sa kishte patur në xhep. Ishin disa monedha metalike dhe një kartëmonedhë dhjetëshe euro. Djaloshi, përkuli kryet dhe i puthi dorën. Përsëriti disa herë faleminderit.

-Paç fat! -i foli nga dritarja. Mbajti kokën mbështetur tek xhami, duke vështruar djalin. Siluheta e tij zvogëlohej, derisa një moment, u tret plotësisht, si të kishte qënë një njollë e vogël në hapësirën gri të aeroportit. Më vonë, e kaploi gjumi. Imazhi i djalit të panjohur po i fanepsej në atë dalldisje gjumi, duke ndryshuar fytyrë. Herë ai, dhe herë tjetër tjetërshej në fytyrën e të birit. Njëherë fytyra e kënaqur e djalit të huaj që i puthte dorën duke e falenderuar, pastaj, i biri duke thënë se me ato lek të dhëna nuk mund të blinte as një sanduic në shitoret e aeroportit. Në këtë përplasje fytyrash, midis falenderimit dhe qortimit, duket se po triumfonte e dyta. Nga dremitja u përmend dhe duke dashur të largojë ndjesinë e keqe, shkundi qepallat, lëvizti kokën disa herë majtas-djathtas. Pse nuk i dhashë pesëdhjetë apo njëqind euro, kjo pyetje, filloi ta gryente trurin e tij. Nuk pushoi së godituri në tru, edhe kur mbriti në shtëpi, edhe kur e shoqja e pyeti në t'i shtronte për të ngrënë.

-Më bëj vetëm një kafe, -ia ktheu të shoqes, gati i përhumur në një botë tjetër.

-Nuk më dukesh mirë, -vazhdoi ajo. E njihte mirë. Nga fytyra e dallonte kur nuk shkonte diçka me të. Ishte tepër i lexueshëm për sytë e saj. Edhe tani ai qëndronte ulur në ballkon, duke tymosur një cigare me vështrim të përhumur. Nuk përkëdhelte as qenin, ulur pranë këmbëve, duke iu fërkuar dhe tundur bishtin nga kënaqësia e të qenit pranë. Herët e tjera, e përkëdhelte kafshën me gishtat e dorës mbi lëkurë, i fliste fjalë të ëmbla, sikur përkëdhelte dikur birin e tyre kërtinjak. Sot, gati tjetër njeri. I heshtur në mendime. Duke i çuar kafënë vërente ngurtësimin e tij.

-Nuk të shoh mirë, ka ndodhur gjë? -pyeti e shqetësuar, tashmë edhe ajo nga gjendja e tij, duke iu ulur në krah.

Nguroi në fillim t'i tregonte, por kur hasi këmbënguljen, i rrëfeu për sa i kishte ndodhur. Edhe tani që i fliste, në sy, i fanepsej imazhi i atij djali të huaj. Sytë e tij të përgjumur, fytyrën e ligështuar duke iu damarëzuar nga lotët e shiut.

-Epo mire ke bërë, -shqiptoi e shoqja, kur ai përfundoi së treguari. -E ndihmove djalit e huaj, pse duhet të vuash tani dhe ta përjetosh keq atë situatë?

-Vërtet e ndihmova, por, a ishte e mjaftueshme ajo ndihmë? -foli ai, duke kërkuar sytë e të shoqes. -Po sikur në gjëndjen e atij djali të huaj, të panjohur për askënd në atë mizëri të pafund njerëzish, të ndodhej djali ynë?

Në apartamentin luksoz të Jetnorit dhe dashnoret së tij të parë, Dianës – në hierarkinë e dashnoreve të tij të shumta, ajo zinte vendin e parë. Diçka e ngjashme me violinën e parë në një orkestër simfonike -, po zhvillohej kjo bisedë:

-Unë kam në barkun tim fëmijën tënd. Po të dua, edhe me këtë fakt, unë e shkatërroj karrierën tënde.

Ministrit i kaluan të përqethura të çuditshme, më shumë të dominuara nga një frikë e pakuptueshme. Një lloj të tillë frike dhe pasigurie që nuk e kishte ndier kurrë më parë. Frikë dhe pasiguri që ishin në kundërshtim me fuqinë dhe autoritetin e postit të tij të lartë. Megjithatë, ai qëndroi për disa çaste pa thënë asnjë fjalë, pa e ditur nëse duhej t'ia shkrepse me të madhe të qeshurës apo të revoltohej dhe t'i përvishej me atë zemërimin e tij të zakonshëm, që shpesh e bënte të dilte nga vetja. Por nuk bëri as njërën, as tjetrën.

-Ti nuk mund të zgjedhësh shkatërrimin tënd vetëm e vetëm për të shkatërruar dikë tjetër – i tha ai dhe iu afrua aq pranë, sa ajo ndjeu frymën e tij në fytyrë – Je një djall i vërtetë! Një kurtizane e kohëve moderne... Shko thuaja këtë gjë burrit tënd, po ta mbajti!

-U trembe? Të hyri frika në palcë? – i tha ajo dhe qeshi me të madhe – Do doja të kisha një fëmijë me ty, vërtet, por nuk jam aq budallaqe sa të mbetem shtazënë dhe të privoj veten nga liria dhe kënaqësitë... Je frikacak i madh! Kot mburresh dhe hiqesh si një njeri që nuk e çan kokën për asgjë!

-Po ty çfarë të tremb?

-Mua? Asgjë... Ah, prit! Vetëm një gjë më tremb: ideja që një ditë nuk do mund të shijoj dot kënaqësitë që shijoj sot. Nuk dua as ta mendoj...

Ndjente një kënaqësi të egër, të pamëshirshme kur luante, ngacmonte apo qesëndiste burra me pushtet, qoftë edhe Jetnorin që i siguronte asaj favore dhe avantazhe që dikur ajo nuk i kishte parë as në ëndrrat e saj më të bukura.

-Përderisa jam lidhur me një burrë që ka shumë pushtet dhe shumë pará, gjithçka më lejohet – vijoi të fliste ajo me atë krenarinë e saj të njohur.

-Ah, ti je një djallushkë e vërtetë!

Pas këtyre fjalëve e rrëmbeu me forcë nga beli, e ngjeshi pas trupit të vet dhe e puti me një mënyrë të tillë, sa ajo, edhe pse e njihte mirë natyrën e tij egërshane në kësi rastesh, u tremb. Nuk bëri as përpjekjen më të vogël për t'u shkëputur nga ai, pasi e dinte mirë se diçka e tillë atë do ta inatoste deri në moskontroll të vetes. Në plot situata dhe rrethana të tjera, ai ishte në gjendje të kontrollonte veten, të shtirej, të vinte me mjeshtëri dhe marifet atë maskë që e tregonte shumë më të ndryshëm nga ç'ishte në të vërtetë. Por në raste si ky tani, apo të ngjashme me të, veprimet e tij ishin të pakontrolluara dhe të pamaskuara.

Diana u shkëput nga krahët e tij vetëm pasi ndjeu se diçka të tillë ishte gati ta bënte edhe ai. Kur ajo ishte vetëm një metër larg Jetnorit, ky i tha:

-Për një gjë jam i bindur: për sa kohë ti do kesh dhe do gëzosh një jetë si kjo që po bën tani, për sa kohë do kesh pará me grushta nëpër xhepa dhe nëpër banka, siç i ke tani, sa kohë do harxhosh pa e vrarë mendjen, do jesh kjo që je tani: e bukur, e lumur, e ëmbël dhe llozonjare.

Për disa momente mes tyre ra një heshtje. Një heshtje e ngurtë, e ftohtë, e qelqtë.

-Le të na akuzojnë sa të duan për jetën që bëjmë. Neve, sidomos ty dhe mua, aq na bën! Dhe ti e di shumë mirë këtë. Le të thonë sa të duan gazetarët dhe kritikët e zellshëm se kjo botë është e kalbur deri në zemër, ne do vazhdojmë ta shijojmë atë.

-Ata nuk thonë se kjo botë është e kalbur deri në zemër. Thonë se kjo qeverisje dhe ky sistem janë të kalbura dhe... pa zemër - e ngacmoi ajo enkas me atë diabolizmin e saj të njohur.

Donte të thoshte edhe diçka tjetër, por ai e rrëmbeu sërish nga beli dhe e puti. Kësaj here akoma më me egërsi dhe pasion të pakontrolluar instinktiv. Pastaj e lëshoi, shkoi te dera dhe pasi e kontrolloi se e kishte kyçur, e rrotulloi edhe një herë çelësin dhe u kthye drejt saj. Për një moment shkoi sërish te dera dhe pasi u sigurua se ishte e kyçur, e mori në krahë kurtizanen e tij dhe e shtriu në tavolinën e punës. I ngriti fustanin, i hoqi mbathjet dhe vështronte si i hipnotizuar seksin e saj. Ajo nuk bëri as përpjekjen më të vogël për të ndalur vështrimin e përndezur të tij. Trupin e saj elegant e la nën peshën e trupit të tij të bëshëm. Edhe nën peshën e instinkteve të tij të pakontrolluara. Ndërkohë që filloi t'i hiqte fustanin dhe e puthte gjithandej, disa letra dhe dokumente fluturuan nga tavolina dhe ranë në dysheme si gjethë të kalbura pemësh.

-Je i pangopur! Në gjithçka i pangopur je! – i tha ajo kur u shkëput pak nga krahët e tij, moment që koençidoi me një zile të zgjatur të telefonit, por ai as që i dha ndonjë rëndësi.

-Po sikur të jetë shefi i madh? – e provokoi enkas ajo.



As kjo gjë, çuditërisht, nuk i krijoi atij ndonjë turbullim, gjë që i ndodhte gjithnjë sa herë bëhej fjalë për shefin e madh. Për Udhëheqësin. Le më pastaj kur ndodhej ballëpërballë tij. Të gjithë ministrat dridheshin para tij, si ata nxënësit e vegjël që kanë shkuar të papërgatitur në shkollë dhe presin ndëshkimin e rreptë të mësuesit. Ai i qesëndiste ministrat sa me fjalorin e rëndë dhe shpesh të pakontrolluar, aq edhe me cinizmin dhe mospëfilljen e tij të zakonshme. Kishte edhe nga ata ministra, madje, që këtë sjellje të Udhëheqësit e quanin si një zbatimje të tij, apo si një terapi që ai zgjidhte të përdorte sa herë ndodhej në gjendje jo të mirë shpirtërore, nën peshën e rëndë të punëve dhe hallevë të qeverisë dhe të shtetit. Ndonjë syresh, servil i rangut të lartë, e përligite këtë sjellje të Udhëheqësit duke e argumentuar pikërisht me peshën e rëndë të punëve dhe hallevë të shtetit që binin mbi supet e tij...

Nga ana e vet Jetnori nuk binte poshtë për nga mendjemadhësia, kapadailëku dhe egoizmi. Marrëzia e tij arrinte gjer në atë pikë, sa të mendonte – madje të kishte edhe bindjen – se të gjithë e çmonin për zotësinë dhe karrierën e tij të bujshme dhe plot shkëlqim. Se brenda tij flinin aftësi dhe talente të mëdha për të bërë vepra të rëndësishme. Hipokrizinë e përsosur të vartësve të vet ai e merrte si një nderim për zotësinë dhe postin e lartë që gëzonte...

Zilja e celularit të tij ra përsëri. Tani ai mendoi seriozisht se mos ishte vërtet Udhëheqësi, ndaj brofi në këmbë dhe kapi telefonin. Me bisht të syrit – asgjë nuk i shpëtonte syrit të saj - Diana pa të shkruar në ekranin e celularit emrin "Princesha". Ishte gruaja e tij.

-Urdhëro, princesha ime! – tha Jetnori, duke u përpjekur të përmbante dihatjen.

Por "Princesha", që e njihte burrin e saj shumë më mirë nga sa pandehte ky, i tha:

-Mirë je?

-Mirë... ti?... – mundi të thoshte ai, krahëvarur dhe gjunjëkëputur nga dridhjet e epshit që ende nuk i ishin shuar.

-Ke ndonjë gjë?... Pse merr frymë me zor?

-Jo, thjesht...

-Ah, i pangopur!... E marr me mend se çfarë po bën!

-Për çfarë... e ke fjalën?

-Mos je gjë me atë kurvën?

Fjalët e fundit Diana i dëgjoji shumë mirë, por nuk i bënë asnjë përshtypje. Madje, sado e çuditshme që të duket, ndjeu një ngazëllim të brendshëm, një lloj gëzimi të zymtë, një ndjenjë epërsie ndaj gruas së dashnorit të saj. Gruaja e tij e ligjshme e dinte marrëdhënien intime të burrit të saj me një grua tjetër, por nuk kishte fuqi që ta ndalonte diçka të tillë.

Këtë skenë Diana e shijoi si një episod të vërtetë romani. Sytë e saj shkëlqyen prej triumfit të një egoizmi, që tek femra si Diana shfaqet në formën e epërsisë ndaj të tjerëve, kushdo qofshin këta.

...Ishte mbuluar i tëri nga djersët. Vetëm tani, ndërkohë që ajo po rregullonte veshjen e vet dhe po shikohej para pasqyrës, ai vuri re se gravata ishte e shtrënguar dhe i zinte frymën. Me një lëvizje nervoze të dorës së djathtë liroi gravatën.

-Kur të hipën gjaku në kokë, ti nuk e kontrollon dot veten – i tha ajo dhe pastaj shtoi: -Seksi dhe paratë janë ballsami yt!

-Thuaj edhe një herë, se më pëlqen aq shumë kur ma thua ti!

-Ti je një maniak i sëmurë pas parave dhe seksit. Nuk ngopesh kurrë me to...

-Pse, vetëm unë? Edhe ti... në mos më shumë...

Ajo besonte se te njeriu të gjitha shfaqen si

një sëmundje: dëshirat, pasionet, veset, smira, egoizmi, hipokrizia, mania për pushtet dhe pará. Madje edhe vetë dashuria dhe, bashkë me të, edhe xhelozia.

-Më duhet të ta përsëris: mos harro se nga ke ardhur! A nuk ma thua edhe ti shpesh këtë gjë? – i tha ai dhe u ul në karriken rrotulluese.

Diana, të cilës i pëlqente që disa miq të rangjeve të larta e krahasonin me Mata Harin për nga bukuria e trupit dhe dinakëria e mendjes, vërtet kishte ardhur nga bodrumet e shoqërisë, por mjeshtërisht ishte ngjitur deri në katet e larta të saj. Punonte si drejtoreshë në një ministri tjetër, jo në atë që drejtonte Jetnori. Kuptohet, atje kishte shkuar me ndërhyrjen e tij.

* * *

Në vilën e Jetnorit ajo hynte nga një rrugicë pakëz të rrahur nga njerëzit, që ia kishte treguar ai, me qëllim që kur hynte atje të shmangte kamerat që fiksonin gjithçka në pjesën e përparme të vilës. Sigurisht, të shmangte edhe gazetarët e disa kanaleve televizive, shumica e të cilëve djem dhe vajza të reja, - disa prej tyre ende pa mbaruar universitetin – që për "redaksi" kishin rrugët nga kalonin politikanët apo rrugët përpara kryeministrit, parlamentit, presidencës, bashkisë, ministrive... Thuajse të gjithë politikanët bezdiseshin nga këta gjuetarë të lajmit të fundit, sikurse u pëlqente atyre të vetëqeheshin, por e vërteta është se aspak ose shumë rrallë qëllonin që të emetonin ndonjë lajm që ia vlenë. Madje shpesh këta djem dhe vajza të reja ngjallnin një lloj keqardhjeje dhe mëshire te kalimtarët e rastit, kur i shihnin që rrinin me orë të tëra përballë kamerave dhe me mikrofonat në dorë, dimër e verë, në acar dhe në kulmin e vapës, në kohë me shi apo me furtunë.

Ai kishte dhe një apartament luksoz në zemër të Tiranës dhe ajo, që të mos diktohej nga sy kureshtarësh, futej me makinën e saj luksoze në garazh dhe që andej, përmes shkallëve të brendshme, ngjitej drejt apartamentit të tij.

Jetnori ishte një njeri i pushtetshëm. Egoist dhe tepër ambicioz. I pëlqente të ishte dominant. Por sado e çuditshme që të tingëllojë, ai ishte i fiksuar pas femrave dominatrix. Kishte patur plot eksperiencë edhe me femra të tilla, por vetëm Diana ishte ajo që ia përmushste si asnjëra këtë dëshirë deri në fiksion. Ajo e eksitonte deri në marrëzi. Diana ishte në gjendje të kënaqte edhe fantazitë e tij më të çmendura.

Mes atyre gjërave që ai pëlqente tek Diana ishte dhe kjo: Ajo i urrente pijet për femrat. Thuajse nuk pinte kurrë nga këto lloj pijesh. Në shtëpinë e saj apo në shtëpinë e dashnorit dhe bosit të saj, në zyrën e saj apo në zyrën e tij, por edhe në lokalet e shtrenjta ku shkonte, - në Tiranë apo në shumë qytete të botës ku udhëtonte shpesh – ajo porosiste vodka me akull, xhin, tekila dhe verë.

Diana po e rronte jetën e vet në një kornizë të praruar, brenda së cilës kishte gjithçka. Ndihej vërtet e lumtur, megjithatë thellë brenda vetes kishte edhe një pasiguri. A ishin të mjaftueshme caqet e kënaqësisë dhe lumturisë që ajo po shijonte prej vitesh, që nga koha kur në lidhjen me Jetnorin e pushtetshëm po gëzonte një jetë gjithnjë dhe më luksoze? Shpesh brenda vetes thoshte se "kam siguruar gjithçka që kam kërkuar në jetë, çfarë të kërkoj më tepër?". Por nëse nuk mund të përcaktonte dot caqet e lumturisë, deri ku shtydheshin dhe zgjeroheshin ato, ambicia dhe egoizmi i Dianës e yshtnin parreshtur që të kërkonte gjithnjë e më shumë nga jeta. E nanurisur dhe e dehur nga avuj ëndrrash kënaqësie dhe lumturie, ajo dëshironte dhe shijonte aq shumë, sa shpesh fantazitë e saj merrnin krahë dhe flakë. Diana, sa nga përvoja

e vet aq edhe e të tjerëve, e kishte përvetësuar fort mirë mësimin e jetës se pa ambicie nuk fillon asgjë. Se pa ambicie nuk fiton asgjë. Se pa ambicie nuk mund të shkosh shumë larg, edhe sikur rrethanat e jetës të jenë të favorshme.

Nëse jeta është një monedhë, ajo kishte ambicien e thellë që këtë monedhë ta shpenzonte ashtu si dëshironte ajo dhe askush tjetër.

Ndryshe nga shumë njerëz që duan një lumturi të thjeshtë në jetë, pa luks dhe pa shumë salltanete, Diana ëndërronte dhe në fakt shijonte një lumturi plot bollëk, mirëqënie dhe shkëlqim. Nëse për shumë njerëz që e njihnin nga jashtë ajo ishte e përkëdhelura e fatit – dhe këtu sigurisht që gaboheshin -, e vërteta është se ajo kishte bërë gjithçka që fatin ta kishte në anën e saj. Me një vetëbesim dhe krenari për t'u patur zili, ajo kishte vënë gjithçka në shërbim të ëndrrës së saj për një jetë dhe lumturi luksoze: trupin e bukur si të një balerine, zgjuarsinë dhe dinakërinë e pakonkurrueshme. Ishin të gjitha këto që i jepnin ritëm dhe frymë jetës së saj.

Sa për Jetnorin, ky ia kalonte ku e ku zotit Grande të Balzakut, që sa herë i paraqitej një rast i volitshëm hapte gurmazin e qeses së tij dhe kullufiste një tok me pará. Vetëm në fillim, kur Jetnori iu fut politikës, paratë e tij mateshin me qese, pasi me kalimin e kohës gurmazi i qeses u bë grykë e madhe dhe qesja u bë një thes i fryrë me paratë që i atij i vinin prej çezmës së pushtetit, aq sa edhe ai vetë – plot gjashtë vjet në postin e lartë qeveritar - nuk e dinte me saktësi se sa pará kishte.

Ai kishte një adhurim të pandryshueshëm për paratë dhe jetën luksoze. Mund të toleronte apo edhe të shpërfillte diçka për një farë kohe, por adhurimi për paratë dhe jetën luksoze ishin të pandryshueshme, siç ndodh me disa zakone, rite dhe doke, nga të cilat njeriu e ka të vështirë, në mos të pamundur, që të shkëputet. Diçka e ngjashme me atë nevojën apo vesin e një prostitute, e cila fillimisht i futet prostitucionit thjesht dhe vetëm për të fituar pará, por që nuk heq dorë nga shitja e trupit të vet edhe kur ka fituar aq sa ka siguruar jetën dhe tani nuk e bën vetëm për të holla, por edhe si një nevojë e brendshme që i ndjen trupi për të mëkatuar. Në këtë rast ndodh ky ndryshim për këtë tip prostitute: në fillim në ndjenjat e saj dominonte shija e parasë, ndërsa më vonë shija e mëkatit të trupit.

Nëse besimtarët ndaj Zotit krenohen me pastërtinë e shpirtit dhe me mëshirën, besimtarët ndaj pushtetit dhe parasë krenohen me imoralitetin shpirtëror dhe me egoizmin e pafre.

* * *

Diana kishte qënë një trup elegant, por edhe një zë të ëmbël dhe melodioz, aq sa edhe një këngëtare do t'ja kish zili. Freskia dhe delikatesa e tipareve të saj bënin përshtypje edhe tek kodoshët më të regjuri, të cilët në jetën e tyre arkivonin lidhje të shumta erotike me vajza dhe gra të bukura dhe të pasura.

-Ti, Diana, je nga ata tipa të rrallë njerëzish që ose mund t'i shmangësh, ose t'i luftosh. Por të shmangësh ty është gati e pamundur. Ti zotëron një fuqi joshjeje, thuajse të pazezistueshme. Por edhe të luftosh ty, kjo është e rrezikshme. Gati të gjithë i tremben fuqisë së hakmarrjes dhe zemërimit tënd. Kështu që njerëzit nuk zgjedhin as të të shmangin, por as të të luftojnë – i thoshte shpesh Jetnori, i cili te Diana gjente dashnoren, miken, bashkëpunëtoren në punërat e fshehta dhe përfitimet që i siguronte prej postit dhe njohjeve të shumta që kishte gjithandej.

-Ti je thesari im i vogël! – i thoshte ai me përkëdheli.

-Nga ky thesar i vogël ti ke përfitime aq të mëdha! – ia priste ajo.

-Ti je besnikja ime! Jo në atë kuptim që shumica e burrave kërkojnë besnikëri te partnerja e tyre.

-Edhe ti je besniku im! Në atë kuptim që ti dhe unë e dimë shumë mirë...

Si Diana, si ai, kishin nevojë për mbështetje ndaj njëri-tjetrit.

Të dy e shfrytëzonin njëri-tjetrin. Të dy kishin një raport epërsie dhe varësie ndaj njëri-tjetrit. Ajo e përdorte si perde Jetnorin. Por edhe ky e përdorte si perde Dianën.

"Unë bëj gjithçka si skllave e tij. Ai paguan që të jetë eprori im. Unë, nga ana tjetër, bëj gjithçka që ai dëshiron. Që të dy jemi njëherësh skllavër dhe padronë të njëri-tjetrit. Kështu funksionon" – i kishte thënë një ditë Diana një shoqes së vet.

Pastaj, fytyrëvretur, me një zë gati të pikëlluar dhe me një dhembje të çuditshme në shpirt, kishte vazhduar:

-Të tjerët, ata që më njohin vetëm nga jashtë, mendojnë se jam e lumtur dhe e shpenguar. Por... Ah, varësia dhe frika e vazhdueshme që fle brenda meje se mos një ditë i humbas këto privilegje, më krijojnë ndjesinë se jam në çdo kohë e lidhur me pranga. Me pranga të padukshme.

NATA KA SHKUE THELLË, POTHUEJSE N'PRAG DITE...

Nata ka shkue thellë, pothuejse n'prag dite. Deti fle, ne lëvizim, ecim, e humbim veten, mu si nis me e humb veten, hana mbi ne.

Befas, ajo ndalet, m'thotë:
"Ti shkruen me kaq shumë zjarr."
"Nganjihërë, po."
"Jo nganjihërë, po gjithëherë."
"Gjithëherë, kur i shoh, a kur m'bungojnë sytë e tu."

Ajo shtanget nga habia që i ndodh. M'thotë:
"Or ti! Po m'thue që jam unë ajo?"
"Gjithësesi, po."
"Por, po gënjen. Nuk kemi gja bashkë. Ajo... vdiq para do ditësh."

"Vdiq edhe nuk vdiq."
"Por e lexova t'shkruajtun nga dora jote... te ajo novelë."

"Ishte një gënjeshtër."
"Letërsia bën edhe gënjeshtër?"
"Letërsia?... Letërsia, sidomos..."
"Po dashunia? Ban gënjeshtër... dashunia?"
"Edhe ma shumë. Edhe ma keq. Madje, madje..."

Ndalem, nuk e vazhdoj fjalën ma tej. Ndjej se asht lëndue.

"Po thueje!", kambëngul ajo, pothuejse sylagun: "Ç'madje?..."

Nuk ia them. Nuk kam me ia thanë kurrë. Nuk due ta lëndoj edhe ma, me të vërtetat e jetës që nuk i ka njoftë akoma. Asht e re. Kaq e paditun asht, kaq e papërvijë. Në vend se me i thanë një të vërtetë, a një gënjeshtër letrare, zgjedh t'ia përthith gojën (s'pari herë), dhe e vdes... e vdes... tuj e dashtë... ma shumë se njimendshëm...

AJO KA ARDHË SËRISH...

Ajo ka ardhë sërish. Por sot, disi, ka një shikim ma t'mprehtë, ma goditës. Me gjasë, asht ba edhe ma delikate.

Nuk arrij me ditë, a ban ironi, a çka ban ajo, por saktësisht e ndigjoj si m'thotë: "T'qenkan zverdhun gishtat, duert."

I dëshpëruet nga ç'ndigjoj, i them asaj: "Jo veç gishtat, duert..."

"Edhe çka tjetër?" - m'pyet ajo, tuj i përpëlilitun sytë e bukur, sytë e blertë.

"Edhe shpirti, edhe shpirti." - i përgjigjem unë.

Ndalon ajo, nuk flet një hop, dhe vazhdon me folë, por, si me veten: "Nga sa t'lexoj, shpirti akoma nuk t'asht zverdhun."

"Jo veç zverdhun, po... edhe kalbun." - i them unë.

Ajo m'sheh disi habitshëm, e mbyll gojën, hesht. Hesht, hesht, hesht, dhe... ndez një cigare. E thith, e pi deri ngjysmë, dhe e fik, ndez një tjetër.

E shoh ashtu, e shoh t'atillë, edhe mendoj njikohshëm: "Ka me ikë?... Apo ka me gabue, dhe ka me vendosë me ndejtë e me u kalbë edhe ajo, tuj e lexue... tuj e përpushë këtë kalbësinën time, që tashma, s'di as sa bajnë dy plus dy, dhe ka fillue... ka fillue... mos me e njoftë... as veten?..."

THUPËR

"Jam ba si thupër", m'thotë ajo, "Mbas lexoj, dridhem."

E pyes: "Mbas lexon çka?"
"Epo, letërsi."

"Mbas dridhjes, çka ban?"
"Dal, shkoj n'banjë.", m'thotë ajo.

"Çka ban n'banjë?"
"Gjithë ç'mendoj se ka me m'u dashtë: i laj dhambët, fytyrën, lyhem, parfumosem, shikohem n'pasqyrë, e forcoj besimin."

"Kur del prej banje, ç'ban?"
"Kujdesem me u veshë sa ma bukur, sa ma... hanënisht, dhe... dal, dal, shkoj..."

"Ku?..."
"Atje ku asht dorëhequn hana."

"Çka ban... atje?"
"Gjana t'reja."

"Ç'gjana t'reja?"
"Epo, t'reja. I praktikoj gjanat që kam lexue..."

"Si?... Me kend?"
"Me një cjan hanor."

"Kush asht ai cjan hanor?"
"Ti.", m'thotë ajo.

Oh, m'sillet bota përreth kreje, sa m'vjen me

SHAZIM MEHMETI

Ajo ka ardhë sërish

tregime



e zanë për futi, me e mbyttë, por i baj llogaritë sakaq, dhe ndërroj mendje: e marr rishtas n'përqafime, rishtas e marr n'shpërbamje...

(Njimend, kur e mendon gjanë paksa ma mirë, ma mirë t'del me qenë i përjetuet, si një personazh i përdorun letërsie, se me qenë një personazh real e duerbosh. N'fund t'fundit, ajo asht reale. Ajo asht ma reale se kjo dritë, që pikënisht tani, i bie mbi flokë, mbi fytyrë, dhe... e ban t'bukur e t'bukur... deri ndridhje...)

NJI PAFAJËSI... QË MA PRISHI JETËN...

Kaloja, një ditë, jo bash, po shumë afër një vendkalimi për kambësorë, kur që, një veturë e bardhë, m'u ndal befaz përpara kambësh.

E ngrita disi dorën e majtë në shenjë falënderimi, besoj se e falënderova atë njeriun e veturës edhe me një përlulje koke, dhe nisa tutje drejt trotuarit.

Për çudi, ajo veturë, e kaloi paksa, vendkalimin për kambësorë, ndaloi, dhe shoferi zbriti furrishëm dhe u drejtue drejt meje.

"Ç'ishte ajo lëvizje dore, mor çallak?" - m'tha gjithë nervozë ai.

"Po... t'falënderova... mor mik." - ia ktheva unë, me mirësjellje.

"Qe ku po të falënderoj edhe unë ty!" - m'tha ai, dhe m'futi një grusht të fortë, hundës.

M'dhimbti shumë. E preka hundën me dorë, dhe pashë se jam përgjakun.

Mëtova me qenë vetja, me i lëshue rrugë atij njeriu nervoz, por ai m'dha edhe dy grushta të tjerë, që m'shkaktuen një dhimbte që m'shko deri n'thembra. M'kapi edhe për fyti, ai njeri, dhe tuj qenë ai sipër meje, fillova ta ndjej mungesën e frymës, për aq sa duert e mia m'patën dalë jashtë kontrolli. Duert e mia, ma saktë e majta, hyni n'xhep t'pantallonave të mia, e gjeti biçakun e vogël me të cilin shërbehem për me qerue nganjihërë ndonji mollë, dhe... fatkeqësisht, mbaroi biçaku im i vogël ngjoksin e tij...

Kështu ndodhi, dhe u bana vrasës. N'burg jam tashti, dhe... po i shkruaj kujtimet...

NJI TAKIM ME PAPËN

Monika Belluçin, nuk e zuni gjumi, përgjatë gjithë natës. Ndihej mezipritëse, kishte shumë adrenalinë, shumë mendime. Ajo, nditën e nesërme, bashkë me kolegen e famshme Kejt Blanshet, do takohej me papën.

Kjo grue e famshme, mbrenda natës, doli disa herë para pasqyrës, tuj analizue si me u veshë e si me u ndreqë nesër, për takimin me papën.

Edhe Kejt, njisoj si Monika, nuk fjeti gjithë natën. Edhe ajo, mbrenda natës, doli disa herë para pasqyrës, tuj analizue si me u veshë e si me u ndreqë nesër, për takimin me papën.

Çuditnisht, edhe pse n'apartamente t'veçanta, të dy gratë e bukura, kishin pas vendosë, që para papës, mos me dalë fort t'ndrequna e t'lyeme si përherë, po me dalë sa ma natyrale, dhe t'vëshuna e t'mbulueme, pa asnjë lloj shplimi. Të dyjave, ua kishte marrë mendja se para papës, do duhej dalë simbas normave morale të fesë.

Të nesërmen, kur u doli papa përpara, dy grave t'bukura u vezulluen sytë, por për dreq, nuk i vezulluen sytë papës. Papës, sa i pa dy gratë ashtu t'mbulueme e jo fort t'ndrequna, i ra mbi fytyrë një tis hidhënimi. Mezi i përshëndeti papa gratë, dhe përgjatë gjithë kohës së takimit, ai u soll me ta, ma ftohtë se ftohtë.

Mbetën disi t'habituna dy gratë e famshme, mbetën me një lloj pengu, dhe n'fund të takimit, Monika, që u tregue pak ma e shpejtë dhe ma guximtare se Kejt, e pyeti papën:

"I dashtun at, nuk m'u duke me disponim t'mirë! Mos vallë kemi gabue, ne dyja, ndonji gja?..."

Papa, e drejtoi mirë trupin, u fut me një shikim t'njihershëm n'sytë e të dyjave, dhe me një za t'ulun sa për të mbërritun veç deri te veshët e dy grave, ua tha këtë gja:

"O, shpirtna t'bukur! Nuk ju prisja kështu si keni ardhun ju! Ju prisja, si ju kam pa gjithëherë, ma t'zhvëshuna... ma t'lyeme..."

Këtu papa e ndali fjalën, u afrue edhe ma shumë, dhe... pothuejse tuj ua puthë veshët, u foli n'vëshët të dyjave:

"Besomëni, o engjëj! Do ta kisha dhanë gjithë papëninë time, dhe gjithë besimin e jetës sime... veç t'ju shoh... t'ju prek... lakuriqe... jo veç e veç, po bashkabashkë... të dyjave..."

GJITHNJI SINGËL

Rastësisht, e shoh ulun, n'rreshtin shtatë t'amfiteatrit, ku vijon me u mbajtë një konferencë shkencore. Se si m'duket, se asht... e bukur, e bukur... (si vdekja).

Si vdekja?...

M'prishet rehatia. Kundrejt pranisë së saj, nuk muj me qenë indiferent. Disi... edhe frikohem... Edhe ligjërimet janë... disi monotone... disi boshe.

Ngritem, baj me dalë, tuj u lutë n'vete t'mos dalë edhe ajo.

Por... për çudi, ndodh e kundërta e lutjes sime: sa kthej kokën me pa, a del, a s'del ajo, e shoh tuj dalë.

"Hej, ti!" - m'flet q'andëj ajo, me atë zanin e bukur që s'ia ka shoqin. - "Prit pak, prit!"

Ndalem, e pres - ajo ma zgjat dorën (e ftohtë!), dhe buzëqesh si buzëqesh një lule n'maj.

"Bashkë do pijmë nga një kafë." - m'thotë ajo.

"Ani mirë.", i them, mezi.
"Jo vetëm kafë." - m'thotë ajo. "Edhe do

pimë, do dehemi. Edhe..."

Asht kaq e lirë, sa ngushtohem fort, ndihem disi keq.

"Jam burrë i martuet." - i them unë.
"Unë jam singël." - m'thotë ajo - "Gjithnji, singël. Gjithnji, singël."

"Por, tashma, jam kaq plak.", i them unë.
"Aq ma mirë. As unë s'jam e re sa isha." -

m'thotë ajo, dhe... ma fut krahun... m'merr... edhe m'shpie... n'katin e shtatë t'qiellit, atje ku ndodh barazimi i moshave... barazimi i statuseve...

(!!!!????...)

E PASHË N'NJI KAND...

E pashë n'një kand, veçuet prej të tjerësh. Pothuejse ngjysëmterr e pashë. Rrinte mbështetun për një parmaku. Thithte cigare. (Një yll që thith cigare!)

Kur iu afrova, u gjet disi si e papërgatitun. M'shikoi me sytë që mezi ia shihja, m'përshëndeti. I dhashë dorë, m'dha dorë, dhe pa iu prezantue, zgjata dorën, ia dhashë librin tim t'fundit. Pa autograf ia dhashë.

Ajo e hapi librin n'faqen e parë, e ngriti kokën, dhe m'shikoi n'sy, me sytë që i qeshën. Goja iu hap paksa, i shndritën dhambët e bukur.

"Nuk ban kështu!" - m'tha. - "E due me nënshkrim."

Ia mora librin nga dora, edhe n'faqen e parë t'librit, e shkruajta këtë tekst:

"Yllit, grues, a vajzës, që nuk e njoh, por për të cilën mendoj se e do fjala. Yllit, vajzës, a grues ngjysëmterr, që thith tym duhani, dhe po ma merr zemrën, me buzëqeshjen e bukur."

Ia dhashë librin, ajo e lexoi tekstin që e shkrova.

Kur i ngriti sytë me m'shikue, pashë n'sytë e saj, një zjarrmim t'papamë, që ia ndizte secilën molekulë t'syve.

Nuk tha gja. Veç buzëqeshi edhe njihërë, dhe ma ktheu shpinën, edhe iku me librin n'dorë, si me u frikue prej vetes.

Kurrë ma nuk e takova, nuk e pashë, atë vajzë, a grue, a yll. Dhe... as sot e kësaj dite nuk e di, çka e bani atë grue, a vajzë, a yll, t'i ndizen ashtu, sytë e bukur: e bani fjalia "Yllit, grues, a vajzës, që nuk e njoh, por për të cilën mendoj se e do fjala.", apo e bani fjalia "Yllit, vajzës, a grues ngjysëmterr, që po thith tym duhani, dhe po ma merr zemrën, me buzëqeshjen e bukur..."

(Ky rrëfimi im i vogël, i thjeshtë, nuk ka asnjë kuptim, po të mos uroj që ajo vajzë, a yll, a grue, të jetë akoma ngjallje. Ky rrëfimi im i vogël, i thjeshtë, nuk do kishte asnjë kuptim, edhe pa e thanë troç se dëshirimi im, ishte dhe asht, që asaj vajzë t'i jenë ndezun sytë, nga ajo fjalia e dytë: "Yllit, vajzës, a grues ngjysëmterr, që po thith tym duhani, dhe po ma merr zemrën, me buzëqeshjen e bukur..."

DASHUNIA ASHT GJAJA QË M'I LIDH FORT, ATDHEUN DHE GRUEN...

Dashunia asht gjaja që m'i lidh fort, atdheun dhe gruen. Gjithnji, i kam dashtë, pothuejse njisoj, atdheun dhe gruen. Besuet a jo, gjithnji kam dashtë edhe me i tradhtue, por nuk kish pas qenë e shkruet.

N'rini, atdheun nuk mund ta tradhtëtoja nga një arsye frike. Kisha frikë se mund të mbetesha pa fare atdhe. Edhe gruen që e doja shumë, nuk mund ta tradhtëtoja, nga një arsye frike. E doja shumë, për dreq, dhe kisha shumë frikë se ka me m'lanë.

Kur bana njëfarë moshe, atdheun dhe gruen, nuk munda t'i tradhtëtoj, nga një arsye dhembshunie. Atdheu m'ishte n'një gjendje t'atillë që mezi mbahej m'kambë. Edhe grueja kalonte nëpër një sëmundje t'randë, sa nuk e tradhtëtoja dot.

Tashti që jam mplakun e jam ba stelë, atdheun nuk mund ta tradhtëtoj, sepse asnjë anmiku s'i ban punë, një tradhëtar me një kambë n'varr. Edhe gruen s'mund ta tradhtëtoj, sepse s'kam me kend: asnjë grue tjetër nuk m'hedh një sy.

Veç kësaj, asht edhe ajo arsyeja tjetër, ajo arsyeja morale. Atdheu m'asht mplakë, jo ma keq se unë, po ma keq se prindtë e mi. Kurse grueja... grueja m'asht ba... motër.

Po si u baka, një burrë i mbarë, me i tradhëtue prindtë... motrën?...

Kur përgaditja për botim librin 'Antologjia e poezive K më të bukura të Botës' - botuar në vitin 2025 nga Shtëpia Botuese MediaPrint, - nuk arrita të përkthej në kohë asnjë poezi të Simon Armitage (lexohet: Sajmën Armitiixh). Aso kohe ndodhesha në Tiranë, dhe librat poetik të gjuhës angleze i kisha lënë në biblioteken time të Londrës. Mungesa e poezive të Simon Armitage në Antologjinë e përmendur është dhe pengi i vetëm i imi për këtë libër.

Ç'është e verteta, ky peng më ka ndjekur ca kohë në heshtje. Ndonëse me vonesë, dëshëroj t'u jap lexuesve të gazetës ExLibris zgjedhjen dhe përkthimin e disa poezive të këtij Poeti, i cili është dhe një nga poetët bashkëkohorë më të njohur në Mbretërinë e Bashkuar, por dhe si dramaturg, romancier dhe përkthyes. Ai lindi në Yorkshire në vitin 1963 dhe filloi të shkruante poezi që në moshë të re. Përmbledhja e tij e parë, *Zoom!*, u botua nga Bloodaxe në vitin 1989 dhe pati menjëherë sukses, duke u shitur mirë dhe duke u përzgjedhur në listën e ngushtë për çmimin Whitbread për poezi. Simon Armitage u emërua UK Poet Laureate, në Majin e vitit 2019, për një afat 10 vjeçar.

Poezitë e Armitage-it njihen për humorin e tyre të errët, qartësinë dhe lojën artistike. Thjeshtësia e tyre e dukshme shpesh fsheh një botë komplekse emocionale dhe pasqyron ndikimin e poetëve të rëndësishëm të shekullit XX, sidomos ndikimin e Ted Hughes, W.H. Auden dhe Philip Larkin.

Janë gjithësejt 3 poezi, dhe njëra prej tyre, ajo që i kushtohet Nënës, që botohet përngjat origjinalit anglisht, është njëra nga poezitë më të njohura për autorit (u botua për herë të parë në vitin 1993). Duke i hyrë në hak poezive të tjera, desha të them dy fjalë për këtë poezi.

... Është njëra nga qindramijat e poezive të njerëzimit të shkruara për Nënën. Por veçse një poezi tepër origjinale, me një sistem metaforik të ngjeshur e të fuqishëm, që shtjellohet gradualisht nga një vetjake e zakonshme realiste në një simbolikë të fuqishme përgjithësuese.

Në pamje të rrejshme, kjo poezi ngjan me një sonet. Por është një sonet i padisiplinuar aq keq, sa lexuesit dhe kritikët tanë buzëhollë të Tiranës, Prishtinës dhe të periferive të Shkupit do të shtrembëroheshin për të gjetur fjalët e duhura të mospëlqimit të tyre për injorancën e autorit në mosnjohjen e disipline së rreptë të sonetit. Në të vërtetë, edhe kjo poezi ka katër strofa, dy të parat me strofa katërshe, dhe dy të fundit me strofa treshe. Vargu i fundit është tepër i shkurtë - ka veç katër fjalë - dhe ajo që është më e keqja, është një varg i tepërt. Një varg që shfaqet si një strofë e pestë e sonetit!!! (soneti, siç dihet, ka 14 vargje gjithësejt, dhe katër strofa - 4,4,3,3, ndërsa ky varg shtesë i Simon Armitage është vargu i pesëmbëdhjetë i Sonetit, dhe strofa e pestë e tij). Dhe, si duke dashur t'i bëja gjërat dhe më lamsh, këtë poezi m'u dha ta përktheja në gegnisht!!!

Tri poezi të laureatit të sotëm të Anglisë: Simon Armitage

Nga Rudolf Marku



Në poezinë e Armitage-it, një folës pa emër po bën matje të dritareve, dyerve, mureve e kështu me radhë, sepse sapo është transferuar në një shtëpi të re. Nëna e folësit ka ardhur për ta ndihmuar, duke mbajtur njërin skaj të metrit, ndërsa folësi lëviz rreth shtëpisë. Gjatë gjithë poezisë, nëna dhe folësi paraqiten të lidhur me njëri tjetrin, në kuptimin literal ashtu edhe në atë metaforik, me shiritin e metrit—dhe poezia nënkupton se kjo lidhje gjithmonë ka ekzistuar dhe gjithmonë do të ekzistojë. Poezia, pra, është një lloj homazhi ndaj fuqisë dhe madhësisë së një marrëdhënieje po aq të vjetër sa vetë njerëzimi: ajo mes Nënës dhe fëmijës të saj.

Poezia e demonstroi këtë lidhje përmes metaforës. "Bobina e metrit" (metri matës) që shpaloset midis folësit dhe nënës ndërsa matin shtëpinë është referenca e umbilical cord - e kordës së kërthizes, lidhja primordial e lidhjes së Nënës dhe Fëmijës që u lind. Edhe pse kërthiza pritët në lindje, ajo që përfaqëson mbetet e vërtetë: se nëna dhe fëmija do të jenë gjithmonë të lidhur (madje edhe pasi folësi largohet dhe krijon një shtëpi të re!).

Dhe ja papritur, lexuesi ndesh një togfjalësh që duket se nuk ka asnjë lidhje me atë që përshkruhet - Spirancë dhe Balonë - shkruan krejt papritur, poeti, në fundin e një vargu. Dhe ky togfjalësh është dhe simboli më i

bukur i vetë poezisë. Nëna është spiranca, është zona e përjetshme e sigurisë dhe e rehatisë për fëmijën, ndërsa fëmija është Balona që, edhe pse do të ngrihet lart në qiej, ngase do të shpëputet nga spiranca, filli i saj është i mbajtur nga dora e Nënës. Folësi është Fëmija-balonë, i inkurajuar të eksplorojë duke ditur se nëna është poshtë, duke mbajtur skajin tjetër të fijos figurative.

Megjithatë, edhe në këtë lidhje të shënjt, vjen një moment kur folësi arrin një "pikë thyerjeje, ku diçka duhet të lëshohet me mirëkuptim". Në kuptimin literal, metri që lidh nënën dhe fëmijën është shtrirë aq sa mundet; Nëna përpriqet instiktivisht që të mos e lëshoj fillin lidhës me të birin (...majat e gishtave të tu ende shtrëngojnë/ t'njëqindtën e fundit t'nji inçi që s'e lëshon...)- edhe pse e ndjen se ka ardhur koha për ta lëshuar balonën në fluturimin e vet të lirë; në një nivel më simbolik, edhe vetë folësi thotë se ka ardhur koha të largohet nga rehatia e Çerdhës, dhe se është koha "me ra ose me fluturu" —të ketë sukses ose të dështojë— në mënyrë të pavarur. Folësi e kupton se njerëzit duhet të rriten përfundimisht dhe se nëna nuk do të jetë gjithmonë pranë, por poezia sugjeron se gjurma që ajo ka lënë tek fëmija i saj, do të mbetet. Dashuria dhe mbështetja e saj i kanë dhënë folësit besimin për të qëndruar në këmbët e veta—për të krijuar një shtëpi të vetën.

Le t'i kthehemi edhe një herë vargut të 'gabuar' të Sonetit, vargut të pesëmbëdhjetë të tij - to fall or to fly - me ra a me fluturu. Edhe ky varg është gabuar mjeshtërisht prej Poetit. Ky varg shtesë, që vazhdon jashtë rregullave metrike, nuk është tjetër veçse simboli i vazhdimësisë së përjetshme të lidhjes mes Nënës dhe krijesave të saj - edhe atëherë kur mendohej se Soneti është mbyllur!

Ndoshta ky spjegim i poezisë së Simon Armitage ka një ton shkollaresk, por e quajta të nevojshme të shkruaja (mund të vazhdoja dhe me katër faqe të tjera) këto pak rrjeshta, për të thënë se poezia bashkëkohore, edhe përmes sofistikimeve shprehëse gjuhësore dhe metaforike, nuk është kurr një boshllëk dhe një - engletisje mendore - siç shprehet me të drejtë një miku im poet, ose një vulgaritet i brohoritur nga turmat, por mbetet gjithmonë një gërmim në minierat e gurëve të çmuar të mjeshtresë dhe humanizmit të madh të vetë letersisë.

SIMON ARMITAGE

NJË ANTOLOGJI E POEZISË NË ANGLISHT


Të përpilosh këtë antologji të rëndësishme të poezisë në Anglisht rreth qenve dhe instrumenteve muzikore është si të notosh përmes tullave.

Deri tani, kam vetëm "Për vdekjen e qenushit të zonjës McTuesday, që u vra nga rënia e pianos" - deri diku e qartë përse kjo zgjedhje.

Është e vërtetë që një harpë Eoliane pëshpërit joshëse në sfondin e sonetit anonim "Qeni i Gjuetarit", por përtej kësaj — heshtje.

Duhet t'i rezistoj punës time të shplarë në favorin e shkrimeve të mia, ku padyshim përmbushja e kënaqshme e imja arrihet

Por Adam Smith më vështron me mburrje nga pas kartëmonedhës njëzetpound-dshe, dhe kur menaxheri im i Bankes qesh me të madhe, grimca të vogla pështyme shpërthejnë si shi meteorësh nëpër pafundësinë e hapësirës së errët midis botës së tij dhe times.



FALEMINDERIT QË PRITËT

Në këtë moment në kohë, do të donim të ftonim vetëm pasagjerët e Klasit të Parë për të hipur në avion. Faleminderit që pritët.

Tani e zgjerojmë ftesën tonë për anëtarët e klubeve Ata që Bëjnë Përjashtim, Superiorët, Të Privilegjuarit dhe Të Shquarit , të ndjekur nga anëtarët Platinum trefish, dyfish dhe njëfish, të ndjekur nga mbajtësit e kartave Ar, Argjend , Bronz, të ndjekur nga anëtarët e Klubit Perlë dhe Koral. Personeli ushtarak me uniformë mund të hipë gjithashtu në këtë moment. Faleminderit që pritët.

Tani ftojmë klientët Meteorë dhe pasagjerët e regjistruar në skemën tonë Metalet e Ralla të Tokës, pikë dhe shpërblime, dhe faleminderit që pritët. Personat e akredituar si të Bukur mund të hipin tani, si edhe çdo zotëri që mban një kopje të revistës së këtij muaji *Cigar Aficionado*, si dhe abonentët e skemave tona Diamond i Kuq, Opali i Zi ose Guri i Çmuar Blu.

Mirëpresim gjithashtu anëtarët Safir, Rubin dhe Smeralt në këtë moment, të ndjekur nga anëtarët e gurëve të çmuar Amethyst, Onyx, Obsidian, Jet, Topaz dhe Kuarc. Klientët e Krahut të Privilegjuar, Sherbimit të Menjëhershëm, Elitës së Zgjedhur, Shërbimit të Preferuar, dhe Të Parët Mes të Barabartëve mund të hipin gjithashtu tani.

Me paraqitjen e një fature të vlefshme, udhëtarët e elegancës dhe stilit që mbajnë veshje dizajni dhe/ose të qepura me porosi me një vlerë minimale prej dhjetë mijë dollarësh amerikanë mund të hipin tani; pasagjerët që mbajnë artikuj bizhuterie (përfshirë orët e dorës) me një çmim blerjeje më të lartë se paga mesatare vjetore e një mësuesi të shkollës së mesme në mes të karrierës, janë gjithashtu të mirëpritur të hipin.

Të mirëpritur në këtë moment janë edhe pasagjerët që flasin me zë të lartë në kufje celulari për marrëveshje aksionesh të përfunduara së fundmi, blerje pronash dhe marrje agresive në kontroll, si dhe menaxherë fondesh mbrojtëse me histori të provuar në minimumin e ambicieve të vogla e të mesme. Pasagjerët në klasat K’netor, Gëlqeror, Guror, dhe Argjiror mund të hipin gjithashtu. Klientët që kanë blerë paketat tona Dinjitet ose Zambaku i Mengjezit mund të marrin tani kostumet e tyre sportive të dezinfektuara para hipjes.

Faleminderit që pritët. Pasagjerët mediokër ftohen tani të hipin, të ndjekur nga pasagjerët që u mungon aftësia për biznes ose potenciali i vërtetë për udhëheqje, të ndjekur nga njerëz me pak ose aspak rëndësi, të ndjekur nga njerëz që operojnë me humbje fiskale neto si qenie njerëzore. Ata që mbajnë bileta për zonat Ndryshk,Krunde ,Kartuç Pellg dhe Ranë nëse dëshirojnë , mund të fillojnë tani të mbledhin pecetat dhe thërrimet e tyre para hipjes.

Pasagjerët pjesërisht ose plotësisht të varur nga ndihma sociale ose mirësia e të tjerëve, ju lutemi të verifikoni kuponët tuaj të udhëtimit në Sportelin e Karantinës. Djersë, Pluhur, Demodë, Kore, Jashtëqitje, Byk, Mbetje, Hi, Qelb, Lluca, Skorie, Ashkla dhe Blozë; të gjithë ju jeni tani të lirë të hipni.

NANË, ÇDO LARGËSI

Nanë, çdo largësi ma e madhe se një pëllambë,
lyp një palë duarsh të dyta pranë;
Ti vjen me m’ndihmë me mat dritare, dyer, perde,
hektarë muresh, lendina dysHEMEJE.

Ti në piken e fillimit, unë me spiralin e metrit ndorë, tue shënue,matë
gjatësitë , metra e centimetra duke t’i thanë, ty za-naltë
e mandej tue u largue,ngjitë shkallëve, filli ende tue u shpalosë, derdhë
vitet mes nesh. Spirancë. Balonë.

Unë shkel hapsinat e dhomave bosh, ngjitem
shkallës për në trapazan, deri n’pikë t’kputjes, kur më nuk mbanë,
duhet me ba lëshim;

dy kate ma poshtë, majat e gishtave të tu ende shtrëngojnë
t’njëqindtën e fundit t’nji inçi që s’e lëshon...
unë zgjatem kah një kapak që çelet n’nji qiell pa skaj blu.
me ra a me fluturu...

**Po kjo poezi, në origjinal:
MOTHER, ANY DISTANCE...**

*Mother, any distance greater than a single span
requires a second pair of hands.
You come to help me measure windows, pelmets, doors,
the acres of the walls, the prairies of the floors.*

*You at the zero-end, me with the spool of tape, recording
length, reporting metres, centimetres back to base, then leaving
up the stairs, the line still feeding out, unreeling
years between us. Anchor. Kite.*

*I space-walk through the empty bedrooms, climb
the ladder to the loft, to breaking point,
where something has to give;*

*two floors below your fingertips still pinch
the last one-hundredth of an inch...
I reach towards a hatch that opens on an endless sky
to fall or fly*



**Protect me from what I want
Syri dhe zemra**

Nga Edison Çeraj

*“Kur Zoti ia don t’mirën dikujt, e frymëzon me folë pak, me hanger pak e me fjetë pak.”
(Ali ibn Ebi Talib)*

“Less is more”, thoshte Mies van der Rohe, natyrisht në tjetër kontekst, por thelbi është li njajtë. Ndërsa Rumi na kujton se fyelli nuk nxjerr asnjë melodi nëse nuk është bosh.

Prirja për ma shumë, për sasinë, është në natyrën tonë, siç është po aq në natyrën tonë përpjekja me e vu nën kontroll këtë prirje, me u përmbajtë.

Duke perifrazu Heraklitin, mund të themi se ai që nuk i kontrollon dëshirat nuk mundet me qenë i lirë.

Kjo është beteja e betejave – me veten. Nëse ekziston një e ashtuquajtur luftë e shenjtë, është pikërisht kjo.

Në thelb, skllavëria e vërtetë nuk është diku jashtë nesh, por brenda qenies sonë.

Herakliti e sheh këtë si tension kozmik dhe psikologjik; Sokrati si problem njohjeje; kurse Epikteti si çështje disipline dhe praktike.

Prandaj, liria nuk është me ba çdo gja që dëshiron, por mos me qenë i detyruar nga ajo që do.Nuk bahemi të lirë duke i kënaqë dëshirat, por duke i vendosë ato në vendin e tyre.

“Protect me from what I want” (Holzer) është një prej veprave-tekst ma të randësishme të artit bashkëkohor, që autorja zgjedh jo rastësisht me e projektju në formë elektronike në Times Square, në atë Niagarë dëshirash e shpërqendrimi.

Anatomia e brendshme e njeriut, sipas Gazalit, është një fushë beteje midis disa forcave: nefsit (egoja, plot dëshira e impulse), aklit (arsyes), kalbit (zembrës, si qendra shpirtërore) dhe ndikimeve ma të larta (hyjnore).

Ai përdor një metaforë për këtë, duke na kujtu se njeriu është si një mbretëri, ku zemra është mbreti, arsyeja këshilltari, ndërsa nefsi është forca që duhet disiplinuar.

Duhet shtu këtu se, sipas Ibn Arabiut, çdo dëshirë ka një burim ma të thellë dhe, në thelb, ajo është kërkim i së Vërtetës, por një kërkim i deformuar, ose një kopje e kërkimit autentik.

Realiteti ka kufijtë e vet, kurse dëshirat tona janë të pakufishme. Mbase për këtë arsye kemi kriju edhe botën virtuale, për me e zgjeru ma shumë territorin e realitetit. Në fakt, kemi zgjeru vetëm hartën, se territori na është tkurrë.

E fërkojmë (pa farkëtim) ekranin e celularit si një llambë Aladini dhe me një klik “bahet” e jona çdo gja që dëshirojmë. Sa ma shumë që e fërkojmë këtë mrokull (mrekulli?) që na ban me harru se jemi vdekatarë, aq ma shumë dëshirojmë. E kështu, sa ma shumë dëshirojmë, aq ma shumë dëshirojmë... Spirallja nuk është ngjitëse, por vicioze.

Kënaqet syri, dehet mendja, zbrazet zemra.

Ky fenomen është etiketu edhe si “qytetërimi i ndrydhjes”, sepse nga ekrani që na është shtuar si gjymtyrë e shqisë njohëresh mundesh me pa çdo gja që të shkon ndërmend, por nuk mundesh me e shiju. Nji lloj striptizi 24/7. Nji model jetese i llojit “shih me sy e plas me zemër”.

Bota virtuale është një treg i pafund që vjen duke e sofistiku joshjen, deri në slogane ku përzihet horrori dhe komedia: “Ti nuk je i shëmtuar, por i varfër.” Tashmë është ngulitur ideja se mjafton të kesh para dhe mund të arrish çdo gja: se çdo gja mund të blihet, edhe “e shenjtja”.

Në fakt, nuk është edhe aq çudi, sepse në Mesjetë blihej me para edhe falja e mëkateve (indulgjencat).

Por, ndryshe nga Mesjeta, ku ekzistonte ideja dhe përjetimi i një transcendence reale, sot kemi një transcendencë të rreme, e prodhuar nga algoritmet dhe reklamat, që premton gjithçka dhe nuk jep asgja, përveç shumëfishimit të dëshirës.

Na duhet një klithmë (pa za) drejtuar vetes, jo të tjerëve, jo botës, e formuluar prej Ali Sheriatit si “klithma e njeriut të robëruar, që ka zbuluar papritur zinxhirët e tij dhe po zgjat dorën drejt dinjitetit të vet”.

Veçse duhet me u ndërgjegjësuar se zinxhirët nuk janë argëtim.

FIG

Qiriri im digjet në të dyja anët e tij
Dhe kjo s'mund të zgjasë në këtë natë blu
Armiqve të mi dhe miqve të mi, sigurisht
U dhuron dritën më të bukur!

MË KUJTOHET

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
Ai ishte i zbrazët dhe plot dritë, por mbante erë stallë
Pamë një zjarr diku, u mbështetëm në një tryezë
U shtrimë në majë të një kodre nën dritën e hënës
Dhe bilbilat këndonin dhe agsholi erdhi shpejt

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
Dhe ti hëngre një mollë dhe unë hëngra një dardhë
Nga një dyzinë që kishim blerë të dy
Dhe qielli u zbeh dhe era u bë e ftohtë
Dhe dielli u ngrit duke derdhur një kovë flori

Ishim shumë të lodhur, ishim shumë të gëzuar
Kishim lundruar gjithë natën me traget
I thamë: "Mirëmëngjes, nënë!" një koke të mbuluar me shall të zi
Dhe i bleva gazetën e mëngjesit, po nuk e lexuam as unë, as ti
Dhe ajo qau: "Zoti ju bekoftë!" për dardhat dhe mollët
Dhe për gjithë paratë që i dhamë, madje dhe qindarkat e fundit
Që i ruanim për biletat e metrosë

KOHJA NUK TË SHËRON

Koha nuk të shëron; ju të gjithë keni gënjer
Kush tha se koha do të më lehtësonte dhembjen?
Dhe shiu di të qajë kur ti më mungon;
Dhe më shumë të dua në kohën e zbatitës;
Kur dëborë e vjetër shkrin maleve,
Dhe gjethet e vitit që shkoi nxjerrin tym në çdo rrugicë ku
ndizen zjarre;
Dhe dashuria e trishtë ka mbetur
E strukur në zemrën time dhe mendimet s'më ndahen.
Ka njëqind vende ku kam frikë të shkoj
Sepse ato mbushen me kujtimin tënd tronditës
Dhe duke hyrë e lehtësuar në një vend të qetë diku
Ku s'ke qenë kurrë dhe fytyra nuk të buzëqesh
Unë them: "Më në fund kujtimi i tij nuk është këtu!"
Po prap dridhem, duke të kujtuar."

DHE LEXOJ NË MËNYRË KREJT TË RASTËSISHME

Dhe lexoj në mënyrë krejt të rastësishme
Se ti ke ikur për të mos u kthyer kurrë
Në trenin e metrosë në faqen e pasme të një gazete
Që fqinji im mban në duar
Në një cep të rrugës, kështu shkruhet
(Me të tilla rrugë janë mbushur gazetat)
Një burrë që nxitonte-dhe ai ishte ti
Sot në mesditë u vra.
Unë duhet të qaj ose të ulërij, por s'mund
Dhe të bëj diçka tjetër, s'mund,
Në një vend të tillë vetëm duhet të shtrëngoj duart
Dhe të shikoj pa vëmendje dritat e stacionit që kalojnë me
shpejtësi
Me një interes të kontrolluar në fytyrë
Ose të ngrej sytë dhe me kujdesin më të madh të lexoj
Vendet ku ruhen peliçet dhe si trajtohen flokët.

ÇFARË BUZËSH BUZËT E MIA KANË PUTHUR

Çfarë buzësh buzët e mia kanë puthur dhe ku dhe pse
E kam harruar, dhe çfarë krahësh kanë qëndruar
Nën kokën time deri në mëngjes; ndërkaq shiu
Është mbushur me fantazma këtë natë
Fërmon si psherëtimë në qelqe dhe dëgjoj si përsëritet
Dhe në zemër kam një dhimbje të qetë
Për t'i harruar të gjithë dashnorët dhe për të mos i kthyer
Këtë mesnatë që të më bëjnë të qaj.
Në mes të dimrit luhatet fillikate një pemë
Nuk di ç'zog shtegtuat prej saj njëri pas tjetrit
Ende nuk di cilat degë kanë më shumë heshtje se më parë
Nuk di çfarë dashnorësh kanë ardhur dhe kanë ikur
E vetmja gjë që di është vera që këndon tek unë
Me pak zë, se nuk do të këndoj më kurrë.

HIRI I JETËS

Dashuria iku dhe më la dhe ditët janë te njëjta nga e hëna në të
dielë
Duhet të ha dhe të fle, - sikur ai dhe unë të ishin këtu përsëri!

Edna st. Vincent
Millay

Poezi | Përktheu: Roland Gjoza

Por ah! - unë rri zgjuar dhe dëgjoj orët e ngadalta që në abys bien!
Dhe vjen një ditë tjetër! - me muzgun afër, muzgun gri!

Dashuria iku dhe më la dhe unë nuk di çfarë të bëj tjetër;
Kjo, ose ajo, ose kjo që dëshiroj janë të gjitha pa kuptim;
Sa filloj një gjë e lë, nis një tjetër dhe atë e lë të pambaruar,
Në asgjë askush s'ka gjetur qetësi, po kjo që shkruar për mua.

Dashuria ka ikur dhe më ka lënë, - dhe fqinjët trokasin dhe marrin
hua,
Dhe jeta vazhdon përgjithmonë si përtpypja e një miu të murrmë,
Dhe nesër dhe nesër dhe nesër, po deri kur?
Ja kjo rrugë e vogël dhe kjo shtëpi e vogël dhe unë.

DASHURIA NUK ËSHTË GJITHÇKA

Dashuria nuk është gjithçka; nuk është ushqim, as pije
As gjumë i ëmbël, as çati që të mbron nga shiu
As gomë shpëtimi për një njeri që mbytet
Fundoset dhe del, fundoset dhe del përsëri
Dashuria nuk t'i mbush dot mushkëritë me frymë
As gjakun s'ta pastron, as kockat e thyera s't'i ngjit
Shumë njerëz s't'i bënë dot miq deri në vdekje
As unë s'kam ç'të them për gëzimin që sjell dashuria
Për mrekullinë që mund të ndodh në orët më të këqija
Kur dhimbja të vë poshtë dhe të del një oh, rënkimi
Nder mend më vjen një forcë që më ka mbajtur dikur
Sikur ende jap dashuri për paqe dhe lumturi
Sikur lë dashurinë për t'i kërkuar kësaj nate ushqim
Kjo është më e mira. Por unë kurrsesi s'mund.

LARGIMI

Nuk dua t'ia di se çfarë rruge marr,
Dhe ku më çon, nuk dua t'ia di,
Por nga kjo shtëpi, që të mos zhgënjehem e të vuaj
Duhet të iki, të zhdokem diku!
S'dua t'ia di se çfarë kam në zemër,
Çfarë kam në mendje, s'dua t'ia di,
Por ka diçka brenda meje që më shtyn të ngrihem dhe të nisem,
Dhe s'me intereson se ku do të më çojnë këmbët e mia!
Do të doja të ecja një ditë dhe një natë pa u ndalur,
Qe të më gjente agimi në një vend të shkretë,
Pa gjurmët e një rruge që në sy do t'më shuhen,
Pa çatinë e një shtëpie, pa sytë e një fytyrë.
Do të doja të ecja gjersa gjaku të më vërshonte nga trupi
Dhe të më braktiste, për të mos lëvizur më kurrë,
Në një breg të gjerë, kur sapo është larguar batica,
Dhe shkëmbinjtë me barëra të këqija zhvishen nga shiu.
Por, kudo që të shkoj, në det, apo në ndonjë skelë te vetmuar, udha
që marr
Më ngrihet në sy e më mbetet aty, po as për këtë s'dua t'ia di,
Dhe nuk do të më interesonte kurrfarë zhurme apo ulërima e një

sirene të largët

E strukur, e vdekur në një hendek diku.
"Ka diçka që nuk shkon, zemër," ishte zeri i saj,
"Që më je zhytur në punë dhe rri kaq e heshtur?"
"Jo, nënë, jo, është një fill i kapur keq
"Ku shkoi çajniku? Të bëj nëna një çaj..."

EDHE NJË HERË NË DITËT E MIA QË THAHEN SI VESA

Edhe një herë në ditët e mia që thahen si vesa,
Si era që fërmon nga një oaz, ose zhaurima e fortë
E ujit të ftohtë e të ëmbël që vërshon nën tokë,
Një lajmës i pabesë, mendimi për ty, o i harruar
Vjen për të më shkatërruar; edhe një herë ringjall
Besimin e fortë në imazhet e tua,
Që prej kohësh s'janë tjetër veçse një grumbull rëre
Mbi të cilin nuk u rrit kurrë asgjë e gjallë.
Edhe një herë, fare e pamend, në marrëzinë time
Ndjek fantazmën tënde perplot ngjyra në ajër,
Dhe qaj dhe mallkoj dhe bie dhe ngrihem përsëri
Dhe pengohem me keqardhje atje ku ti shfaqesh
I mjerë dhe i humbur, me sytë e skuqur plot lot.
Edhe një herë përpiqem, por
Asgjë nuk ka atje, ku unë shpresoj më kot.

PRANVERË DHE VJESHTË

Në pranverën e vitit, në pranverën e vitit,
Ecja ne rrugë pranë te dashurit tim.
Pemët ishin të zeza aty ku lëvorja ishte e lagur.
I shoh ende, në pranverën e vitit.
Ai më theu një degë pjeshke plot me lule të bardha
Ajo ishte lart dhe ai u përpoq për ta kapur.

Në vjeshtën e vitit, në vjeshtën e vitit,
Ecja në rrugë pranë të dashurit tim.
Korbat ngjiteshin përpjetë me krrokama të kobshme.
I dëgjoj ende, në vjeshtën e vitit.
Ai qeshte me gjithçka që unë e quaja të mirë
Dhe ma theu zemrën, për gjëra të vogla.

Qoftë viti pranverë, qoftë viti vjeshtë,
Lëvorja do të pikojë dhe zogjtë do të cicërojnë.
Ka shumë gjëra të bukura për t'u parë dhe dëgjuar
Në pranverën e vitit, në vjeshtën e vitit.
Nuk ishte dashuria, ajo që m'i prishi ditët.
Por që shkoi ashtu për gjëra të vogla.

VETËM EUKLIDI E KA PARË BUKURINË LAKURIQ

Le të heshtin të gjithë ata që flasin për bukurinë,
Le t'i shtrijnë përtokë dhe t'i ndalojnë me rreptesi
Le të rrinë dhe te meditojnë, ndërsa shikojnë
Asgjënë, të vizatuar në mënyrë të ndërlikuar ne zbrazeti
Ato forma të evolucionit që ndryshojnë; le të flasin patat
Të këlthasin dhe të leshojnë vigma eternale, por heronjtë
kërkojnë çlirim
Nga skllavëria e pluhurosor në ajrin e ndritshëm.
O orë verbuese, o ditë e shenjtë, e tmerrshme,
Kur shigjeta në shikimin e tij shkëlqeu për herë të parë
Me dritë të anatomizuar! Vetëm Euklidi
E ka parë bukurinë lakuriq. Me fat ata
Që, megjithëse vetëm një herë dhe nga larg,
I kanë dëgjuar sandalet e saj mitike të shkelin mbi gur.

PRANVERË

Prej cilit shkak prilli kthehet përsëri?
Bukuria nuk është e mjaftueshme.
Nuk mund të më qetësojë më me skuqjen e bumbeskave
Gjethëve të vogla ngjitëse që hapen si erashkë.
Unë di atë që di. Kaq.
Dielli është i nxehtë në qafën time ndërsa vështroj
Petalet e sapoçelura të irisit.
Aroma e tokës është e këndshme.
Është e qartë se nuk ka vdekje.
Por çfarë do të thotë kjo?
Jo vetëm truri i njerëzve është nën tokë
I ngrënë nga krimbat.
Jeta në vetvete
Nuk është asgjë.
Një filxhan i zbrazët, një palë shkallë të pa shtruara me
qilim.
Nuk mjafton që çdo vit, poshtë kësaj kodre,
Prilli
Vjen si një idiot, duke u zgërdhirë dhe duke shpërndarë
lule.

Në vitin 1994, Pjetër Arbnori i shkroi një letër njërit prej lordëve më të shquar të Britanisë së Madhe, **Nicholas Bethell**.

Duke marrë shkas nga kjo letër, Lordi Bethell më 6 shtator 1994 botoi një shkrim të gjatë në gazetën *Independent*, një nga gazetatat më prestigjioze të Mbretërisë së Bashkuar.

Pjetër Arbnori, në rolin e tij si Kryetar i Parlamentit të Shqipërisë, i kërkoi Lordit Bethell që të përdorte autoritetin e tij për të bindur drejtuesit e **Sotheby's** që përfitimet e disa shitjeve me ankand t'u jepeshin disa të persekutuarve politikë në Shqipëri.

Sotheby's është një nga korporatat më të mëdha në botë që shet me ankand sende dhe objekte me vlera historike.

Në korrik të vitit 1994, vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së spiunit të famshëm **Kim Philby**, korporata Sotheby's, pasi kishte blerë në Moskë apartamentin dhe të gjitha objektet e tij, vendosi t'i shesë ato me ankand dhe paratë e grumbulluara t'i japë për bamirësi.

Pjetër Arbnori, sapo e mësoi këtë lajm, vendosi menjëherë t'i shkruante një letër mikut të tij, Lordit Bethell. Përmes kësaj letrë, ai i kërkoi që të ndërhynte tek drejtuesit e Sotheby's, që paratë e grumbulluara nga këto shitje të mos u jepeshin shoqatave bamirëse në Londër, por viktimave ose familjarëve të viktimave shqiptare që u vranë apo u burgosën si pasojë e spiunimit për llogari të KGB-së dhe organeve të Sigurimit Shqiptar nga ky dyfishtë agjent.

Lordi Bethell, sapo e mori këtë letër, me përgjegjësinë e një politikani karriere dhe të një historiani dinjitoz, u ul dhe shkroi një artikull të gjatë rreth kësaj çështjeje. Artikulli i tij ishte i detajuar dhe me mjaft informacion të rëndësishëm rreth rolit të Philbyt dhe viktimave shqiptare që kishte shkaktuar veprimtaria e tij spiunuese për llogari të KGB-së dhe organeve të Sigurimit

Pjetër Arbnori, Lordi Bethell dhe spiuni Kim Philby

Nga Ndrek Gjini, Galway, Irlandë



Shqiptar.

Historia që i lidh këta tre persona me njëri-tjetrin

Para se të flasim për historinë që i lidh këta tre persona me njëri-tjetrin, e shoh me vend të shpjegoj shkurt se kush ishin ata:

Pjetër Arbnori (18 janar 1935 – 8 korrik 2006) ishte një shkrimtar dhe politikan shqiptar. Ai është quajtur "Mandela i Ballkanit" për shkak të kohës së gjatë, plot 28 vjet, që kaloi në burgjet e diktaturës komuniste. Ai ishte bashkëthemelues i degës së Partisë Demokratike në Shkodër. Prej vitit 1991 deri më 2001 ishte deputet në Parlamentin e Shqipërisë, ndërsa prej vitit 1992 deri më 1997 ishte Kryetar i

Parlamentit Shqiptar.

Lord Nicholas William Bethell (19 korrik 1938 – 8 shtator 2007) ka qenë politikan britanik dhe historian për Europën Qendrore dhe Lindore. Bethell ka qenë anëtar i Dhomës së Lordëve si konservator nga viti 1967 deri më 1999. Ai ka qenë gjithashtu anëtar i Parlamentit European nga viti 1979 deri më 1994, dhe përsëri nga viti 1999 deri më 2003. Ndër librat që botoi ishte edhe *The Great Betrayal*, ku flet për rolin e agjentit Kim Philby.

Kim Philby (1912–1988) ishte një spiun sovjetik. Në vitin 1963, qeveria britanike pranoi se ish-diplomati i saj, Harold Adrian Russell Kim Philby, kishte vepruar si agjent sovjetik.

Dezertimi i tij në Bashkimin Sovjetik në janar 1963 ishte një prej momenteve më dramatike të Luftës së Ftohtë. Në kohën kur ishte me detyrë në Washington, në fillim të viteve 1950, si ndërmjetës mes shërbimeve sekrete britanike dhe atyre amerikane, Philby tradhtoi operacionin sekret të dërgimit të mijëra shqiptarëve të arratisur në vendin e tyre për të përmbysur regjimin komunist të Enver Hoxhës. Pas përjashtimit nga shërbimi i zbulimit britanik MI6, ai u arratis në Moskë dhe vdiq në vitin 1988, në moshën 76-vjeçare.

Rrethanat e letrës

Në korrik të vitit 1994, vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së Kim Philbyt, Sotheby's vendosi t'i shesë me ankand sendet dhe objektet e tij të sjella nga Moska dhe t'i përdorë të ardhurat për bamirësi.

Pjetër Arbnori, sapo e mësoi këtë lajm, i shkroi menjëherë Lordit Bethell. Ai i kërkoi që të ndërhynte pranë drejtuesve të Sotheby's, në mënyrë që paratë e grumbulluara të mos shkonin për shoqata bamirëse në Londër, por për viktimat shqiptare që kishin vuajtur pasojat e veprimtarisë së këtij agjenti.

Lordi Bethell e trajtoi këtë çështje me seriozitetin e një politikani karriere dhe të një historiani të formuar. Ai e botoi artikullin në *Independent* dhe, në hyrje, iu referua drejtpërdrejt letrës që kishte marrë nga kryetari i Parlamentit Shqiptar, si edhe propozimit të tij për destinacionin e parave të mbledhura nga ankandi.

Në përmbyllje të artikullit, Bethell shkruan se shpërblimet e fituara nga Kim Philby ishin të pamerituara, sepse veprimtaria e tij anti-ligjore shkaktoi qindra viktimat dhe shkatërroi mijëra jetë shqiptarësh. Ai thekson se paratë e fituara nga objektet e shitura janë fitime që burojnë nga akte tradhtie dhe se nuk duhet të përfitojnë as familja Philby, as Sotheby's.



KREU I

Ose dashuria brof nga pasioni, ose s'vjen kurrë.

Është e vërtetë që nuk është e lehtë ta çmagjepsësh atë moment të ngurosur. Secili duhet të kapërcejë pragun e çuditshëm, në të cilin gjithçka që është zbuluar në thellësi të shpirtit, nuk do të zbulohet më.

Dashurojmë vetëm njëherë. Dhe të vetmen herë që dashurojmë nuk e dimë meqë e zbulojmë.

Të zbulosh e të rinjohësh nuk përcaktojnë sisteme të ngjashme. Është njëllësi si të zbulosh e të rinjohësh ashtu si edhe të vish në jetë e të plakësh.

Të rinjohësh është aq tronditëse por edhe mrekulluese.

Të kalosh nga dëshira e zjarrtë në dashuri është një ordali¹.

Ky rrugëtim është me rrezik, ngaqë zgjedhja të cilës i parashtrohet, është e prerë: ose fatsjellëse ose vdekëtare.

Dashuri vjen nga një fjalë e vjetër që lidhet me sisën.

Kjo fjalë e Romës së lashtë, e cila për habi tregon veçorinë që karakterizon klasën e sisorëve viviparë², që janë shfaqur gjatë erës së tretë, atëherë kur u krijuan kushtet më të përshtatshme për fatin tonë. *Amor* është fjalë që rrjedh nga *amma*, *mamma*, *mamilla*. *Mamaire* (amësi, gji) dhe *mamam* (mami), janë forma thaujse të padallueshme. Dashuri (*Amour*) është një fjalë e afërt me një gojë që flet më pak duke thithur gjirin në mënyrë ende të vetvetishme që zgjat buzët për të shuar urinë.

Ata që dashurohen kuptohen nga vështrimi.

KREU II

Emri i Nemi Satlerit është i rremë. Kështu do ta quaj unë një grua që ka ekzistuar, që s'është më e qe e kam dashuruar. Është e vështirë të përmbledhësh një mendim për të, kur ky mendim është vetë jeta e saj. Ajo që vjen nga e shkuara, drejt së cilës ne zgjatim dëshpërimisht dorën, jo vetëm që ndryshon në kohët e reja, por është e pushtuar nga emocionet që krijohen prej saj. Megjithatë ajo që na shkund dhe që vjen nga ajo çka na ka mallëngjyer, ende prehet te vetë e shkuara. Ajo grua që kam dashur, vite më parë, madje ka dhjetëra vjet, nuk jeton më në këtë botë - as edhe në ndonjë botë tjetër - por diçka që është trupi i saj, qarkullon ende brenda trupit tim. Më tepër se shpirti që shkëputet prej tij, ndoshta si jehonë, çdo trup i dashuruar që në çastin e parë kur e ndjen peshën autoritare, gjen vendin e vet në trupin që e përgjonte. Ajo që kërkoj të them nuk ndryshon në asgjë nga ajo që kam përjetuar e veçanërisht nga ajo që jetoj e që dua të vazhdoj të jetoj. Ata që quheshin dikur filozofë, ndienin kënaqësi kur meditimin në publik në sy të të gjithëve. Ata e pranin se veta e parë njëjës i trondiste. Duke pasur para syve të mirat e qytetit, trupi i tyre nuk ishte i çliruar, mendjempërtësia e tyre nuk mund t'i nënshtrohej anketës popullore, ata nuk mund të dyshoheshin si kureshtarë, as të ishin të zotë për anekdotat. Asgjë nga jeta e tyre vetjake nuk prekej, sepse ata sodisnin sa më larg të qe e mundur. Largimi ishte teknika e tyre, ligjërimi ishte napa e tyre e kuqe. Ata thoshin atë çka donte të dëgjonte bashkësia njerëzore. Pak a shumë si priftërinjtë që kishin qenë para tyre. Pak a shumë si televizori i ditëve tona. Bashkësia njerëzore është më e interesuar për të ardhmen, se trupi i çdo njeri që përsiat.

Që nga çasti kur një individ e gjen gëzimin duke u ndarë nga shoqëria që e ka parë të vijë në jetë dhe i kundërvihet ngrohtësisë dhe ndjenjave të saj, menjëherë përsiatja bëhet e ndërlikuar, vetjake, dyshuese, origjinale, mundimtare, e vështirë, hutuese dhe pa më të voglën dobi kolektive. Nuk është fare e saktë nga ana ime të mëtoj për të ripërshkruar atë që ndiej në kohën e tashme sikur të ishte fjala për një mësim të hollësishëm dhe plot pasoja

1 Ordalie (fr.) - Gjykimi i Zotit.

2 Vivipare (fr.) - Kafshë që e zhvillojnë vezën në mënyrë të atillë që i sapolinduri mund të çojë një jetë të pavarur.

Fragment nga libri *Jetë sekrete* që është në proces shqyrtimi te botimet Aleph

PASCAL QUIGNARD

Dashuria

Përktheu: Feride Papeleka

Pascal Quignard-i ka lindur më 1948 në Verneuil-sur-Avre (Francë). Jeton në Paris. Është autor i shumë romaneve (*Salloni i Wurtembergut*, *Gjithë mëngjeset e botës*, *Tarracë në Romë*, *Vila Amalia*, *Lotët*, *Dashuria det*, *Thesar i fshehtë*) dhe i shumë eseve ku fikcioni përzihet me përsiatjen (*Trajtesa të vogla*, *Mbretëria e fundme*). Ai ka fituar çmimin Goncourt 2002 me *Hijet që enden*, i cili është përkthyer në shqip.

që i detyrohesha një gruaje - edhe pse dua që të rrëfej gjithçka për atë që kam vendosur ta quaj Nemi Satler - sepse nuk kam provuar asnjë çast si ky atëherë kur e jetoja. Ai kujtim e ka zaptuar mendjen time si rrufeja që ka harxhuar qindra e mijëra ditë për të gjetur tamam lirin që do të përflakë. Shpesh ne japim përshtypjen se jemi pasojat që presin shkakun. Toukaram-i në Déhu më 1640, shkruan: "Kam ardhur që larg. Kam vuajtur nga dhimbje të tmerrshme dhe nuk e di se çfarë më ruan ende e kaluara ime!" Ka tridhjetë vjet që ka ndodhur kjo dhe unë mendoja se Nemi më mësonte diçka, diçka që lidhej me muzikën. Tashmë dyshoj se ajo më mësonte ndoshta fare thjesht, atë që kërkoj me këmbëngulje për ta gjetur.

Dashnorët janë të shkëputur nga bota dhe duhet të rrojnë si ajo pjesë e popullsisë që vetë koha i ka shpërndarë në vise të humbura.

Më tepër se në hapësirë, ata duhet të jenë të hutuar në kohë nga dashuria që kanë. Po ashtu si ndodhte në parahistori, në kohën e kulluar, ose së paku në çastin që i nënshtrohej ende kohës, kur njerëzit e parë e ndien përkatësinë e tyre gjinisore vetëm duke e jetuar.

A mendonte ajo se shkëlja e kurorës ishte një lidhje nga më të fuqishmet? Se mungesa e robërisë ishte e çara e mundshme në ligjëratën njerëzore, me pranëvënien urdhëruese, tërësisht robëruese të marrëdhënieve dhe shkëmbimeve të përditshme për fjalën e dhënë? Një e çarë në atë muranë, në atë mal

që është në të vërtetë krejt koha, me bukën e përditshme, netët, punët, sëmundjet, ditët?

Përse drithërohet shpirti kur bërryli cek padashur krahu e një gruaje që është ende krejt e panjohur?

Dashuria i kundërvihet njëherësh seksualitetit dhe martesës. Dashuria nuk vjen si rrjedhim i shkëmbimit social. Dashuria qëndron në atë guxim të pashmangshëm. Tërë dashuria ngrihet mbi sekretin e të paemërtueshmes.

Herën e parë që Nemi Satler më dëgjoi kur luaja në violinë më tha:

- Mos luani si me dorë të vdekur!

Ajo shtoi se ka shumë duar të vdekura në muzikë.

Dhe heshti.

Nuk e mora vesh mirë se çfarë donte që të kuptoja.

Një dorë e butë dhe ngurruese më ngjall frikë.

Në gjuhën ruse thonë se kur një grua ju zgjat një dorë të flashkët, ajo ju dhuron një fëmijë të vdekur.

Nemi nuk thoshte vetëm: "Mos luani si me dorë të vdekur", ajo thoshte edhe: "Mos bëj me muzikën si të haje me kurrizin e një luge të vogël."

Këto shprehje të njohura franceze që nuk i përdorja atëherë më pëlqenin si të ishin çelës që hapnin botën.

Më dukeshin shumë të çuditshme dhe me vlerë.

Të çmuara ashtu si ndodh kur zbulon për herë të parë kuptimin e saktë të një fjale të rëndë apo të vjetruar.

Gjithçka në univers zgjerohet, shumëfishohet. Gjithçka në qiell ose në botë çelet. Ai shpërthim i heshtjes në vendin që zë rrënjë, ai shpërthim i sekretit mbi trupin që fshihet, ai shpërthim dhe ajo mbyllje, ai oqean që shtrihet dhe ai ishullëzim që përqendrohet në brendësinë e skajshme, gërmonin një thellësi që ne e përjetonim sa më shumë të dy e nuk e ndanim me të tjerë.

Nemi ishte e heshtur, e rreptë. Më tepër e guximshme, se sa e ndjeshme. Bënte një jetë të qetë, që i jepte forcë gjestit. Dashuria hapte papritur të pakomunikueshmen si me çelës. Po ashtu librat kur janë të bukur bëjnë të rrëzohen jo vetëm fortësat shpirtërore, por edhe fortifikimet e mendimit që e sheh veten të mposhtur papritur. Fatkeqësia qëndron në faktin se unë me ta zbuluar kërkvoja të zbërtheja mënyrën se si ishte ndërtuar imazhi i saj vetëm e vetëm që të merrja vesh kuptimin. Çfarë kuptimi kishin kurrizi i lugës së vogël dhe ajo dorë e vdekur për të thënë të njëjtën gjë: bjeri mirë notës në piano, bëje të tingëllojë me energji që shpërthen?

Me të mbaruar së luajturi pjesën, unë i mbaja sytë ulur.

Kur pushon, muziktar i vërtetë kridhet në një heshtje aq të madhe e të thellë, që është në fund të fundit dëshirë për të qarë.

Unë mendoj se është një heshtje që e dërrmon interpretuesin, tamam si uji që peshon mbi zhytësin në oqean.

Mes kësaj heshtjeje ndodhi që unë i hodha një vështrim.

Sytë e Nemit ishin krejt të bardhë. Ata nuk silhnin më. Unë murmurita:

- Ju jeni një pianiste e mahnitshme.

Ajo nuk u përgjigj.

Në të vërtetë ajo ma mësoi muzikën.

Zëri i saj ishte i pabesë dhe i ulët. Përherë i ëmbël, i vendosur, i qetë, aspak joshës, tepër i nyjtuar, pa ndryshim të madh toni. Gjithnjë e përcaktuar, gjithnjë e arsyeshme, shpjeguese, ajo hapte thjesht shpirtin, argumentonte ose më mirë sillte te unë arsyet e veta, jepte udhëzimet e saj, depërtonte te unë me një qartësi të atillë, sa isha i paafët ta kundërshtoja. Atij zëri unë i bindesha. Gjithsesi unë iu binda sapo e dëgjova.

Ka mundësi që lindja e dashurisë të jetë bindje ndaj një zëri. Ndaj intonacionit të një zëri.


Zëri i Nemit të bënte për vete pa u përpjekur të ndryshonte duke flakur tej çdo retorikë. Ajo komandonte duke mos lënë asnjë zgjedhje, duke u kthyer pa pushim në të njëjtat pika, në të njëjtat dobësi, ose më saktë në të njëjtat harresa, dhe, duke treguar se priste përherë, nxiste kujtesën që dyshohe se ajo do të përsëriste, duke paraprirë me shpirt, ngadalë, qetësisht, e çinteresuar, absolute. Unë prisja kthimin e atij zëri, ngrija harkun e violinës, ose e lija të varej te krahu im, prisja çfarë do të urdhëronte ajo e që e ndriçonte muzikën pa mëtuar asnjëherë t'i jepte një domethënie.

Tashmë unë e kisha kuptuar se çfarë donte të më thoshte.

Megjithatë prisja me shqetësim se cilët do të ishin epitetet e pamëshirshme që do të përdorte ajo. Më së fundi ata vinin tek unë, gjithmonë atje ku i kisha prituar, dhe ku gjenin vendin e tyre të rëndë, të dhimbshëm; ata lëshoheshin secili si pika acidi. Duke më folur, ajo i drejtohej tërë trupit të madh që formonin dy instrumentet dhe dy trupat tanë, vëllimit të dhomës së ljer me ngjyrë hiri, statujave, madje edhe ajrit që kalonte drejtpërdrejt përmes nesh në çastet kur luanim.

Serioziteti, neveria, bukuria e perceptuar si neveri ndaj përpjekjes për t'u dukur, si mosjoshje, vrull i pashpjegueshëm, vegullia përherë memece, uniteti i frymëzimit ose i fuqisë, origjinaliteti i përpiktë, dyshimtaria që shkon gjer në krenari se nuk pëlqehesh, ushtrimi i pamëshirshëm i vetëdijes, gjithashtu edhe katolicizmi, të tilla ishin vlerat që ajo ngrinte më lart se vetvetja jonë.

Mësimi i muzikës me Nemin e shtynte



përqendrimin gjer në torturë. Ai që nuk i përshtatej plotësisht, sidomos në lidhje me ato që duhej t'i kishte në kujtesë e që nënkuptonte mësimdhënia e saj, largohej menjëherë me mirësjellje, vendosmërisht.

Të dije një pjesë përmendësh ishte për të më e vogla e gjërave.

Muzika nuk kishte të bënte me analiza, me të mësuarit, me teknikën. Mësimdhënia e saj ishte si njëloj vetëhipnoze e pjesës që luhej, që duhej ta mbaje në trup e ta gdhendje brenda trupit. Ishte një udhëtim pa kthim. Më kujtohet se shprehja - e cila ndonjëherë mund të merrej si lëndatë - që "të biesh brenda me këmbët e tua", ishte në gojën e saj fyerja më e rëndë që mund të gjendet për të kritikuar lojën tënde. Flegrat e hundës së saj fërgëllonin. Vrimëzat e hundës, të brishta, pak të shtypura, të kthyer, hapeshin përgjysmë atëherë kur ajo thoshte me të keq: "Ajo që luajtët nuk ishte në asnjë mënyrë këngë. Ju nuk kërkonit asgjë. Nuk jeni i shpenguar. Ju... *bini përherë brenda me këmbët tuaja!*"

Atë çka i jepte tërë fuqinë mësimi rraskapitës të Nemi Satlerit, unë do ta zbuloja më vonë, të fshehur në një mirëbesim që Mozart-i i ka bërë Röchlitz-it: " Gjithçka vjen në bllok, menjëherë, e pashpalosur, thujse panoramike, mbi të gjitha me një ritëm". Kjo e lodh pa masë trurin ashtu si edhe trupin e kompozitorit, që duhet të ketë guximin atëherë të shkruajë.

Fjalët aq të thjeshta që Mozart-i i ka thënë Röchlitz-it, janë shumë më të sakta sesa duken: është fjala të japësh njëherësh kuptimin e së tërës. Të kompozosh panoramiken. Dhet ta mbërthesh gjithçka, të tërën me një frymë.

Të hedhësh në nota "të gjithën bashkë", njëherësh.

Ta mbërthesh në shpejtësi.

Ç'është dashuria? Para se ta njihja, në mendjen time nuk kishte një "botë të dashurisë", të krahasueshme me një përvojë themelore si muzika (ose të krahasueshme me joshjen nga librat) e që fillimi të kishte qenë përqafimi i lakuriqësisë njerëzore. Ajo më bëri të depërtoj në këtë botë, në të njëjtën mënyrë që një zot shtëpie e bën një mik të vizitjës e të zbulojë vendin e tij dhe me atë rast e zbulon edhe vetë. Si një njeri që udhëton në det dhe mëson një tjetër mënyrë për të matur kohën, sesa ajo që provojmë duke qenë në tokë, më e qëndrueshme se toka dhe drurët apo malet që e rrethojnë fshatin e tij, ndërsa udhëtimi zgjat disa muaj (dashuria jonë zgjati tre muaj e gjashtë ditë. Dashuria jonë zgjati saktësisht nëntëdhjetë e gjashtë ditë.)

Të mësosh është një kënaqësi e madhe. Të mësosh është njëloj si të shohësh dritën e jetës. Çfarëdo moshe që të kesh, trupi njeh atëherë njëloj dëshire për t'u shprehur lirisht.

Ai që nuk provon gëzim kur nxë, nuk duhet mësuar.

Të rrëmbehesh për atë që është tjetër, të duash, të mësosh, është e njëjta gjë.

Veçantia e Nemit u binte në sy të gjithëve. Vëmendja e saj e heshtur dhe shumë e përqendruar, çonte në bukuri. Sytë e saj të vegjël në një të zezë të rreptë, butësia e zërit të saj dhe mënyra e të folurit të avashëm, lypnin heshtje.

Ajo kohë ishte tjetër botë. Unë kam jetuar në tjetër botë. Por bota e vërtetë s'e ka ditur kurrë njëkohësinë. Më kujtohet se një ditë i sollën blloqe akulli. Bënte nxehtë. Isha atje për mësimin dhe nuk e di përse Nemi ishte vetëm atë ditë në shtëpi. Transportuesi i la copat e akullit në legenin e madh që ishte mbi pllakat e kuqe të dyshemesë së kuzhinës. Nemi kërkoi ta ndihmoja t'i rendiste duke i prerë pak për t'i mbështjellë me peceta të pastra para se t'i vendoste në të ndarat e bufesë që shërbente për akull. Të ndarat ishin të veshura me zink bojë hiri dhe kishin një aromë druri të mykur, sidomos sipër sirtarit nga ku niste rrjedhja. Unë i kisha duart të mpira nga akulli. E mbaj mend ende këtë vështirësi që pata për t'u vënë pasaj të luaja.

Më duket se qe e njëjta ditë.

Për këtë jam i sigurt, sepse i rishoh krahët e zhveshur e të bardhë që dilnin nga mëngët

e gjata të fustanit të saj që i kishte përveshur kur rregullonte akullin.

Qe nxehtë. Ajo ishte pa çorape.

Kishte veshur ca sandale me rripa.

Unë i kisha gishtat me djersë dhe i fshija te pantallonat prej fanellate ngjyrë hiri, për aq kohë sa më premtonte partitura. Kur e prekja violinën ishte rrëshqitëse.

Ishte mbarimi i kursit dhe ne ishim në këmbë.

Nemi ishte duke më zgjatur një listë librash që i kishte shënuar për mua, me qëllim që t'i gjeja.

Nuk e mora listën e shkruar.

Qe dora e saj që mbërtheva.

Përpiqesha ta tërhiqja trupin e saj drejt meje. E shtrëngoja fort pas vetes. Papritmas ndjeva gjinjtë e saj që i kishte të mëdhenj e të bukur e që mbështeteshin te unë. Gjinjtë e Nemit më ceknin, hynë në hasje me trupin tim dhe më kujtohet që kjo ndjesi m'u duk plotësisht e pabesueshme. Por trupi im i besonte kësaj ndjesie. Unë vetë dyshoja në atë që kisha dëshiruar.

Ndjeva aromën e saj, aromë që vinte nga bluza e që është nga parfumet më të ëmbla që kam ndier ndonjëherë. Atë çast ajo më thoshte se nuk duhet të vija më te ajo, se nuk duhej të shkonim më te bujtina për të ngrënë drekë, se mosha e saj, jeta që bënte...

Por unë nuk dëgjoja nga ai vesh. Ndjeva ngrohtësinë dhe peshën e gjinjeve të saj në kraharor, ndieja parfumin e papërfytyrueshëm që vinte prej saj. Dikur mbështeta buzët në fillim në një cep të gjoksit të saj. Ajo heshti. Ia hapa bluzën dhe afrova buzët. Por në atë çast ajo më shtrëngoi më fort pranë vetes e duke më shtrënguar s'më linte të bëja gjë tjetër. Unë ngrita kokën.

Vura buzët e mia mbi buzët e saj gjysmë të hapura. Fryma e saj e ngrohtë kalonte tek unë. Ajo e ktheu fytyrën menjëherë në anën tjetër. Ndenjëm kështu, njeri pranë tjetrit, Nemi duke ruajtur fytyrën e kthyer në anën tjetër. Dëgjonim zemrat tona që rrihnin fort. Dëgjonim vetëm ato të rrahura të mëdha e hutuese që dukej sikur nuk vinin nga ne, aq në mospërputhje ishin me ëmbëlsinë që provonim. Ato rrahje nuk kishin kurrfarë harmonie. Ishte një kaos gjaku që na bashkonte. Ishin ritme zemre shumë të rrëmbyera, të forta me ndalime të pabesueshme. Papritur ajo u largua nga unë e m'u lut të ikja. Kishte vështrim të trishtuar, prekës. Unë ika. Nuk më kujtohet fare mënyra se si dola e as se çfarë bëra ditën që pasoi atë përqafim të papritur, pas asaj përmbysjeje të kohës dhe as mënyra e jetesës që solli ai përqafim.

Kur u pamë sërish, fjalët e para që më drejtoi kishin të bënin me shpjegimin përse nuk do të shiheshin më. Ishte në fillim të muajit mars. Është muaji kur Zoti vdiq. Është muaji i luleve të para. Pranvera ishte në prag. Ishte kohë e bukur.

Dashuria i kundërvihet njëherësh seksualitetit dhe martesës. Dashuria nuk vjen si rrjedhim i shkëmbimit social.

Dashuria - komunikim i mahnitshëm nga i cili preken dy ndjeshmëri - mbijeton pas ndarjeve dhe madje pas zisë. Nuk është dashuria që arratiset. Është njëri nga trupat e saj që shkulet në një shkëmbim që është në lidhje të drejtpërdrejtë me vdekjen, meqenëse ajo është e pandarë me riprodhimin - me riprodhimin që është ajo pavdekësi monumentale, ngjasuese, e tmerrshme, e gjallë që kalon nga vdekja e atyre, tiparet e të cilëve rikopjohen gjatë skenës që vetë protagonistit s'mund ta shohë kurrë.

Dashuria është anakronike dhe ngadalësia - më anakronikja e *tempi*, domethënë më pak grabitqarja e hoveve - i shkon si një joligjërë. Jean Racine-i thoshte se në shfaqjet për dashurinë ishte e domosdoshme të futej një lloj largësimi, një lloj pabesueshmërie dhe një lloj trishtimi madhështor. Habia i shkon dëshirës. Dëshira mund të lindë duke u çliruar pak nga pak dhe jo duke qenë krejt e lirë.

Dashuria e vërtetë është marrëdhënia e papërgatitur, që i përjashton bisedimet. Ajo është një komunikim i papërmbajtur midis dy individëve, që i kapërcen të gjitha opinionet familjare dhe të gjitha meditimet sociale.

Botim i ri nga Ombra GVG

“Drita e muzgut”

nga Jaap Robben

Përktheu Viola Trifoni

Historia e romanit *Drita e muzgut*, zë fill në vitet '60 dhe lidhet me qytetin e Nijmegenit, një qytet me bindje të rrepta fetare.

Mbi akullin e ngrirë të lumit Waal, ndodh një takim i rastësishëm midis Fridës, një shitëse e re lulesh dhe një burri të martuar të quajtur Otto, profesor në universitetin e qytetit.

Shumë shpejt mes tyre ndizen shkëndijat e dashurisë. Edhe pse e paligjshme, kjo histori dashurie që i ndryshoi jetën Fridës, kthehet në një dramë egzistenciale.

Ngjarjet dhe historitë shpirtërore të asaj qyteze dominoheshin dhe kontrolloheshin tërësisht nga Kisha Katolike. Edhe vendimet e marra prej saj, ndaj atyre që dilnin jashtë këtij kontrolli, ishin viktimizuese.

Ky roman ngre probleme të mëdha mbi psikologjinë e një shoqërie e cila është e detyruar që të gjitha historitë personale, ti mbajë të mbyllyra brenda vetes deri në fund të jetës.

Dita e muzgut e ndërtuar mbi një strukturë retrospektive, rrëfëhet me sytë e Fridës, sot një grua tetëdhjetë vjeçare, e cila i shtyn ditët e fundit të jetës e vetmuar në një azil, sepse bashkëshorti nuk jeton më...


Tani që ajo është në prag të largimit nga jeta, nuk dëshiron të ikë e pikëlluar, prandaj guxon të kërkojë atë që ka humbur në kohën e vajzërisë...

Por... cili është pengu i saj?

Jaap Robben, [1984] është poet, shkrimtar dhe dramaturg holandez.

Romanet e tij janë realizuar skenare për filma dhe janë botuar në pesëmbëdhjetë gjuhë.

Është shpallur fitues i çmimit Dutch Booksellers në vitin 2014. Romani *Drita e muzgut*, është botuar në fund të vitit 2022.



Karikaturë nga Arben Mexsi

